MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

# PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR

Për klasën IX të shkollës së mesme të ulët

Prishtinë, dhjetor 2005

Kryeredaktor

Dr. *Fehmi Ismajli*

Redaktorë

Mr. *Miranda Kasneci*
*Ramush Lekaj*

UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

| MINISTRIA E ARSIMI, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË | MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY | MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU |
|---|---|---|
| Kabineti i Ministrit | Office of the Minister | Kabinet Ministra |

# UDHËZIM ADMINISTRATIV
## Zbatimi i planit dhe i programit për klasën e nëntë

**NUMËR: MASHT 7 /2006**
**DATË: 20.01.2006**

Në bazë të nenit 1.3, pika ç), të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 për Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 6.1, paragrafi (b), si dhe nenit 7.1 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

### Neni 1
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është zbatimi i Planit dhe programit mësimor për klasën e nëntë, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

### Neni 2
**Plani dhe programi**

Plani dhe programi i ri për klasën e nëntë i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

**Neni 3**

**Zbatimi**

**3.1.** Ky Plan dhe program për klasën e nëntë zbatohet nga viti shkollor 2006/2007.

**3.2.** Me zbatimin e Planit dhe të programit të klasës së nëntë shfuqizohen planet dhe programet e deritashme të klasës së nëntë të shkollës së mesme të ulët.

**Neni 4**

**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.



**Agim Veliu, Ministër**

PËRMBAJTJA

Udhëzim administrativ, **3**

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT, **7**

I. Hyrje, **7**

II. Qëllimet, **8**

III. Objektivat e përgjithshëm, **10**

IV. Vlerësimi, **11**

V. Udhëzime metodologjike, **14**

VI. Burimet dhe mjetet mësimore, **15**

VII. Plani mësimor, **15**

VIII. Mësimi zgjedhor, **16**

**GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**

GJUHË SHQIPE, **21**
GJUHË ANGLEZE, **33**
GJUHË FRËNGE, **55**
GJUHË GJERMANE, **73**

MATEMATIKË, **99**

**SHKENCAT E NATYRËS**

BIOLOGJI, **113**
FIZIKË, **133**
KIMI, **147**
GJEOGRAFI, **159**

**SHKENCAT SHOQËRORE**

EDUKATË QYTETARE, **177**
HISTORI, **191**

**ARTET**

EDUKATË MUZIKORE, **211**
ART FIGURATIV, **221**

**TEKNOLOGJI**

TEKNOLOGJI ME TIK, **229**

EDUKATË FIZIKE DHE SPORTIVE, **243**

# UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT

## I. HYRJE

Arsimi përfaqëson fushëveprimtarinë prirëse të zhvillimeve shoqërore, politike dhe ekonomike të Kosovës.

Vizionin për krijimin e një shkolle bashkëkohore, sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare, që filloi pas përfundimit të luftës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) po e realizon, duke ndërmarrë hapa të gjithanshëm dhe praktikë në të gjitha fushat e veprimit.

Në këtë ndërmarrje me rëndësi historike për zhvillimin dhe për përparimin e shoqërisë kosovare MASHT-ti synon të ndryshojë pikëpamjet në procesin e ndërtimit të individit me një vizion të qartë për të ardhmen e tij dhe të vendit të tij.

Kjo krijon parakushtet e nevojshme për integrimin e individit dhe të shoqërisë kosovare në lëvizjet politike, në zhvillimet ekonomike, intelektuale, shkencore e teknologjike, si dhe në zhvillimet social-kulturore të vendeve të përparuara evropiane dhe botërore.

Zhvillimi i Planit dhe i programit lëndor mbështetet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënit, mjetet mësimore, metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit.

Grupet punuese profesionale për zhvillimin e planeve dhe të programeve ishin vazhdimisht në rrjedhë të zhvillimeve të reja në arsim dhe në konsultim me ekspertët ndërkombëtarë. Në këtë proces të zhvillimit të planeve dhe programeve, i cili qëndron mbi bazën e strategjisë afatgjatë të MASHT-it, ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë UNICEF-i, agjencitë dhe qeveritë e disa shteteve.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar kultivimit të qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit, inkurajimit të nxënësve që të angazhohen në mënyrë të arsyeshme në përmbushjen e kërkesave shkollore, zhvillimit të shkathtë-

sive në jetën e përditshme, gjithmonë duke pasur parasysh karakteristikat e zhvillimit fizik dhe psikologjik në këtë moshë.

Realizimi i qëllimit të këtij Plani dhe programi do të varet nga puna e përkushtuar e mësimdhënësve, të cilëve edhe u kushtohet ky plan dhe program. Për ta lehtësuar zbatimin e këtij plani dhe programi mësimor, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë do të organizojë kohë pas kohe cikle ligjëratash me mësimdhënës të udhëhequr nga ekspertë fushash përkatëse me një udhëzim shtojcë të këtij plani dhe programi.

## II. QËLLIMET

Plani dhe programi mësimor për klasën e nëntë ka për qëllim që nxënësve:

- t'u sigurojë kushte të përshtatshme për zhvillimin intelektual, estetik, fizik, shoqëror, moral dhe shpirtëror;

- t'u sigurojë orientim dhe t'u ndihmojë në realizimin e interesave të tyre personale për plotësimin e aspiratave përmes nxënies.

- t'u bëjë konsolidimin e diturive, ngritjen, orientimin e prirjeve dhe të shkathtësive në ndërtimin e së ardhmes së tyre;

- t'u mundësojë shfrytëzimin e burimeve të shumta për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve si dhe për zhvillimin e një qasjeje kritike ndaj informacioneve dhe fakteve që u ofrohen;

- t'u mundësojë që në mënyrë të pavarur të marrin iniciativë dhe veprim të pavarur, gjithnjë duke pasur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grup, varësisht prej llojeve të ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë;

Grupet punuese për zhvillimin e planeve dhe të programeve në përshtatshmëri me përmbajtjen i kanë zgjedhur objektivat e përgjithshëm dhe specifikë për sendërtimin e qëllimeve të lartshënuara, nga të cilat, në mënyrë të qartë, janë përcaktuar edhe rezultatet e pritura në përfundim të klasës së nëntë.

## III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Për të jetësuar qëllimet e këtij Plani dhe programi nevojiten shumë rezultate të të nxënit, që mund të jenë të shkallës së përgjithshme dhe specifike. Gjithherë vendosen paraprakisht rezultatet e përgjithshme të të nxënit, të cilat duhet të jenë të shkallës së nevojshme të së përgjithshmes dhe të dallohen qartë në aspektin e shkallës së ndërlikueshmërisë apo të tërësisë që synojmë të arrihet.

Në bazë të qëllimeve të Planit dhe të programit mësimor të klasës së nëntë, MASHT-i synon që në fund të vitit mësimor nxënësi t'i arrijë këta objektiva të përgjithshëm:

***A. Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat***

- Të jetë kritik ndaj lëndës;
- Të jetë i hapur;
- Të jetë tolerant;
- Të gëzojë respekt;
- Të jetë i vullnetshëm.

***B. Të njohë***

- Fjalorin (terminologjinë);
- Faktet;
- Konceptet;
- Parimet;
- Procedurat dhe metodat.

***C. Të kuptojë***

- Faktet dhe parimet (të zbatojë në situata të thjeshta);
- Përmbajtjen e materialeve;
- Relacionin shkak-efekt;
- Arsyetimin e metodave dhe të procedurave.

***Ç. Të zbatojë në situata të reja***

- Faktet dhe parimet.
- Procedurat dhe metodat;
- Zgjidhjen e problemeve.

***D. Të analizojë***

- Zbërthimin e informatave;
- Krahasimin e fakteve;
- Marrëdhënien ndërmjet shkakut dhe efektit;
- Raportin e ngjarjeve në një tekst.

***DH. Të sintetizojë (të menduarit kritik- kompleks)***

- Njohjen e informatës relevante dhe jorelevante;
- Dallimin ndërmjet faktit dhe mendimit;
- Zbatimin e parimeve në zgjidhjen e problemeve;
- Interpretimin e materialit ilustrues;
- Njohjen e supozimeve.

Për të vlerësuar arritjen e këtyre objektivave duhet të zhvillojmë procedura dhe mjete përkatëse të matjes (shih vlerësimi).

## IV. VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vrojtimit, i mbledhjes sistematike, i analizës dhe i interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në ç'shkallë nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues. Ai duhet të mbështetet në rezultatet e pritura të programit të lëndës përkatëse dhe të nivelit përkatës.

Ky proces mbështetet në disa parime themelore, siç janë:

- përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- zbatimi i instrumenteve përkatëse të matjes në përputhje me qëllimin, në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit nëpërmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- zbatimi i teknikave të vlerësimit me anë të së cilave bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

### IV.1. Instrumentet e vlerësimit

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- vrojtimi;
- pyetësori (vetëvlerësimi);
- raporti me shkrim i një pune praktike apo i një hulumtimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- testi i bazuar në kritere dhe objektiva;
- testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje):
    - me përgjigje alternative të shumta;
    - me përgjigje të hapura të shkurtra;
    - me përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

*Çdo shkollë vendos standardet apo kriteret me të cilat përcaktohet shkalla e arritshmërisë në fund të procesit mësimor për klasën e nëntë.*

### IV. 2. Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit mësimor çdo nxënës duhet të arrijë njërën prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumë mirë (arritje e lartë);
- mirë (arritje mesatare);
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme).

Shkalla e përfitimit të arritshmërisë varet drejtpërdrejt nga standardet e arritshmërisë të cilat bazohen në:

| Objektivat e përgjithshëm | Arritje shumë e lartë 90% | Arritje e lartë 80% | Arritje e kënaqshme 60% | Arritje e kufizuar 40% | Arritje e pamjaftueshme |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Njohja e lëndës*** | Aftësi shumë e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta. | Aftësi e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohu-rive të lëndës në situata të thjeshta. | Aftësi mesatare në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta. | Aftësi e kufizuar në njohjen dhe në zbatimin e njohu-rive të lëndës në situata të thjeshta. | Aftësi jo e mjaftueshme në njohjen dhe në zbatimin e njohu-rive të lëndës në situata të thjeshta. |
| ***Të kuptuarit e proceseve shkencore*** | Aftësi shumë e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe e organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë. | Aftësi e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë. | Aftësi e kënaqshme e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë. | Aftësi e kufizuar e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore. | Aftësi e pamjaftueshme e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore. |
| ***Të menduarit kritik*** | Aftësi e lartë e të menduarit kritik në situata komplekse, si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme. | Aftësi e të mendu-arit kritik në situata komplekse, si: njohja me informa-cione relevante, zgjidhja e proble-meve, duke zbatuar parimet dhe usht-rimet e interpretueshme. | Aftësi e kufizuar e të menduarit kritik në situata komplekses: njohja me informacione relevante, zgjedhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme. | | |
| ***Shkathtësitë manovruese*** | Shkallë e kënaqshme e përfitimit në shkathtësitë manovruese. | | | Shkallë e ulët e përfitimit (disa) në shkathtësitë manovruese. | |

## V. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përzgjedhja e metodave mësimore është në kompetencë të mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe me kërkesat e nxënësve, me veçoritë e përmbajtjes së temave mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet kombinuar, të jenë sa më të larmishme, ngase nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë llojet e mësimnxënies. Mësimdhënësi mund të përdorë disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara për të arritur rezultate sa më të larta gjatë procesit mësimor.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda dhe teknika të ndryshme:

- shpjegimi dhe sqarimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- të mësuarit problemor;
- diskutimi (debati);
- puna në grupe;
- demonstrimi dhe interpretimi;
- teknika e të menduarit kritik;
- shtrim idesh (brainstorming);
- vetëhulumtimi (kërkimi).

Për tema të caktuara që karakterizohen me informacione të bollshme gjen zbatim edhe ligjërata ndërvepruese e kombinuar me veprimtari praktike.

Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses mësimi në natyrë, ekskursione të ndryshme studimore, vizitat institucioneve të ndryshme etj.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

## VI. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive e këtij plani dhe programi, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi. Deri tash burim kryesor informimi ishte teksti shkollor i lëndës përkatëse.

Krahas teksteve të ndryshme shkollore, sugjerojmë të përdoren edhe materiale të tjera informimi:

- doracakë, atlase, broshura;
- gazeta, revista profesionale dhe shkencore;
- fotografi, posterë, afishe, skema, diagrame, harta, tabela;
- modele, figura, makete;
- fotoslajde, filma, videokaseta;
- programe të kompjuterëve, interneti, CD-të etj.

Është kompetencën e mësimdhënësit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuele, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

## VII. PLANI MËSIMOR

| Nr. | Lëndët mësimore | Numri i orëve | Përqindja |
|---|---|---|---|
| 1 | Gjuhë shqipe | 140 | 12.90 |
| 2 | Gjuhë angleze | 105 | 9.67 |
| 3 | Matematikë | 105 | 9.67 |
| 4 | Biologji | 70 | 6.45 |
| 5 | Fizikë | 70 | 6.45 |
| 6 | Kimi | 70 | 6.45 |
| 7 | Gjeografi | 35 | 6.45 |
| 8 | Edukatë qytetare | 35 | 3.57 |
| 9 | Histori | 70 | 6.45 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 10 | Edukatë muzikore | 35 | 3,57 |
| 11 | Edukatë figurative | 35 | 3,57 |
| 12 | Teknologji | 70 | 6.45 |
| 13 | Edukatë fizike dhe sportive | 70 | 6.45 |
| 14 | **Zgjedhore:**<br>Lëndë apo kurse të reja (p.sh. edukimi qytetarë, etika, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, edukimi për ndërmarrës, teknologjia e informimit dhe e komunikimit, mbrojtja e mjedisit jetësor apo çka do tjetër që është joshëse për nxënësit dhe me interes për komunitetin.<br>Mund të zgjedhin lëndë të reja mësimore edhe nga: Fillet e ekonomisë dhe të drejtësisë (ekonomi, bujqësi, drejtësi) dhe nga Bazat e teknikës (elektroteknikë, makineri, ndërtimtari, industri). | **140** | 12,90 |
| | **Gjithsej:** | **1085** | **100.0** |

## VIII. MËSIMI ZGJEDHOR

Quhet kështu, sepse nxënësit e zgjedhin sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit. Lënda, kursi apo veprimtaria për mësimin zgjedhor mund të sugjerohet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ose në bazë të kërkesës së nxënësve, prindërve, arsimtarëve, apo kujtdo tjetër nga komuniteti. Në mënyrë të veçantë, do të ishte dashtë të konkurrojnë arsimtarët e papunë me projekt komplet (lëndën, kursin apo veprimtarinë dhe planin, programin, tekstin dhe mënyrën e realizimit).

Mësimi zgjedhor mund të organizohet nga:

Lëndë apo kurse të reja (p.sh. edukimi qytetar, etika, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, edukimi për ndërmarrës, teknologjia e informimit dhe e komunikimit, mbrojtja e mjedisit jetësor apo çkado tjetër që është joshëse për nxënësit dhe më interes për komunitetin.

Mund të zgjedhën lëndë të reja mësimore edhe nga: Filet e ekonomisë dhe të drejtësisë (ekonomi, bujqësi,drejtësi) dhe nga Bazat e teknikës (elektroteknikë, makineri, ndërtimtari, industri).

Lënda, kursi apo veprimtaria për mësim zgjedhor duhet të zgjatë jo më pakë se tre muaj.

Për lëndën, kursin apo veprimtarinë duhet të deklarohen më se paku 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës (në qoftë se klasa ka më shumë se një paralele) e nëqoftëse klasa ka vetëm një paralele, atëherë është e nevojshme që për lëndën, kursin apo veprimtarinë të deklarohen gjysma e paraleles, në mënyrë që të mund të organizohet mësimi zgjedhor.

Për mësimin zgjedhor, në bazë të kërkesave të interesuarve, vendosin organet profesionale të shkollës në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Arsimit para fillimit të vitit shkollor. Për mënyrën e deklarimit të nxënësve, të prindërve apo të të interesuarve të tjerë dhe kohën kur ata e bëjnë këtë, vendosin organet e shkollës, por gjithsesi e terë procedura duhet të kryhet para fillimit të vitit shkollor.

Planet dhe programet për mësimin zgjedhor i harton shkolla në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Arsimit dhe profesionistë të lëmenjve përkatës nga komuniteti (në qoftë se ka të tillë).

Mësimi zgjedhor, kur të aprovohet nga organet profesionale të shkollës, e ka statusin e mësimit të rregullt, më të vetmin përjashtim që mësimi zgjedhor do të vlerësohet me notë përshkruese (jonegative).

## GJUHË SHQIPE

**(4 orë në javë, 140 orë në vit)**

### HYRJE

Në këtë klasë nxënësit do të zhvillojnë, zotërojnë dhe zbatojnë shkathtësitë e komunikimit. Vëmendje e e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit të saktë të gjuhës, formimit kulturor dhe përvetësimit të shkathtësive të komunikimit. Nxënësit duhet t'i praktikojnë dijet e përvetësuara nga letërsia, kultura, gjuha, përmes formave të ndryshme të krijimtarisë individuale dhe grupore: nëpërmes eseve, projekteve, punimeve të ndryshme, të cilat u mundësojnë nxënësve strukturimin e mendimeve, gjykimeve dhe zhvillimin e imagjinatës.

Në këtë klasë ata duhet të jenë në gjendje të trajtojnë me gojë dhe me shkrim tema të ndryshme nga këndvështrimi kulturor, letrar e gjuhësor.

Kjo klasë përmbyll nivelin e dytë të shkollimit dhe nxënësit do ta forcojnë suksesin e tyre në pajtim me rezultatet e klasës përkatëse dhe gjithashtu do ta zotërojnë përdorimin e drejtë të shkathtësive të komunikimit.

Insistimi në aftësimin e nxënësit në pikëpamje të shkathtësive gjuhësore do të përqendrohet në: përdorimin e gjuhës për të informuar, për të argumentuar, për të diskutuar, për të përshkruar, për të krijuar, për të hulumtuar, për të klasifikuar dhe për të vlerësuar.

### QËLLIMET

Lënda e gjuhës shqipe në këtë klasë mësohet me qëllim që nxënësi:

- Të përforcojë, të zhvillojë dhe të zbatojë shkathtësitë e komunikimit në shkollë dhe në situata të ndryshme jashtë shkollës
- Të rrisë shkallën e analizës, të vlerësimit dhe të kritikës për tekstet letrare dhe joletrare

- Të zotërojë dhe të praktikojë drejt njohuritë e sistemit gjuhësor

**Shkathtësitë e komunikimit**

**I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT**

**II. TË LEXUARIT**

**III. TË SHKRUARIT**

**Fushat (tërësitë tematike) përmes të cilave do të zhvillohen shkathtësitë e komunikimit:**

- Organizimi dhe zhvillimi i komunikimit
- Të kuptuarit e teksteve
- Diskutim për tekstin
- Analiza e fjalës, zhvillimi i fjalorit
- Analizë dhe interpretim i teksteve letrare
- Strategjia e shkrimit dhe shkrimi i aplikuar
- Norma gjuhësore e shqipes dhe zotërimi i standardit

- **Organizimi dhe zhvillimi i komunikimit**

1.1 Formulimi i gjykimeve të sakta për idetë që diskutohen; paraqitjeja e qartë e tyre. Krahasimi dhe kontrasti i mënyrës në përmes të së cilës mediat e ndryshme (p.sh. televizioni, gazetat, lajmet revistat, radioja, dokumentarët, lajmet në internet etj.) prezentojnë të njëjtën ngjarje.
Shembuj tekstesh joletrare

1.2 Zgjedhja e modeleve logjike të organizimit (p.sh. kronologjik, tematik, shkak-efekt etj.) për të informuar dhe bindur përmes prezantimit
Shembuj nga Rilindja Kombëtare Shqiptare

1.3 Zgjedhja e teknikave të përshtatshme të hyrjes dhe të përfundimit të tekstit gojor apo të shkruar (shembull: duke përdorur citate letrare dhe joletrare, anekdota dhe referenca burimesh autoritative).

1.4 Njohja dhe përdorimi i formave klasike të të folurit (shembull: hyrja, paragrafët e fillimit, trungu, përmbyllja) me qëllim të formulimit të argumenteve të arsyeshme dhe të bindurit gjatë debatit.

Shembuj nga Letërsia e vjetër (akte, fjalime, letra etj.). Shembuj nga Rilindja Kombëtare Shqiptare

1.5 Prezantimi dhe avancimi i tezave dhe i provave (p.sh. atyre statistike, dëshmuese, specifike).

1.6 Efektet vizuele, grafike, etj. Të prezantimit; gjestet, zëri, kontakti me sy etj.

Shembuj nga tekste joletrare fushash të ndryshme.

1.7 Analiza historike e fjalimeve të rëndësishme (P.sh. nga Kthimi i Skënderbeut në Krujë, nga Fjalimi i Klintonit në Kosovë në vitin 1999 etj.) për të gjetur tiparet themelore retorike të atyre fjalimeve, të cilat i bëjnë ato të mbahen në mend më lehtë. Vlerësimi i gjuhës, i qartësisë, i lidhjes së fuqishme unike të fjalimit të folësit, të argumenteve të tij dhe i organizimit të ideve, të diksionit dhe të sintaksës.

1.8 Identifikimi i efekteve estetike në një krijim letrar të dhënë përmes (p.sh.), prezantimit të teknikave të shkrimit dhe të tekstit të një drame të shkruar në kohën e Rilindjes Kombëtare, duke krahasuar atë me teknikat teatrale, kur shfaqet ai tekst ose kur bëhet film.

1.9 Kombinimi i strategjive tradicionale retorike të narracionit, paraqitjes, të bindurit dhe përshkrimit. Demonstrimi i zotërimit të shqipes standarde përmes prezantimeve narrative dhe komunikimit të mirë me publikun. (Shembuj nga revistat, gazetat). Lokalizimi i skenave dhe i incidenteve në vende të caktuara. Përshkrimi i detajuar i skenave; tingujve, veprimeve të veçanta, kohës, hapësirës, lëvizjeve, gjesteve dhe ndjenjave të personazheve. Përfshirja e teknikave të ndryshme; hartave, skemave, grafikoneve për demonstrim.

1.10 Parashikimi i mundshëm i keqkuptimeve dhe i paragjykimeve që mund të rrjedhin.

1. 11 Aplikimi i teknikave përkatëse të intervistave:

a. përgatitja dhe parashtrimi i pyetjeve të rëndësishme;

b. shënimi i përgjigjeve;

c. përdorimi i gjuhës me pjekuri, ndjeshmëri, mençuri dhe ndjenjë respekti.

ç. Përgjigjja korrekte dhe efektive në pyetje.

d. demonstrimi i njohjes së temës.

e. vlerësimi dhe efektiviteti i intervistës.

- **Të kuptuarit e teksteve**

1.1 Leximi dhe kuptimi i materialeve.

1.2 Të kuptuarit dhe analiza e tekstit letrare dhe joletrar.

1.3 Analiza e strukturës dhe e formatit të dokumenteve të punës, duke përfshirë anën grafike, vijat kufizuese si dhe sqarimin se si autorët përdorin këto tipare teksti e doukumenti për t'i arritur qëllimet e tyre.

1.4 Krijimi i pyetjeve të rëndësishme rreth leximit për çështjet që mund të hulumtohen.

1.5 Sintetizimi i përmbajtjes së tekstit nga disa burime a vepra nga një autor i vetëm për një problem të vetëm dhe nga autorë të ndryshëm për një problem të vetëm; parafrazimi i ideve dhe lidhja me burime dhe tema të tjera.

1.6 Shtrirja e ideve të prezantuara në tekste dhe në burime themelore përmes analizave e vlerësimeve origjinale.

1.7 Vlerësimi i besueshmërisë së një argumenti të një autori. Mënyra se si autori realizon strukturën e tekstit të tij
(shembuj: tekste letrare dhe joletrare; tregime, artikuj, fjalime).

- **Diskutim për tekstin**

1.1 Diskutime për tekste letrare:

a. Avancimi i gjykimit që del nga të kuptuarit e një ideje domethënëse ose fragmenti.

b. Përkrahja e ideve dhe e pikëshikimeve të rëndësishme përmes referencave në tekst dhe nga burime të tjera.

c. Demonstrimi i të kuptuarit dhe i përdorimeve gjuhësore dhe stilistike të autorit dhe të çmuarit e efekteve të krijuara.

d. Identifikimi dhe vlerësimi i efekteve shumëkuptimore, nuancat dhe efektet komplekse përbrenda tekstit.

1.2 Krijimi i argumenteve bindëse, duke përfshirë analizën dhe vlerësimin e problemeve dhe të zgjidhjeve si dhe shkaqet dhe efektet:

a. Strukturimi i idesë dhe i argumenteve në mënyrë koherente dhe logjike.

b. Përdorimi i parimeve retorike për të mbrojtur një pohim, duke u thirrur në logjikë përmes arsyes ose në emocion apo besim në një etikë; duke përdorur shembuj personalë, raste apo analogji.

c. Sqarimi i mendimeve të ekspertëve, citate të zgjedhura dhe shprehje të besimeve dhe të paragjykimeve të ndryshme si dhe arsyeshmëria logjike e tyre.

d. Parashikimi i asaj që ka dëgjuesi apo i kundërargumentit të tij.

1.3 Krijimi i prezantimeve përshkruese:

a. Vendosja e saktë e pikëshikimit të folësit për temën që prezantohet;

b. Vendosja e saktë e lidhjes së folësit me temën përkatëse (p.sh. vrojtim, gjakftohtë, involvim personal etj.).

c. Përdorimi i përshkrimeve faktike të dukjeve, imazheve konkrete, ndërrimi i perspektivave dhe i pikave të përparësisë dhe detajet ndijore.

- **Analiza e fjalës, zhvillimi i fjalorit**

1.1 Analiza e fjalës, rrjedhshmëria e gjuhës dhe e mendimit, pasurimi sistematik i fjalorit

1.2 Identifikimi dhe përdorimi i kuptimeve literale dhe figurative të fjalëve dhe të kuptuarit e burimeve të fjalëve.

1.3 Dallimi mes kuptimeve denotative dhe konotative të fjalëve dhe interpretimi i fuqisë konotative të fjalëve.

1.4 Identifikimi i teksteve të vjetra shqipe, njohja e kuptimit të origjinës dhe e kuptimit të fjalëve të reja.
Shembuj nga letërsia e vjetër shqipe, nga letërsia gojore shqipe, nga letërsia e Rilindjes dhe nga letërsia moderne shqipe.

- **Analizë dhe interpretim i teksteve letrare**

1.1 Leximi dhe interpretimi i veprave të rëndësishme historike dhe kulturore të letërsisë, me theks të veçantë në histori dhe në shkencat shoqërore.

Shembuj nga: Letërsia e Rilindjes, letërsia për të rinj.

1.2 Artikulimi i lidhjeve mes qëllimeve të shprehura dhe veçorive të formave të ndryshme të letërsisë dramatike (komedisë, tragjedisë, dramës, monologut dramatik); krahasimi dhe kontrasti i temave të ngjashme në zhanre të ndryshme, duke parë se si zgjedhja e zhanrit formëson temën dhe anasjelltas.

1.3 Analiza e ndërlidhjeve mes karaktereve kryesore dhe dytësore në tekstin letrar (p.sh., konflikti i jashtëm dhe i brendshëm, motivimi, lidhja, ndikimi) dhe sqarimi si ndikojnë këto ndërlidhje në thurjen e intrigës. Përcaktimi i tipareve të karaktereve nga ajo që ato thonë për veten gjatë rrëfimit, dialogut dhe monologut dramatik.

1.4 Krahasimi i veprave që shprehin tema universale dhe sigurimi i të dhënave për përkrahjen e ideve të shprehura në secilën vepër.

1.5 Analiza e zhvillimit të kohës në një paragraf të caktuar, (p.sh., profetizimi apo vizionariteti, retrospektiva etj.).

1.6 Nohja dhe të kuptuarit e domethënies së parimeve të ndryshme letrare, duke përfshirë gjuhën figurative, pamjet letrare, alegorinë dhe simbolizmin; sqarimi i tyre.

Shembuj nga letërsia moderne shqipe

1.7 Interpretimi dhe vlerësimi i fuqisë shumëkuptimore (ambiguitive) të gjuhës së letërsisë; kontradikta, ironia, paradoksi etj.

1.8 Sqarimi si ndikon zëri që rrëfen, veta dhe zgjedhja e narratorit në karakterizim, në intrigë dhe në besueshmëri të tekstit.

1.9 Identifikimi dhe përshkrimi i funksionit të dialogut, skenografisë dhe i tipareve të karakterit në letërsinë dramatike.

1.10 Vlerësimi i vlerave estetike të stilit, duke përfshirë diksionin dhe gjuhën figurative, intonacionin, atmosferën, temën, duke përdorur terminologjinë e kritikës letrare (qasja kritike).

1.11 Analiza e mënyrës si lidhet një vepër letrare me tema dhe me çështje nga periudha historike së cilës i takon (qasja historike) Shembuj nga kritika letrare shqipe.

- **Strategjia e shkrimit dhe shkrimi i aplikuar**

1.1 Shkrimi i lidhur (koherent) dhe i përqendruar (fokusuar), i argumentuar dhe nga perspektiva e qartë. Shkrimi demonstron vetëdijen e nxënësit për publikun dhe për qëllimin e shkrimit. Nxënesi kalon nëpër shkallë të caktuara të proceseve të shkrimit.

1.2 Vendosja dhe verifikimi i tezave të qëndrueshme që përmbajnë një subjekt të qartë dhe një atmosferë të qëndrueshme gjatë tërë shkrimit.

1.3 Përdorimi i saktë i gjuhës, i foljeve vepruese, i detajeve të ndieshme, modifikuesve përkatës dhe të diatezës veprore më shumë sesa të asaj pësore.

1.4 Përdorimi i pyetjeve hulumtuese dhe i metodave të përshtatshme të hulumtimit (p.sh., biblioteka, mediat elektronike, intervistat personale) për të siguruar burime themelore dhe plotësuese.

1.5 Sinteza e informatave nga burime të ndryshme.

1.6 Futja e citateve në tekstin e shkruar, duke mos u shkëputur nga rrjedha e idesë së tekstit.

1.7 Përdorimi i normave përkatëse për dokumentacionin në tekst; shënimet, bibliografia, fusnota.

1.8 Rishikimi i shkrimit me qëllim të përmirësimit të logjikës dhe të koherencës së organizimit të precizitetit të fjalëve të zgjedhura, duke pasur parasysh publikun, qëllimin dhe kontekstin.

1.9 Kombinimi i strategjisë retorike të rrëfimit, të të paraqiturit dhe të bindurit e përshkrimit (deskripcionit) për të dhënë një tekst me më së paku 1,500 fjalë. Demonstrimi i njohjes së shqipes standarde dhe i hulumtimit, i organizimit dhe i zhvillimit të strategjisë së shkrimit.

1.10 Shkrimi i përgjigjeve për letërsinë:

a. Demonstrimi i të kuptuarit të idesë domethënëse të teksteve letrare;

b. Përkrahja e ideve të rëndësishme dhe i pikëshikimeve përmes referencave të detajuara;

c. Demonstrimi i vetëdijes së autorit për përdorimin e parimeve stilistike dhe të kuptuarit e efekteve të krijuara.

1.11 Shkrimi i eseve analitike dhe i raporteve hulumtuese.

a. Nënvizimi i të dhënave me të cilat përkrahen tezat dhe informacionet.

b. Dallimi mes vlerave relative dhe domethënies kryesore të fakteve dhe të ideve.

c. Përdorimi i mjeteve vizuale dhe teknologjike për organizimin dhe krijimin e hartave, grafikoneve etj.

d. Bartja e shpejtë dhe e suksesshme e informacioneve dhe e ideve nga burimet parësore dhe dytësore.

e. Parashikimi i keqkuptimeve dhe i paragjykimeve të mundshme të lexuesit.

ë. Përdorimi përkatës i termave.

1.12 Shkrimi i esesë dhe përfillja e gjuhës standarde.

1.13 Shkresat e karakterit administrativ.

1.14 Zhvillimi i shkrimit bindës: strukturimi logjik dhe argumentet; përdorimi i procedurave retorike; sqarimi dhe mbrojtja e pozicioneve përmes fakteve të rëndësishme, opinioneve, citimeve etj.; adresimi i preokupimeve, paragjykimeve, pritjeve.

1.15 Letra për biznes: sigurimi i informacionit të qartë dhe të kuptimshëm dhe drejtimi kah publiku përkatës; përdorimi i fjalorit dhe i stilit të duhur; fuqizimi i idesë dhe imazheve; ndjekja e stilit standard të faqes, formatit, fontit etj.

1.16 Dokumenti teknik (p.sh., doracak për rregullat e sjelljes në rast zgjidhjeje të konfliktit, procedurat e udhëheqjes së takimit, minutat e takimit etj): raportimi logjik dhe korrekt i informatave dhe i ideve; ofrimi i specifikave të detajuara, duke përfshirë edhe skenaret, definimet dhe shembujt; parashikimi i gabimeve dhe i keqkuptimeve të lexuesit etj.

- **Norma gjuhësore e shqipes dhe zotërimi i standardit**

1.1 Zhvillimi historik i gjuhës.

a. Rëndësia e zhvillimit historik të gjuhës në periudha të ndryshme

1.2 Klasifikimi i Gjuhëve

1.3 Gjuha standarde dhe dialektet (rëndësia e përdorimit të gjuhës standarde në shkolla dhe roli i dialekteve në zhvillimin e gjuhës. Dialektizmat në gjuhën shqipe )

1.4 Demonstrimi i të kuptuarit të drejtë të përdorimit të shqipes standarde

1.5 Tingujt e gjuhës shqipe dhe klasifikimi i tyre

1.6 Ndryshimet fonetike të tingujve

a. (asimilimi, disimilimi, haplologjia, elizioni, metafonia, apofonia,qiellzorëzimi, rotacizmi, metateza)

b. Rëniet e tingujve (afereza, sinkopa dhe apokopa)

c. Shtesat e tingujve (proteza, epenteza dhe epiteza)

1.7 Përdorimet kryesore të rasave, nyjave, parafjalëve, lidhësave, pjesëzave dhe funksioni i tyre në gjuhë

1.8 Pasqyra e bashkimit të trajtave të shkurtra të përemrave

1.9 Përdorimi i kategorive gramatikore të foljeve dhe rëndësia e praktikimit të drejtë të tyre. Format e pashtjelluara të foljes (paskajorja, pjesorja dhe përcjellorja)

1.10 Llojet e fjalive (bashkërenditëse dhe nënrenditëse)

1.11 Praktikimi i përdorimit të drejtë të shenjave të pikësimit si: pika, pikëçuditja, pikëpyetja, presja, pikëpresja, viza, thonjëzat, kllapat, dypikat, shumëpikëshi

1.12 Rëndësia e zhvillimit leksikor për pasurimin e gjuhës shqipe. Kuptimi leksikor i fjalës, fjalët me shumë kuptime, neologjizmat, mënyra e formimit të fjalëve

## REZULTATET E PRITURA

Në fund të klasë së nëntë, nxënësi:

- Zotëron shkathtësi të veçanta individuale për organizimin dhe zhvillimin e komunikimit gjatë punës individuale dhe në grup
- Kupton, identifikon dhe analizon informacione të ndryshme kulturore e letrare
- Analizon, vlerëson dhe organizon informata nga burime të ndryshme, duke i paraqitur dhe sistemuar ato
- Kupton strategjinë e shkrimit dhe praktikon përmes shkrimit forma të ndryshme letrare dhe joletrare
- Kupton format dhe idetë themelore të kulturës dhe të letërsisë së periudhave të ndryshme
- Zotëron dijet dhe standardin e sistemit të gjuhës, duke praktikuar atë në lloje të ndryshme të komunikimit, të analizave dhe të shkrimit

## QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Gjuha shqipe është mjet komunikimi për të gjitha lëndët. Mirëpo, lidhje të drejtpërdrejta vihen me historinë, me gjeografin, me edukatën qytetare, me artet etj. Disa tema nga këto lëndë ndikojnë në zhvillimin e shkathtësive të komunikimt, në formimin kulturor dhe në krijimin e individualitetit të pavarur. Përveç çështjeve ndërlëndore, përmes gjuhës shqipe mund të zhvillohen edhe disa çështje ndërprogramore, p.sh., tema për shëndetësi, për të drejtat e njeriut, për çështjet gjinore etj. Temat mund të zgjedhen nga mësimdhënësi, varësisht nga rëndësia dhe aktualitetit që kanë (nga televizioni, revistat, gazetat apo nga rrethi dhe mjedisi i tyre).

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodologjia e mësimdhënies zë vend kryesor në realizimin e përmbajtjes programore. Gjatë realizimit të procesit mësimor, mësimdhënësi duhet të ketë parasysh strategjitë më efektive, të cilat mundësojnë mësimin efektiv. Mësimdhënësi duhet të jetë model për nxënësit në

mënyrën e përdorimit të shkathtësive gjuhësore. Vëmendja e tij duhet të përqendrohet në disa parime bazë

- **Përqendrimi në komunikim** (shkathtësitë e komunikimit: të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit). E tërë përmbajtja është në funksion të zhvillimit të këtyre shkathtësive;
- **Përqendrimi në zhvillimin e gjuhës**
- **Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij**

Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes. Mësuesi duhet të bëjë përpjekje ta njohë mirë karakterin e nxënësit, përparësitë dhe dobësitë e tij, ta verifikojë a është tip i hapur apo i mbyllur, frikacak apo guximtar, a merr vetë iniciativa apo duhet të nxitet nga mësuesi etj.

Roli i mësimdhënësit është vendimtar, i cili ndihmon në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Kjo varet nga planifikimi i orës mësimore: përdorimi i hapësirës në klasë, d.m.th mënyra e vendosjes së bankave si dhe aktiviteteve që zhvillohen në klasë: mënyra e komunikimit, luajtja e roleve, puna në grupe, në çifte, luajtja e roleve dhe përdorimi i teknikave të reja të mësimdhënies.

## VLERËSIMI

***Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:***

- Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç'shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t'i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit
- Shkallën e zotërimit të njohurive me qëllim të eliminimit të pengesave dhe të vështirësive në nxënie
- Integrimin e njohurive të fituara që nxënësit i realizojnë edhe jashtë programit shkollor

Theks të veçantë gjatë vlerësimit duhet kushtuar:

- përdorimit të fjalorit
- pyetjeve dhe përgjigjjeve
- iniciativave dhe mendimeve të pavarura
- përshkrimeve dhe shpjegimeve

- radhitjes së fjalëve në fjali
- aktiviteteve individuale dhe grupore
- fjalorit (leksiku)

**LITERATURA**

- **Tekstet që hartohen sipas këtij programi**
- **Tekste të mëhershme që përmbajnë këtë materie**
- **Revista, gazeta etj., të cilat ndihmojnë realizimin e objektivave të këtij programi**
- **Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR – KEC, Prishtinë 2003**
- **Tekste të tjera alternative**

# ENGLISH LANGUAGE CURRICULUM

**(3 hours per week, 105 in total)**

## INTRODUCTION

Learning is a complex process of discovery, collaboration, and inquiry facilitated by language. Composed of interrelated and rule governed symbol systems, language is a social and uniquely human way of representing, exploring, and communicating meaning. Language is an essential tool for forming interpersonal relationship, understanding social situations, extending experiences, and reflecting on thought and action. Language is the principal instrument of thought and the primary basis of all communication.

## PHILOSOPHY

The program of English language will emphasize the importance of experiencing language in context. Learners' background knowledge, skills and attitudes will be used as means of developing communicating abilities. As the learners develop communication skills, they also increase their linguistic accuracy and develop language learning strategies.

In the English language program learners will acquire various kinds of knowledge, skills and attitudes about:

**1.** Interpreting, expressing and negotiating meaning (communication).

**2.** Sounds, written symbols, vocabulary, structure and discourse (language).

**3.** Cognitive, socio-cognitive and meta-cognitive process (general language education).

4. Patterns of ideas, behaviours, manifestations, cultural artefacts and symbols (culture).

Acquiring the language incorporates communication skills such as listening, speaking, reading, writing, viewing and showing. Learners develop these communication skills by using knowledge of the language, including grammar, and culture, communication and learning strategies, technology, and content from other subject areas to socialise, to acquire and provide information, to express feelings and opinions. Knowledge of other cultures, connections to other disciplines, comparisons between language and cultures, and community interaction all contribute to and enhance the communicative language learning experience, but the communication skills are the primary focus of language acquisition.

**AIMS**

In order to communicate effectively and increase their language and cultural understanding, in grade nine learners should:

- Use the four language skills in real life situations both inside and outside of school;
- Demonstrate an understanding of the traditions, practices, and products of the cultures other than their own;.
- Demonstrate understanding of the nature of language through comparisons of the target language and the mother tongue;
- Demonstrate comprehension of information from making connection with other disciplines in the school setting and further;

## The Scope of Grade Nine English Language Curriculum

| | | |
|---|---|---|
| **COMMUNICATION**<br>Enable learners to increase confidence and fluency in all language skills and use the language with both native and non-native speakers. | | |
| **Listening**<br>**General objective:** Enable learners to listen to peers and teachers to establish, maintain and enhance personal relationship in school and to some extent in the community. | | |
| **Specific objectives** | **Suggested language activities** | **Attainment targets** |
| **Learners should be able to:**<br>• Listen to, tell and/or re-tell familiar stories;<br>• Listen and extract meaning from familiar conversational topics;<br>• Distinguish between statements, questions and commands and respond appropriately;<br>• Listen to and take notes from teacher's lessons presented orally;<br>• Identify ideas in a variety of oral presentations, on a range of topics using grade appropriate vocabulary;<br>• Listen to discussions and ask questions to clarify meaning;<br>• Identify own purpose for listening;<br>• Listen to a dialogue and determine probable relationship between the speakers, i.e. family members, friends, doctor/patient;<br>• Begin to listen to authentic passages for enjoyment and information. | • Listen and fill in the gaps;<br>• Listen and match;<br>• Listen and view to a Radio/ TV commercial;<br>• Listen to recorded short stories;<br>• Dictation<br>• Listen and reorder;<br>• Listen to a tape (dialogue, conversations) and answer;<br>• Listen to songs, poems;<br>• Role play; | **Learners can:**<br>• Listen and respond to short, simple stories, songs and poems;<br>• Respond to vocabulary, questions and instructions in a familiar context;<br>• Identify main ideas and supporting details in short oral presentations;<br>• Listen and respond to messages spoken in English at a normal speed;<br>• Listen to a dialogue and begin to determine if the language is appropriate to the situation;<br>• Identify speaker's purpose. |

| **Reading**<br>**General objective:** Enable learners to increase fluency, comprehension, and insights of written English by using effective reading strategies. | | |
|---|---|---|
| **Specific objectives:** | **Suggested language activities** | **Attainment targets** |
| **Learners should be able to:**<br>• Use text organisers, such as headings, pictures and graphs, to predict and categorise information;<br>• Skim, scan and read closely for required information;<br>• Make simple inferences, using information from texts;<br>• Summarise, compare, contrast, and synthesize significant ideas in a text;<br>• Analyse text, before, during and after reading with limited assistance;<br>• Distinguish between facts and opinions;<br>• Read a variety of texts for a variety of purposes;<br>• Read simple texts for pleasure;<br>• Recognise the structure of a short story, essay, play, or poem;<br>• Understand and use new vocabulary words from context to share information about topic. | • Jigsaw reading;<br>• Read and retell;<br>• Preview the story;<br>• Read aloud;<br>• Match activities (headings, key words etc);<br>• Scanning (for specific information)<br>• Skimming (for a gist)<br>• Label the paragraphs;<br>• WH questions;<br>• Poetry. | **Learners can:**<br>• Read and understand instructions;<br>• Retell stories (e.g. traditional and fairy tales);<br>• Re-read favourite stories and poems, reciting some from memory;<br>• Read short stories with the ending omitted; then predict the ending for it;<br>• Prepare, present and act out stories and poems they have read;<br>• Read and interpret graphic and pictorial information;<br>• Read and comprehend selected texts (paraphrasing or summarising the main idea). |

<table>
<tr><td colspan="3">Speaking<br>General objective: Enable learners to engage in conversation, provide and obtain information in a variety of personal and social context.</td></tr>
<tr><th>Specific objectives:</th><th>Suggested language activities</th><th>Attainment targets</th></tr>
<tr><td>Learners should be able to:<br>• Retell familiar stories and participate in short conversations;<br>• Give an oral presentation on a specific topic, e.g. self, family, school and similar<br>• Offer and respond to greetings, farewells, compliments, and apologies independently;<br>• Participate in class discussions;<br>• Speak to inform and persuade;<br>• Prepare and debate an issue;<br>• Recognise the difference between formal and informal speech;<br>• Ask questions to clarify meaning and seek information;<br>• Recognise that there are often multiple ways to express an idea in the target language;<br>• Exchange opinions about people, activities and events in their personal lives or communities;<br>• Use new vocabulary in speech;<br>• Summarise the plot and provide brief descriptions of characters in selected poems, short stories, folk tales and anecdotes that are familiar to their peers in the target culture.</td><td>• Story-telling;<br>• Oral presentation;<br>• Debate;<br>• WH questions;<br>• Role play;<br>• Answer the question;<br>• Giving opinions.</td><td>Learners can:<br>• Give and follow instructions by participating in various games or activities with partners or groups;<br>• Retell a text using age-appropriate vocabulary;<br>• Perform dialogues/role plays, and recite poems;<br>• Express their likes and dislikes regarding various people, objects, events present in their everyday environments;<br>• Prepare and deliver short oral presentations;<br>• Speak to share thoughts, opinions and feelings.</td></tr>
</table>

| **Writing**<br><br>**General objective:** Enable learners to write in English for a variety of purposes with increasing independence and accuracy. | | |
|---|---|---|
| **Specific objectives:** | **Suggested language activities** | **Attainment targets** |
| **1.1. Të dëgjuarit** | ▪ Shkëmbimi i mendimeve mes profesorit dhe nxënësve.<br>▪ Dialogët e incizuar ose në situata të drejtpërdrejta (bashkëbisedime).<br>▪ Dallimi i trajtave të ndryshme të intonacionit.<br>▪ Kuptimi i llojeve të ndryshme të ligjërimit/ të porosive.<br>▪ Nxjerrja e informatave kryesore nga një porosi.<br>▪ Kuptimi dhe dallimi i ligjëratës së drejtë nga ligjërata e zhdrejtë. | **Nxënësi është në gjendje :**<br>▪ të shkëmbejë mendime me profesorin, me nxënës,<br>▪ të kuptojë dialogun e incizuar dhe (bashkë)bisedimet,<br>▪ të dallojë trajtat e ndryshme të intonacionit,<br>▪ të kuptojë ligjërimet e ndryshme / porositë e ndryshme,<br>▪ të nxjerrë informatat kryesore nga një porosi.<br>▪ të kuptojë dhe të dallojë ligjëratën e drejtë nga ligjërata e zhdrejtë, |
| **1.2. Të folurit** | ▪ Dialogët dhe bashkëbisedimet.<br>▪ Shqiptimi i drejtë i fjalëve, i intonacionit, i theksit.<br>▪ Shprehja e fjalive sipas lidhjeve të drejta sintaksore.<br>▪ Shtruarja e pyetjeve dhe përgjigjja në pyetje të shkurtra.<br>▪ Paraqitja e të dhënave për veten, për dikë tjetër, për mjedisin e vet, për familjen.<br>▪ Shprehja e vlerësimit, e parapëlqimit.<br>▪ Përshkrimi i një personi, i një monumenti, i një vendi, i një peizazhi.<br>▪ Shpjegimi i një teksti të shkurtër (të lexuar). | ▪ të dialogojë dhe të bashkëbisedojë,<br>▪ të shqiptojë drejt fjalët, intonacionin, theksin,<br>▪ të shprehë fjali sipas lidhjeve të drejta sintaksore,<br>▪ të shtrojë pyetje e të japë përgjigje të shkurtra,<br>▪ të paraqitë të dhëna për vetveten, për dikë tjetër, për mjedisin e vet, për familjen,<br>▪ të shprehë vlerësimin e vet, parapëlqimin,<br>▪ të përshkruajë një person, një monument, një peizazh,<br>▪ të shpjegojë një tekst të shkurtër (të lexuar), |

<table>
<tr><td>1.3. Të lexuarit</td><td>• Leximi sipas rregullave të shqiptimit të gjuhës frënge<br>• Leximi dhe kuptimi i materialeve të ilustruara : tabela informimi, skema, harta gjeografike, vizatime, pjesë të teksteve, tekste<br>• Leximi dhe kuptimi i mesazheve të shkurtëra dhe të thjeshta :<br>- kartolinë, ftesë me shkrim,<br>- formular, skedë, pyetësor,<br>- fragment i shkurtër,<br>- poezi, këngë<br>• leximi i përshkrimit të shkurtër të një vizatimi me fjali të thjeshta dhe të shkurtëra:<br>- identifikimi i një shteti, vendi ose qyteti<br>- dallimi i informatave thelbësore të një shpalljeje<br>- seleksionimi i informatave<br>- kuptimi i fjalëve të mësuara në mënyrë korrekte<br>- kuptimi i një orari, programi televiziv<br>- njohja dhe kuptimi i llojeve të muzikës në Kosovë, në Francë dhe në vende frankofone</td><td>Nxënësi është në gjendje:<br>• të lexojë pa vështirësi dhe sipas rregullave gjuhësore të gjuhës frënge<br>• të lexojë dhe të kuptojë materiale të ilustruara : tabela informimi, skema, harta gjeografike, vizatime, pjesë të teksteve,<br>• të lexojë dhe të kopjojë mesazhe të shkurtra dhe të thjeshta :<br>- kartolinë, ftesë me shkrim,<br>- formular, skedë, pyetësor,<br>- fragment i shkurtër,<br>- poezi, këngë<br>• të lexojë përshkrimin e një vizatimi me fjali të thjeshta dhe të shkurtra:<br>- të identifikojë një shtet, vend ose qytet,<br>- të dallojë informatat thelbësore të një shpalljeje,<br>- të seleksionojë informatat,<br>- të kuptojë fjalët e mësuara në mënyrë korrekte,<br>- të kuptojë një orar, program televiziv,<br>- të njohë dhe të kuptojë llojet e muzikës në Kosovë, në Francë dhe në vende frankofone</td></tr>
<tr><td>1.4. Të shkruarit</td><td>• hartimi i mesazheve të shkurtëra: shpallje, kartolinë, letër shoqërore, ftesë, informim, duke respektuar drejtshkrimin dhe sintaksën,<br>• ripërdorimi në mënyrë korrekte i fjalëve dhe i</td><td>• të hartojë mesazhe të shkurtra: shpallje, kartolinë, letër shoqërore, ftesë, informim, duke respektuar drejtshkrimin dhe sintaksën,<br>• të ripërdorë në mënyrë korrekte fjalët dhe</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | shprehjeve të njohura<br>• kopjimi në mënyrë korrekte i fjalëve dhe i shprehjeve të përvetësuara më parë<br>• përshkrim i shkurtër i shkollës, i klasës, i shokëve, i mjedisit, i ndjenjave, i emocioneve,<br>• përshkrim i shkurtër i muzeut, i tregut, i bankës, i zyrës së turizmit, i postës, i shtëpisë së mallrave, i hotelit, i pishinës, i sheshit, i qytetit, i fshatit, i vendbanimit<br>• përshkrim i shkurtër fizik i një personi, duke përfillur rregullat drejtshkrimore dhe sintaksën | shprehjet e njohura,<br>• të kopjojë në mënyrë korrekte fjalët dhe shprehjet e përvetësuara,<br>• të përshkruajë shkurt shkollën, klasën, shokët, mjedisin, ndjenjat, emocionet,<br>• të përshkruajë shkurt vendet : muzeun, tregun, bankën, zyrën e turizmit, postën, shtëpinë e mallrave, hotelin, pishinën, sheshin, qytetin, fshatin, vendbanimin,<br>• të bëjë një përshkrim të shkurtër fizik të një personi, duke përfillur rregullat drejtshkrimore dhe sintaksën |

## Kategoria: 2.0. Kultura

| | **Përmbajtja e Programit** | **Rezultatet e pritura** |
|---|---|---|
| **2.1. Kultura frënge**<br><br>**2.2. Kultura shqiptare**<br><br>**2. 3. Frankofonia** | 1. Muzika, muzetë, ekspozitat artistike, panairet, sporti, mediat frankofone (shtypi, televizioni, radioja)<br>2. Radioemisionet shqipe në Francë, ekspozitat artistike, panairet e librit.<br><br>3. Mësimi i gjuhës frënge në mjediset shqiptare. | **Nxënësi është në gjendje:**<br>1. të njohë vlerat e kulturës dhe të artit francez (muzetë më të njohur, galeritë, titujt e gazetave, kanaleve televizive, radiostacioneve më të njohur),<br>2. të cekë ndonjë radiostacion në Francë që emeton program në gjuhën shqipe,<br>3. të cekë mjediset shqiptare ku mësohet gjuha frënge. |

## UDHËZIMET METODOLOGJIKE

### 1.0. PARIMET METODIKO-DIDAKTIKE

**Të mësosh një gjuhë do të thotë të mësosh për të komunikuar në atë mënyrë që të mund të përdorësh gjuhën në situata të jetës reale.** Shkathtësitë gjuhësore zënë vend parësor në mësimin e gjuhëve.

**1.1. Parimi i parë:** përqendrimi në komunikim dhe jo si deri më tani, përqendrimi kryesisht në gjuhë.

**1.2. Parimi i dytë:** përqendrimi në nxënësin dhe në nxënien e tij.

### 2.0. FORMA KOMUNIKATIVE E MËSIMDHËNIES

Komunikimi është forma më dobiprurëse në mësimdhënien dhe në nxënien e gjuhës së huaj. Me arsye i kushtohet sot kësaj qasjeje vëmendje e posaçme, sepse u mundëson nxënësve të shprehen në gjuhën frënge në situata të caktuara në jetën e përditshme.

Pikënisje e një mësimdhëniejeje të tillë nuk do të jetë rregulla gramatikore, por situata konkrete gjuhësore, d.m.th., nga situatat gjuhësore nxirren rregullat dhe jo anasjelltas.

### 3.0. METODAT E MËSIMDHËNIES

**3.1. Metodat që nxitin komunikimin janë:**

1 puna në çifte dhe në grupe,

2 debatet e rëndomta,

3 interpretimet e roleve në skeçe etj.,

4 intervistat e rëndomta.

**3. 2. Metodat që nxitin punën e pavarur:**

˜ tekste me vende të zbrazëta,

˜ lojërat e mësimit (të mbajturit mend),

˜ kontrollimi i ndërsjellë i detyrave me shkrim dhe i shprehjeve me gojë,

˜ mbledhja dhe përdorimi i pavarur i të dhënave nga burime të ndryshme,

˜ nxënia gjatë mësimdhënies (nxënësi merr rolin e mësuesit),

- letërkëmbime me persona në Francë dhe gjetiu në botë (partnerizimi i shkollave, letërkëmbime ndërmjet nxënësve tanë me ata francezë dhe të tjerë).

**3.3. Metodat që nxitin prodhimin:**

1. punimi i gazetave të murit, i pikturave, i posterëve, i teksteve (p.sh., për ekspozita, për gara të shkollës) dhe komentimi gojor i tyre,
2. shkrimi kreativ i poezive, i tregimeve të shkurtra, i nxitur përmes aktivizimit të njohurive paraprake, i provave, rrëfimi i ngjarjeve, përshkrimi i personave, i objekteve etj.

## 4.0. SHFRYTËZIMI I MEDIAVE

### 4.1. Televizioni, radioja

Televizioni dhe radioja janë mjete të dobishme dhe të përhershme që duhet të shfrytëzohen si nga arsimtari ashtu edhe nga nxënësit. Emisionet shkollore kushtuar gjuhës ose kulturës frënge, programet e filmit dhe ato të dramës në Kosovë dhe emisionet e ndryshme të televizioneve të jashtme në gjuhën frënge janë një mjet i fuqishëm që do të ndihmojë dhe do të shpejtojë përvetësimin e kësaj gjuhe të huaj nga nxënësit tanë.

### 4.2. Gazetat dhe revistat

Shfrytëzimi i gazetave dhe i revistave të ndryshme në gjuhën frënge, po ashtu, mund të ndihmojë shumë në lehtësimin dhe në përshpejtimin e përvetësimit të gjuhës frënge. Ato mund të shfrytëzohen në klasë dhe në shtëpi.

### 4.3. Filmi, teatri, muzika

Filmi, teatri dhe muzika përbëjnë mjete motivuese të rëndësishme për shtimin e rezultateve në përvetësimin e gjuhës frënge, ndonëse te ne ato nuk janë shfrytëzuar aq sa ka pasur mundësi. Kinemaja dhe teatri, bashkë me televizionin, tani e tutje do të luajnë një rol më të rëndësishëm në këtë aspekt.

### 4.4. Fotografitë dhe vizatimet

Fotografitë dhe vizatimet ndihmojnë për të sajuar tekste përshkruese kreative.

Nxënësit përshkruajnë gjërat e njohura dhe ato të pazakonshme që shohin në fotografi, në vizatim.

Ata tregojnë një ngjarje, fillimin ose mbarimin e së cilës e paraqet fotografia.

### 4.5. Materiali dëgjimor (disqet, kasetat)

Ky material mundëson ballafaqimin me frëngjishten standarde dhe nxit të kuptuarit përmes dëgjimit të materialeve dëgjimore.

Nxënësit gjejnë fillimin ose mbarimin e një teksti të shkurtër të dëgjuar më parë.Ata personifikohen me personazhet e një pjese teatrore të dëgjuar dhe diskutojnë për sjelljet e tyre.

### 4.6.1. Materiali pamor (videoprojektori)

Përdorimi i projektorit shton interesimin e nxënësve për mësim. Kjo arrihet me:

*1.* paraqitjen e fotografive, të vizatimeve, të tregimeve të ilustruara dhe të teksteve përmes fletëve dhe projektorit,
2. mbulimin dhe zbulimin e pjesërishëm të fotografisë,
3. paraqitjen me fotografi të një ngjarjeje pa renditje kronologjike,
4. paraqitjen e një teksti të ndarë në pjesë dhe të radhitur në mënyrë jo të rregullt dhe rregullimi i tij.

### 4.6.2. Videomateriali (videokasetat)

1. Përdorimi i videomaterialit u jep nxënësve mundësi të shumta për sajimin e teksteve me shkrim dhe me gojë.
2. Paraqitja e një filmi të punuar mbi bazën e një tregimi ose një përralle, që nxit krahasimin me tregimin apo me përrallën e lexuar ose të dëgjuar më parë.

## 5.0. RENDITJA E VEPRIMEVE

Shkathësitë gjuhësore janë shkathësi të integruara dhe nuk mund të ndahen. Megjithatë, për mësim të efektshëm të gjuhës së huaj është e nevojshme të respektohet kjo renditje: **të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit.** Kjo është një renditje logjike, respektimi i së cilës mundëson një mësimdhënie/nxënie më të shpejtë, më të lehtë dhe më cilësore të kësaj gjuhe të huaj.

### 5.1. Puna aktive dhe konkrete

Gjatë mësimit të gjuhës frënge në shkollat tona, mësimdhënësit duhet të kenë parasysh kushtet dhe rrethanat tona (si një mjedis jofrankofon) që dallohen nga ato të Francës.

**5.2. Ushtrimet dhe zbatimi i tyre**

Rëndësi e veçantë duhet t`u kushtohet ushtrimeve, varësisht nga llojet e tyre. Ato mund të bazohen në të dëgjuar, në të shikuar dhe në të shkruar.

## 6.0. KORRIGJIMI I GABIMEVE TË NXËNËSVE

Mënyrat e korrigjimit diskutohen shpesh dhe në mënyrë kundërthënëse në rrethin e mësimdhënësve. Disa i shohin gabimet si pengesë në procesin e mësimdhënies, të tjerët i shohin si ndihmesë në përvetësimin e gjuhës së huaj. Ndërkaq, disa prej tyre mendojnë se ato duhet të korrigjohen menjëherë që të mos përvidhen, të tjerët mendojnë se nuk duhet të korrigjohet, me çdo kusht, çdo gabim. Sido që të jetë, në fazën e komunikimit gjuhësor, p. sh., gjatë përshkrimit të një fotografie, mësimdhënësit praktikojnë të shprehurit e lirë të nxënësve të tyre. Gjatë korrigjimit të gabimeve nxënësin nuk duhet ndëshkuar, qortuar apo kritikuar për gabimet e bëra. Kjo mund të mënjanohet përmes punës grupore: të kontrolluar, gjysmë të kontrolluar dhe të lirë.

## 7.0. MËSIMDHËNIA / NXËNIA E DIFERENCUAR DHE E INDIVIDUALIZUAR

Një përmbajtje mësimore duhet përshtatur nevojave individuale të nxënësve me prirje dhe aftësi të veçanta. Asnjë klasë nuk ka përbërje homogjene nxënësish sa u përket njohurive të tyre paraprake. Këtë duhet ta ketë parasysh çdo mësimdhënës dhe të organizojë orën në bazë të kësaj. Kjo nënkupton që nxënësit që kanë aftësi për nxënie më të shpejtë të trajtohen ndryshe nga të tjerët, në mënyrë që mësimi i gjuhës frënge të jetë në përputhje me mundësitë dhe aftësitë individuale të secilit nxënës.

## 8.0. TEKNIKAT E PUNËS

Një ndër detyrat e mësimdhënies së gjuhës së huaj është edhe aftësimi i nxënësve që të punojnë në mënyrë të pavarur (duke konsultuar fjalorin, literaturën e nevojshme dhe materiale të tjera) dhe të marrin përgjegjësinë për të mësuarit individual. Nxënësit të cilët kanë mundësi për të menduar për proceset e nxënies, për organizimin e procesit të mësimdhënies dhe të të mësuarit në grup, zakonisht, arrijnë sukses më të mirë. Në këtë mënyrë, ata, përveç të tjerash, mund të përgatiten që të

reagojnë në mënyrë të pavarur në situatat shkollore dhe jashtëshkollore, si dhe të vazhdojnë proceset e mësimit të gjuhës.

## 9.0. LIDHJET NDËRPROGRAMORE

Mësimi i një gjuhe të huaj, sidomos në klasat e larta, ofron mundësi të shumta për lidhje ndërprogramore, në të gjitha nivelet. Këto lidhje përfshijnë shumë lëmenj (lëndë mësimore), sidomos ato të gjuhëve (të gjuhës amtare dhe të gjuhës së huaj të parë); të shkencave shoqërore (edukatën qytetare, historinë, gjeografinë, etj.); të arteve të llojeve të ndryshme; por edhe të shkencave të natyrës. Në këtë mënyrë, nxënësit, përmes njohurive nga lëndët e tjera, në njërën anë ndihmohen në përvetësimin më të suksesshëm të gjuhës frënge, në anën tjetër, përmes njohurive nga gjuha frënge, ata i zgjerojnë dhe i përforcojnë njohuritë e tyre paraprake nga lëndët e tjera.

# VLERËSIMI

## 1.0. LLOJET E VLERËSIMIT NË ORËN E GJUHËS FRËNGE

### 1.1. Vlerësimi diagnostik ka për qëllim:

1. Të identifikojë vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit dhe të ndërmjetësojë në tejkalimin e tyre;
2. Të kontrollojë njohuritë e nxënësve,

### 1.2. Vlerësimi i jashtëm ka për qëllim:

1. të vlerësojë përparimin e nxënësit,
2. të identifikojë rezultatet e arritura, si dhe ngecjet e nxënësit.
3. të vlerësojë njohuritë e nxënësve, të vërtetohet se njohuritë e fituara mjaftojnë që nxënësi mund të kalojë në klasën vijuese.

### 1.3. Vlerësimi formativ ka për qëllim:

- t`i mundësojë nxënësit të identifikojë rezultatet e arritura si dhe ngecjet e veta dhe të angazhohet në tejkalimin e vështirësive.

2.0. ÇFARË DUHET TË VLERËSOHET?

**2.1. Njohuritë e fituara të nxënësve,**
**2.2. Përparimi i nxënësve në përvetësimin e gjuhës frënge:**

- vlerësimi i zhvillimit të nxënies,
- shkalla e zotërimit.

**2.3. Integrimi i njohurive të fituara:**

- Vlerësohen projektet dhe aktivitetet jashtëshkollore.

3.0. SI DUHET TË VLERËSOJMË?

**3.1. Mënyrat e vlerësimit nga profesori: kontrolli i vazhdueshëm:**

a) Vlerësimi i drejtpërdrejtë.

b) Vlerësimi i tërthortë.

**3.2. Vlerësimi nga nxënësit (vlerësim i njëri-tjetrit).**
**3.3. Vetëvlerësimi i nxënësve.**

4.0. LLOJET E TESTEVE:

**4.1. testi i vetëkontrollit,**
**4.2. testi për vlerësim,**
**4.3. testi i përparimit,**
**4.4. testi përfundimtar.**

***Shënim: Pjesëve të programit, që objektivisht mund të paraqesin vështirësi përvetësimi për nxënës, mësimdhënësi duhet t'u kushtojë rëndësi të veçantë gjatë mësimdhënies dhe me rastin e vlerësimit të njohurive të tyre.***

## LITERATURA DHE MJETET E NEVOJSHME

Për realizim më të suksesshëm të përmbajtjeve programore për këtë klasë, mësimdhënësi duhet të ketë literaturën profesionale dhe mjetet e nevojshme: librin dhe fletoren e ushtrimeve për nxënësin, librin e vet, doracakë didaktiko-metodikë për gjuhën frënge; kabinetin për gjuhë të huaja, fjalorë (dygjuhësh dhe njëgjuhësh), gramatikën e gjuhës frënge, audiokasetat ose CD-të e metodës, videokasetat, kasetofonin, videon, televizorin, CD me muzikë frënge, gazeta, revista të ndryshme në gjuhën frënge.

# GJUHË GJERMANE

**(2 orë në javë, 74 orë në vit)**

## HYRJE

Tanimë dihet se njohja e gjuhëve të huaja krijon hapësirë dhe liri më të madhe të lëvizjes, e me këtë edhe vetëbesim dhe është një ndër kushtet kryesore të kualifikimit për tregun botëror të punës, njëkohësisht është edhe kusht paraprak për njohjen me kulturat e tjera.

Me ndryshimet e fundit në Kosovë u hapën edhe mundësitë e kontaktimit më të lirë me Evropën, e me këtë u krijuan edhe mundësitë për mësimin më të lehtë të gjuhëve të huaja.

Për shkak të migrimeve të shumta në vendet gjermanofolëse, në një mënyrë janë krijuar edhe lidhjet me gjuhën dhe kulturën gjermane. Aq më shumë që tani me reformat e fundit të ndërmarra nga Ministria e Arsimit gjuha gjermane do të jetë gjuhë e dytë obligative e jo më zgjedhëse, qysh nga klasa e gjashtë e vazhdon deri në klasën e dymbëdhjetë a po të trembëdhjetë, varësisht nga profili i shkollës së mesme.

Të gjitha këto janë arsye që mësimdhënia moderne e gjuhëve të huaja duhet t'u ofrojë të rinjve shkathtësitë dhe njohuritë e duhura për një botë shumëgjuhëshe, të cilat ua bëjnë të mundur atyre të jenë të aftë të veprojnë edhe jashtë kufijve të gjuhës së tyre amtare.

Arsye të gjitha këto që mësimin e gjuhës gjermane në klasën e **nëntë** ta shohim si një vazhdimësi të asaj që është mësuar në klasat paraprake dhe një shkallë më tutje drejt përsosjes së njohurive të marra, qoftë edhe si ndihmë gjatë mësimit të gjuhëve të tjera të huaja.

## QËLLIMET

Qëllimi i mësimit të gjuhës gjermane në klasën e **nëntë** është:

1. të avancojë njohuritë e fituara në klasën e tetë, njohuri të cilat te nxënësi ngritin aftësitë e tij komunikuese, vetëdijesimin e tij kulturor e gjuhësor,
2. të zhvillojë në vazhdimësi shkathtësitë receptive dhe produktive të nxënësit si në të folur ashtu edhe në të shkruar dhe përdorimi i tyre në situata të ndryshme gjuhësore në mjedisin shkollor apo gjatë kontaktit me persona të hapësirës gjermanofolëse,
3. t'u mundësojë nxënësve të fitojnë dijeni për qytetërimin gjerman (për kulturën, traditën, historinë, gjeografinë, politikën e ekonominë e tyre) dhe njohuritë e fituara paraprakisht t'i përdorin në krahasimin e kulturës dhe të traditës vetjake me atë gjermane.
4. t'i mësojë nxënësit që strategjitë e fituara gjatë të mësuarit të gjuhës gjermane t'i zhvillojnë më tutje në mënyrë të pavarur si dhe t'i zbatojnë ato gjatë të mësuarit të gjuhëve të tjera të huaja.

| OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM | OBJEKTIVAT SPECIFIKË |
|---|---|
| **Nxënësi duhet të jetë në gjendje**:<br>I. Të kuptojë raporte e referate më të gjata dhe ndonjë argumentim më kompleks, kur behët fjalë për ndonjë temë pak a shumë të njohur. Ai, po ashtu, duhet të jetë në gjendje të kuptojë në TV shumicën e emisioneve informative dhe reportazhe aktuale, të kuptojë shumicën e filmave, nëse flitet gjuha standarde. | **Nxënësi duhet të jetë në gjendje:**<br>I.1.të kuptojë fjali dhe shprehje që kanë të bëjnë me jetën e tij të përditshme;<br>I.2. të kuptojë një bisedë apo edhe një argumentim, kur përdoret gjuha e qartë standarde, e ka të bëjë me tema pak a shumë të njohura për të;<br>I.3. të nxjerrë informatat nga ndonjë emision në radio apo TV, kur kanë të bëjnë me fushat e tij të interesit;<br>I.4. të kuptojë atë që kërkohet e të përgjigjet drejt në situatat e ndryshme në të cilat mund të hasë gjatë udhëtimeve në vendet gjermanofolëse; |
| II. Të lexojë dhe të kuptojë artikuj dhe raporte rreth problemeve aktuale (në të cilat shkruesit përfaqësojnë një qëndrim të caktuar). Po ashtu, duhet të jetë në gjendje ta | II.1. të lexojë dhe të kuptojë tekste të njohura dhe më pak të njohura;<br>II.2. të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të pavarur tekste argëtuese përkatësisht informative, të një vëllimi të konsiderueshëm; |

| | |
|---|---|
| kuptojë prozën bashkëkohore letrare. | II.3. të lexojë dhe të kuptojë tekste të përshtatura për nivelin e tij të nxënies, në mënyrë që ato të mund të përdoren gjatë të shprehurit me shkrim dhe me gojë (p.sh. të përgjegjurit në pyetje, vlerësimi i të shprehurit/ i mendimit); Këto tekste mund të përmbajnë edhe mjete të panjohura gjuhësore, kuptimi i të cilave mund të nxirret nga konteksti;<br>II.4. të lexojë dhe të kuptojë tekste të prozës bashkëkohore; |
| III. Të merret vesh gjatë bisedave spontane që do t'i bënte të mundur zhvillimin e një bisede normale me një gjermanofolës. Ai, po ashtu, duhet të jetë në gjendje që, në situata të njohura (gjuhësore), të marrë pjesë aktivisht në diskutim dhe të arsyetojë e të mbrojë qëndrimet e veta, si dhe të shprehet në mënyrë të qartë dhe të detajizuar për shumë tema që i interesojnë atij, apo të sqarojë qëndrimet e tij rreth ndonjë çështjeje aktuale dhe të diskutojë për përparësitë e mangësitë. | III.1. të raportojë për ndodhi<br>III.2. të përshkruajë ngjarje, procese dhe gjësende<br>III.3 të japë një mesazh përmbajtësor<br>III.4. të paraqesë gojarisht dhe me shkrim ndodhitë apo përjetimet<br>III.5. të raportojë për të ardhmen apo për diçka të imagjinuar. |
| IV. Të shkruajë tekste të qarta dhe të detajizuara për tema të ndryshme që e interesojnë. Po ashtu, ai duhet të jetë në gjendje, në një hartim apo në raport, të paraqesë informata apo argumente dhe kundër-argumente për ose kundër një pikëvështrimi të caktuar, si dhe të shkruajë letra dhe në to të sqarojë qëndrimet personale rreth çështjeve të ndryshme. | IV.1. të shkruajë drejt tekste gjatë diktimit;<br>IV.2. të shfaqë siguri gjatë të shkruarit të teksteve të hartuara vetë sa u përket rregullave të shkrimit të gjuhës gjermane, si dhe rregullave të pikësimit<br>IV.3. të paraqesë me shkrim përjetime personale, ngjarje, procese ose rrethana për të cilat është diskutuar gjatë procesit mësimor; |

| | |
|---|---|
| V. Të shqiptojë fjalët mjaft kuptueshëm, edhe pse vërehet qartë një theks i huaj e ndonjëherë fjalët shqiptohen gabimisht. | V.4. të përshkruajë me fjalë të veta përmbajtjen e një tregimi me fotografi, të një filmi, libri, pjese teatrale etj;<br>IV.5. gjatë hartimit të një teksti të sqarojë qëndrimet e veta rreth një çështjeje e të paraqesë argumente e kundërargumente;<br>V.1. të shqiptojë kuptueshëm, të dijë vendin e theksit të fjalëve dhe të fjalive; V.2. të dallojë zanoret e shkurtra dhe të gjata; |
| VI. Që me një spektër të gjerë të mjeteve gjuhësore të përshkruajë situata të paparashikuara; aspektet kryesore të një mendimi apo të një problemi t'i shpjegojë me një saktësi të mjaftueshme dhe të shprehë qëndrimet e veta rreth temave kulturore (si muzika dhe filmi). | VI.1. prej një vokabulari mjaft të gjerë, të cilin tanimë e zotëron, të gjejë përshkrime me ndihmën e të cilave do të mund të shprehet rreth shumicës së temave nga jeta e vet e përditshme, p.sh., familja, hobit, interesat, puna, udhëtimet, ndodhitë aktuale;<br>VI.2. gjatë të folurit, saktësia e përdorimit të vokabularit të jetë në përgjithësi e lartë, edhe pse mund të bëhet zgjedhja e gabuar e ndonjë fjale ose ngatërrimi i fjalëve, por pa e penguar komunikimin.<br>VI.3. të përdorë fjalësin (vokabularin) prej rreth 1500 fjalëve aktive, i cili është i domosdoshëm për përpunimin e detyrave që janë të lidhura ngushtë me katër shkathtësitë gjuhësore;<br>VI.4. të dijë rregullat e fjalëformimit dhe përmes tyre pavarësisht të zgjerojë vokabularin; |
| VII. Të zotërojë mjaft mirë gramatikën; jo shumë shpesh mund të paraqiten rrëshqitje të rastësishme ose gabime josistematike dhe mangësi të vogla në ndërtimin e fjalisë, të cilat është në gjendje t'i korrigjojë, kur të mendojë | VII.1. t'i njohë strukturat gjuhësore të përpunuara gjatë mësimit, sepse kjo duhet t'i ndihmojë atij që: - të kuptojë tekstet e shkruara dhe të folura, - t'i bëjë atij të mundur një prodhim gjuhësor kreativ, - të zhvillojë një bisedë spontane, me ç'rast mund të ketë mëdyshje rreth zgjedhjes së strukturave |

| | |
|---|---|
| sërish për to. | ose fjalëve, dhe të krijohen pushime ndërmjet fjalive, - ta nxisë përdorimin e pavarur të mjeteve ndihmëse gramatikore; |
| VIII. Të dijë informacione për mënyrën e jetesës dhe të menduarit, zhvillimet kulturore, politike, ekonomike, historike, pozitën gjeografike apo preokupimet aktuale të popujve gjermanofolës, njohja me problemet e mjedisit, gjithnjë duke u munduar t'i krahasojë me kulturën vetjake. | VIII.1. të ketë një ide rreth mënyrës së jetesës së popujve gjermanofolës, qoftë duke a) njohur karakteristikat e jetës kulturore e sociale të të rinjve në vendet gjermanofolëse, posaçërisht nën aspektet e Gjermanisë së ribashkuar, b) duke treguar aftësi dhe gatishmëri të merret me gjeografinë, ekonominë, politikën, historinë e kulturën e vendeve gjermanofolëse dhe të bëjë krahasime me ato të vendit të vet, c) duke njohur dukuritë dhe problemet e mjedisit në rrafshin ndërkombëtar dhe të përgjithshëm si dhe veprimet dhe mundësitë e mbrojtjes së mjedisit. |

## PLANIFIKIMI I PËRMBAJTES PROGRAMORE

| **Kategoritë** | **Nënkategoritë** |
|---|---|
| I. Komunikimi | 1. Shkathtësitë perceptuese<br>a) të dëgjuarit<br>b) të lexuarit<br>2. Shkathtësitë produktive:<br>c) të folurit<br>d) të shkruarit |
| II. Formimi gjuhësor | 1. Dallimi dhe përdorimi i fonemave të gjuhës gjermane<br>2. Kuptimi dhe përdorimi i vokabularit lidhur me temat e caktuara për nivelin e dytë<br>3. Përdorimi i strukturave gjuhësore |
| III. Vetëdijesimi kulturor | 1. Njohja me kulturën e popujve gjermanofolës dhe krahasimi me kulturën e vet |

| Kate-goritë | Nënkategoritë | Përmbajtja programore | Rezultatet e pritshme |
|---|---|---|---|
| **I.**<br>K<br>O<br>M<br>U<br>N<br>I<br>K<br>I<br>M<br>I | I.1.<br>shkathtësitë receptuese<br><br>a) të dëgjuarit<br><br>b) të lexuarit<br><br>I.2.<br>shkathtësitë produktive:<br><br>a) të folurit<br><br>b) të shkruarit | **1. Përvojat themelore jetësore**<br>• Katastrofat natyrore<br>• Dhuna<br><br>**2. Identiteti personal**<br>• Miratimi/pohimi i jetës<br>• Qëndrimi ndaj jetës<br>• Ndryshimet gjatë rritjes<br>• Bota e të rinjve dhe e të rriturve<br>• Vetëdijesimi për rolin në shoqëri<br><br>**3. Raportet mes çifteve**<br>• Seksualiteti<br>• Përkrahja e partnerit<br>• Dëshpërimet<br>• Ndarjet<br><br>**4. Përditshmëria dhe familja**<br>• Rëndësia/vlera e familjes në shoqëri<br>• Planifikimi i së ardhmes<br>• Mënyra e jetesës<br><br>**5. Individi dhe shoqëria** | I.1.a) **Nxënësi mund:**<br>A. Të kuptojë shprehje autentike nga ata të cilët gjuhën gjermane e kanë gjuhë amtare<br>A.1. tekste të dëgjuara nga libri shkollor,<br>A.2. tekste të dëgjuara që nuk lidhen drejtpërdrejt me tekstet e librit shkollor, por mjetet gjuhësore të të cilave mund të nxirren nga konteksti, p.sh.: regjistrime me zë, incizime të ndryshme të bisedave, të diskutimeve e të intervistave rreth temave të njohura<br>A.2. pjesë të shkëputura nga shfaqje teatrale, që kuptohen lehtë<br>A.3. këngë të muzikës së lehtë,<br>A.4. reportazhe televizive dhe radiofonike për udhëtimet ose ngjarjet sportive<br>A.5. filma dokumentarë (p.sh., për kafshët).<br><br>B. Të kuptojë informacionet thelbësore nga tekstet autentike nga mediat, p.sh.: emisionet informative në radio ose në televizion, për kuptimin e të cilave është e nevojshme njohja e fjalëve kyçe.<br><br>C. Të kuptojë kumtesa (gojore) dhe të reagojë arsyeshëm në to, nëse situata e bisedës është e re.<br><br>D. Të kuptojë dhe të zhvillojë më tutje fjalësin |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | • Pozita personale në shoqëri<br>• Qëndrimi personal ndaj shoqërisë<br>• Kontradiktat në shoqëri<br>• Shoqëria e hapur<br><br>**6. Banimi**<br>• Ndryshimet e banimit të mëparshëm ( shpërngulja, rindërtimi, restaurimi)<br>• Njohja e një mjedisi të ri (shkëmbimi i nxënësve)<br>• Të banuarit në një planet tjetër<br><br>**7. Edukimi**<br>• Zhvillimi drejt personalitetit autonom dhe madhor (i rritur)<br>• Ndikimet civilizuese në edukim (filmat, Televizionet, mediat)<br>• Sistemi shtetëror i shkollimit në Gjermani<br>• Të mësuarit dhe të punuarit e pavarur<br><br>**8. Puna**<br>• Synimet profesionale<br>• Teknika dhe arritjet<br>• Bujqësia dhe industria | perceptues, i cili shpie drejt të kuptuarit e bashkëbiseduesve gjermanofolës në situata komplekse të bisedave (jo të njohura më parë).<br><br>I.1.B) Nxënësi mund:<br>A. të lexojë tekste të njohura dhe tekste të thjeshta të panjohura me shqiptim të mirë dhe të kuptueshëm :<br>A.1. tekste nga libri shkollor,<br>A.2. pjesë nga tekste dramatike<br>A.3. tekste autentike nga gazetat<br>A.4. vjersha, tekste letrare<br><br>B. të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të pavarur tekste argëtuese (të trilluara), përkatësisht informative:<br>B.1. tekste nga libri shkollor<br>B.2. tregime, rrëfime të shkurtra, tregime të thjeshtësuara kriminale<br>B.3. tekste aktuale, posaçërisht tema relevante nga lëmi i qytetërimit gjerman<br>B.4. tekste profesionale më të thjeshtësuara p.sh., nga lëmi i biologjisë apo i gjeografisë<br>C. të lexojë tekste të panjohura dhe me këtë rast të përmbledhë thëniet kryesore<br>C.1. tekste nga libri shkollor<br>C.2. tekste të thjeshtësuara nga revistat, të ilustruarat dhe revistat gjuhësore. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | • Shumëllojshmëria e punës në industrinë e shoqërisë moderne<br>• Shërbimet<br><br>**9. Furnizimi**<br>• Të ushqyerit e shëndetshëm<br>• Të qenët në formë<br>• Furnizimi me energji<br><br>**10. Kujdesi shëndetësor**<br>• Të jetuarit e shëndetshëm<br>• Konsumimi i drogës (alkooli, nikotina, droga etj.)<br><br>**11. Koha e lirë**<br>• Të udhëtuarit në vende të tjera<br>• Planifikimi i pushimit<br>• Shkuarja në restaurant<br>• Teatri<br>• Koncertet<br><br>**12. Sporti**<br>• Loja e drejtë/Dopingu<br>• Rëndësia e sportit në shoqëri<br><br>**13. Njeriu dhe natyra** | D. tekste, të cilat përmbajnë gjithashtu edhe mjete të panjohura gjuhësore, t'i kuptojë ato ashtu që gjatë të shprehurit me gojë (përgjigje në pyetje, përshkrime etj.) dhe me shkrim të mund t'i përdorë ato.<br>D.1. tekste nga libri shkollor<br>D.2. tekste letrare, lirike dhe tekste të thjeshta dramatike<br><br>I.2.a) Nxënësi mundet:<br>A.1. të marrë dhe të japë informata<br>A.2. të interesohet për një çështje sipas përgjegjësive<br>A.3. t'i pyesë të rriturit për përvojat e tyre jetësore<br>A.4. të pyesë për kalimin e kohë së lirë: disko, teatër, kino, të japë informacione për to<br>A.5. të pyesë për mundësitë e udhëtimit nëpër Gjermani<br>A.6. të pyesë informohet për libra (në bibliotekë)<br>A.7. të marrë informata për ofertat për shkollim, p.sh., në Institutin Goethe<br><br>A.8. të përshëndesë dhe të paraqesë / shpjegojë<br>A.8.1. të përdorë nivele të ndryshme të të shprehurit stilistik në biseda me të rriturit dhe me moshatarët e tij<br>A.9. të raportojë për problemet ndërnjerëzore, për një udhëtim<br>A.10. të përshkruajë shfrytëzimin e kohës së lirë të të rinjve<br>A.11. të gjykojë, të përshkruajë dhe të argumentojë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | • Përgjegjësia e shoqërisë për ruajtjen e natyrës<br>• Masat e ndërmarra për ruajtjen e saj<br>• Hulumtimi i natyrës<br>• Katastrofat natyrore<br>• Njeriu - pjesë e natyrës<br><br>**14. Lëvizshmëria dhe trafiku**<br>• Trafiku - pjesë e shoqërisë përparimtare<br>• Lëvizshmëria - dëmtues i mjedisit<br><br>**15. Komunikimi**<br>• Gjermanishtja - gjuhë e huaj<br>• Shumëllojshmëria gjuhësore në Evropë<br>• Rëndësia e njohjes së gjuhëve të huaja<br>• Të dalluarit e disa dialekteve gjermane<br><br>**16. Shkenca dhe teknika**<br>• Hulumtuesit e natyrës dhe zbulimet e tyre<br>• Eksperimentet e thjeshta kimike<br>• Përdorimi i kompjuterit | mënyrën e sjelljes dhe të veprimit të njerëzve<br>A.12. të zhvillojë një bisedë, të përgjigjet në pyetjet e të tjerëve, t'i lusë të tjerët, të përsërisë pyetjen e tjetrit, që të fitojë kohë etj.<br>A.13. të zhvillojë biseda telefonike me persona të njohur dhe të panjohur për raste të ndryshme<br><br>B. të përdorë me vend mjete gjuhësore në biseda, diskutime (të pyes dhe të bëjë kundërpyetje, të miratojë, të argumentojë etj.)<br>C. të marrë pjesë në diskutime të ngadalshme dhe aktuale.<br><br>I.2.b) Nxënësi duhet:<br>A. të përshkruajë drejt fjali e tekste të shkurtra ose pjesë tekstesh nga teksti shkollor apo nga tekste leximi<br><br>B. të ketë siguri në fushën e drejtshkrimit gjerman (duke përfshirë edhe shenjat e pikësimit)<br><br>C. të përpunojë idetë e tij personale, mendimet dhe vështrimet e tij në tekstet vijuese:<br>C.1. në letra, letra të lexuesve<br>C.2. tregime, në formimin e një tregimi<br>C.3. në biografi etj.<br><br>D. të shpjegojë me fjalë të tij përmbajtjen e ngjarjeve |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | • Teknika në përditshmëri, në komunikacion, në mjekësi, në lëmenj të tjerë etj. | me fotografi, kartonë, filma vizatimorë<br>E. të përdorë shprehje profesionale, p.sh. Strofe, Reim, Verszeile, Metapher. |
| II.<br>F<br>O<br>R<br>M<br>I<br>M<br>I<br><br>GJ<br>U<br>H<br>Ë<br>S<br>O<br>R | II.1.Dallimi dhe përdorimi i fonemave të gjuhës gjermane<br><br><br><br><br>II.2. Kuptimi dhe përdorimi i vokabularit lidhur me temat e caktuara për klasën e trembëdhjetë | • Präteritum<br>• Fjalitë e varura me *als*<br>• Mbiemrat e përbërë<br>• Paravendosje dhe prapavendosja e mbiemrit (prädikative und attributive Stellung)<br>• Të thënat e vendit dhe të kohës<br>• Diateza pësore në kohën e tashme (Vorgangsspassiv Präsens)<br>• Diateza pësore në kohën e tashme (Zusatndsspassiv Präsens)<br>• Emërzimi i foljeve dhe i mbiemrave (Substantivierung)<br>• Gjinorja e emrave<br>• Diateza pësore në kohën e pakryer dhe të kryer (Vorgangsspassiv Präteritum und Perfekt)<br>• Infinitivsätze<br>• Mbiemrat në prapavendosje (Attributive Stellung)<br>• Mbiemrat me prapashtesa (-lich,-bar) | II.1.1. Nxënësi duhet:<br>A. 1. ta ketë të qartë lidhjen fonemë-grafemë,<br>A.2. të shqiptojë kuptueshëm dhe qartë (edhe pse pak a shumë mund të vërehet theksi) fonemat e gjuhës gjermane (aq sa i përshtatet nivelit të tij të nxënies),<br>A.3. të shqiptojë kuptueshëm pyetjet, lutjet, miratimet, refuzimet, dyshimet etj.<br>B. t'i dallojë gjatë shqiptimit zanoret e gjata dhe të shkurtra<br><br>II.2.1. Nxënësi duhet:<br>A.1. të zotërojë një vokabular themelor (por ende bën gabime *elementare*) për të treguar ngjarje pak më komplekse, ose për t'u shprehur për tema dhe situata më pak të njohura<br>A.2. të përdorë fjalët dhe fjalitë në kontekstin e duhur si në të folur ashtu edhe në të shkruar<br>A.3. të përdorë vokabularin me rreth 1600 fjalë aktive si në të shkruar ashtu edhe në të folur<br>A.4. të dijë, në bazë të njohurive për rregullat e fjalëformimit, ta zgjerojë vetë vokabularin<br>A5. të aftësohet ta zgjerojë vokabularin aktiv nëpërmes detyrave sistematike të zgjerimit të vokabularit, si gjatë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | II.3. Përdorimi i strukturave gjuhësore | • Emërzimi (Nominaliseirung)<br>• Koha e ardhme (Futur I)<br>• Lidhorja e foljeve ndihmëse haben dhe sein (Konjunktiv II)<br>• Lidhorja me formën würde + Infinitiv (Konjunktiv II)<br>• Ligjërata e zhdrejtë (Konjuktiv I)<br>• Fjalitë e varura me w*enn* | orës së mësimit ashtu edhe në shtëpi:<br>A.6. të zgjerojë vokabularin e njohur përmes:<br>• Parashtesave ( Präfixe)<br>• Prapashtesave ( Suffixe<br>• Verbzusatz/Verbergänzungen<br>• Ndryshimit të pjesëve të ligjëratës (Wortartenwechsel)<br><br>II.3.1.Nxënësi mund:<br>A.1. të përdorë foljet, të cilat përdoren si folje modale (p.sh. *lassen, hören* etj); të përdorë Infiniv Präsens Passiv me foljet modale ( Në fjalinë kryesore *Hauptsatz)* p.sh. " muss gewechselt werden"; të përdorë pësoren (Passiv) ne Präsens (koha e tashme), në Präteritum (e pakryera) dhe në Perfekt (e kryera); të dijë listën e foljeve të parregullta; të përdorë foljet me kundrinën në dhanore (*Dativ-Objekt, ähneln, antworten, ausweichen, befehlen, danken, einfallen, erwidern, fehlen, folgen, gefallen, gehören, gehorchen, gelingen, glauben*) ; të përdorë foljet me kundrinë parafjalore si dhe lidhjen e fjalisë kryesore me atë të varur; të përdorë foljet kalimtare dhe jokalimtare që dallohen vështirë *( p.sh. stellen, legen etj, që lidhen me parafjalët e vendit dhe të drejtimit)*; të përdorë *lassen + Infinitiv* ;<br><br>A.2. të përdorë të gjitha foljet modale, *dürfen, können, mögen, müssen, sollen, wollen* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | A.3. të dijë të gjitha mundësitë e shumësit të emrit<br><br>A.4. të përdorë përemrat lidhorë (Relativpronomen) në njëjës dhe në shumës në të gjitha rasat dhe pas parafjalëve; të përdorë përemrat e pacaktuar (Idefinitpronomen) *jeder, jemand, niemand, man, etwas, nichts*<br>A.5. të dijë lakimin e mbiemrit në të gjitha rasat<br>A.6. të përdorë parafjalët me të gjitha rasat<br>A.7. të dijë ndajfoljet kryesore të cilat e kërkojnë dhanoren; të dijë ndajfoljet kryesore të cilat e kërkojnë kallëzoren; të dijë ndajfoljet kryesore të cilat kërkojnë parafjalë të caktuara<br>A.8. të dijë llojet e fjalive të varura; të dijë të përdorë fjalitë lidhore (në gjinore, me parafjalë dhe me *„wo-„);* të përdorë ndajshtimet; të përdorë konstruksione alternative për fjalitë e varura; të përdorë formime prejpjesore; të përdorë pësoren në kohë të tjera; të përdorë fjali të varura në pësore me folje modale; të dijë të vendosë përemrin vetvetor; të dijë formën e fjalisë pas lidhëzave (*Und, aber , denn ,oder, sondern)*; të dijë vendin e kryefjalës (kur heqet kryefjala pas përdorimit të lidhëzës *und*) ; të dijë pozitën e pjesëve të kallëzuesit; të formojë fjali Satzreihen und Satzgefüge; të dijë të lidhë fjalinë kryesore me atë të varur<br>A.9. të përdorë drejt shenjat e pikësimit gjatë përshkrimit. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| III.<br><br>V<br>E<br>T<br>Ë<br>D<br>I<br>J<br>Ë<br>S<br>I<br>M<br>I<br><br>K<br>U<br>L<br>T<br>U<br>R<br>O<br>R | III.1. Të njohurit me kulturën e popujve gjermanofolës dhe krahasimi me kulturën e vet | **Përditshmëria dhe familja**<br>• Rëndësia/vlera e familjes në shoqëri<br>• Planifikimi i së ardhmes<br>• Mënyra e jetesës<br>**Raportet mes çifteve**<br>• Seksualiteti<br>• Përkrahja e partnerit<br>• Dëshpërimet<br>• Ndarjet<br>**Edukimi**<br>• Zhvillimi drejt personalitetit autonom dhe madhor (i rritur)<br>• Ndikimet civilizuese në edukim (filmat, televizionet, mediat)<br>• Sistemi shtetëror i shkollimit në Gjermani<br>• Të mësuarit dhe të punuarit e pavarur<br>**Koha e lirë**<br>• Të udhëtuarit në vende të tjera<br>• Planifikimi i pushimit<br>• Shkuarja në restaurant<br>• Teatri - Koncertet | III.1. Nxënësi mund:<br>A.1. të dijë për mënyrën e jetesës së një familjeje gjermane, organizimin brenda familjes dhe planifikimin e së ardhmes<br>A.2. të dijë për raportet ndërpartnerore si dhe për problemet e shumta të cilat shpesh shkaktojnë ndarjen e çifteve<br>A.3. të dijë për sistemin shkollor në vende të ndryshme gjermanofolëse, të njohë llojet e shkollave, mundësitë për studim<br>A.4. të dijë për zhvillimet historike, të njohë periudhat letrare si dhe ekzistimin e tyre, përfaqësuesit më të rëndësishëm të një periudhe letrare etj.<br>A.5. të dijë për aktivitetet brenda dhe jashtë institucioneve shkollore, shfrytëzimi i bibliotekave në shkollë dhe përmes internetit etj.<br>A.6. të dijë për kohën e lirë brenda dhe jashtë shkollës, organizimin e aktiviteteve të ndryshme nga ana e udhëheqësisë së shkollës. |

| 4. LERNJAHR | |
|---|---|
| **Lernziel 1** | **Lerninhalte** |
| **Über Ereignisse berichten** | **Thematische Schwerpunkte**<br>• Sachverhalte<br>• Ereignisse<br>• Schulveranstaltungen<br>• Beobachtungen bei Unterrichtsgängen<br>**Grammatik**<br>✓ Präteritum<br>✓ Nebensätze mit *als* |

| 4. LERNJAHR | |
|---|---|
| **Lernziel 2** | **Lerninhalte** |
| **Gegenstände und Vorgänge beschreiben** | **Thematische Schwerpunkte**<br><br>Beschreibung von<br>• Personen<br>• Tieren<br>• Gegenständen<br>**Grammatik**<br>✓ Zusammengesetzte Adjektive<br>✓ Adjektive in prädikativer und attributiver Stellung<br>✓ Orts- und Zeitangaben |

| 4. LERNJAHR | |
|---|---|
| **Lernziel 3** | **Lerninhalte** |
| **Tätigkeiten und Vorgänge beschreiben** | **Thematische Schwerpunkte**<br>• Spiel- und Bastelanleitungen<br>• Gebrauchsanweisungen<br>• Kochrezepte<br>• Versuche beschreiben<br>**Grammatik**<br>✓ Vorgangspassiv im Präsens<br>✓ Zustandspassiv im Präsens<br>✓ Substantivierung von Verben und Adjektiven<br>✓ Genitiv von Nomen |

| 4. LERNJAHR | |
|---|---|
| **Lernziel 4** | **Lerninhalte** |
| **Mitteilungen sachlichen Inhalts machen** | **Thematische Schwerpunkte**<br>• Veranstaltungen<br>• Besichtigungen<br>• Lokale Feste<br>• Unfallbericht<br>**Grammatik**<br>✓ Passiv im Präteritum<br>✓ Infinitivsätze |

| 4. LERNJAHR | |
|---|---|
| **Lernziel 5** | **Lerninhalte** |
| **Vorgegebene Geschichten und Erlebnisse mündlich und schriftlich darstellen** | **Thematische Schwerpunkte**<br>• Vorgegebene Geschichten<br>• Eigene Erfahrungen und Erlebnisse aus der Umwelt der Schüler<br>• Kriterien erlebnishafter Erzählungen:<br>- Personen, Gefühle<br>- Zeitlicher Ablauf<br>- Wichtiges/Nebensächliches<br>- Mittel des Spannungsaufbaus<br>- Höhepunkt<br>**Grammatik:**<br>✓ Adjektive in attributiver Stellung<br>✓ Adjektive mit Suffixen (-*lich*, -*bar*)<br>✓ Nominalisierung |

| 4. LERNJAHR | |
|---|---|
| **Lernziel 6** | **Lerninhalte** |
| **Über Zukünftiges und Erdachtes berichten** | **Thematische Schwerpunkte**<br>• Das Schuljahr ist zu Ende:<br>- Pläne für die Ferien<br>- Vorhaben für das neue Schuljahr<br>• Was wäre, wenn ...<br>- Phantasie-Geschichten<br>**Grammatik**<br>✓ Futur I<br>✓ Konjunktiv II von *haben* und *sein*<br>✓ Konjunktiv II mit *würde*<br>✓ Nebensätze mit *wenn* |

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

### 1. Forma komunikative e mësimdhënies

Në një mësimdhënie bashkëkohore komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme, kjo do të thotë: Cilat mjete gjuhësore u duhen nxënësve që në situata të caktuara gjuhësore të shprehen dhe të sillen në mënyrë të duhur?

Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuar. Pikënisja për një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo e kundërta.

### 2. Radhitje e qartë e rrafsheve gjuhësore

Është e nevojshme, posaçërisht në nivelin fillestar të mësimdhënies, që t'u jepet një theks i veçantë rrafsheve të ndryshme gjuhësore, si:

- Përpunimit të vokabularit (fjalësit)
- Përpunimit të teksteve
- Strukturave gjuhësore

e kjo do të thotë: të caktohen prioritetet brenda një njësie mësimore.

Nuk mund, p.sh., të zhvillohen edhe vokabular i ri edhe strukturat të reja gjuhësore.

Mënyra më e drejtë do të ishte që së pari të përpunohet dhe të trajnohet vokabulari, i cili paraqitet në leksionet e caktuara.

Pastaj, vokabulari i përpunuar do të futet në struktura të reja sintaktike.

Mësuesi, brenda mësimdhënies komunikative, zgjedh situata të tilla gjuhësore, të cilat janë të afërta me përditshmërinë, ashtu që strukturat e ushtruara të jenë natyrale e jo artificiale.

### 3. Objektivat

Përcaktimi i qartë i objektivave është lehtësim për punën e mësuesit dhe e ndihmon atë vetë në përcaktimin e ojektivave më specifikë. Kur të arrihet objektivi - kjo do të thotë se nxënëset/it e zotërojnë materien e përpunuar- atëherë mesimdhënësi do të duhej të jetë i kënaqur me këtë. Nëse ende nuk ka përfunduar ora mësimore nuk ka logjikë që të futen edhe përmbajtje të reja në orë. Në këtë rast më e logjikshme do të ishte që të përforcohet ajo që është mësuar me anë të ushtrimeve të llojllojshme, të përpunohet një këngë gjatë orës së mësimit ose të futet ndonjë lojë mësimore më qëllim të arritjes së objektivit.

Gjithashtu, është e rëndësishme që në fazën e “e njoftimit me temën e re" (Sprachbegegnung)” të hyhet mundësisht shpejt në thelb të “problemit” me një motivim me të cilin arrihet objektivi dhe jo të shkohet rrugëve anësore, të cilat do t’i lejonin nxënëses/sit të hamenden rreth asaj se cili, në të vërtetë, mund të jetë qëllimi i orës mësimore.

### 4. Kufizimi i objektivave

Duke i njohur nxënësit dhe duke i pasur të qarta objektivat e përcakuar më parë, mësuesi nuk do të duhej të bëjë gabim e të përcakojë shumë objektiva për një orë mësimi e të habitet pastaj pse nuk është arritur objektivi. Për këtë arsye mësuesi duhet të caktojë një objektiv specifik, të cilin tenton ta arrijë brenda një ore mësimi. Përcaktimi i shumë objektivave për një orë ka për pasojë këtë:

Mbetet pak kohë për ushtrime dhe zbatim, për këtë arsye nxënëset/sit nuk mund ta zotërojnë mjaftueshëm materien. Në orën e ardhshme duhet të përsëritet dhe të sqarohet materia edhe një herë, sepse mund të ndodhë që të jenë përvjedhur gabime, të cilat pastaj me mund mund të korrigjohen, arsye kjo për t’u dëshpruar arsimtari dhe nxënësi.

Llogaria është e thjeshtë: një orë e stërngarkuar dhe një orë për përsëritje bëjnë dy. Në këtë rast do të ishte më e logjikshme që materia qysh nga fillimi të ndahet në dy orë.

Sipas hulumtimeve, nxënëset/sit mesatarë janë në gjendje që për një orë mësimi të mbajnë mend rreth dhjetë shprehje të reja. Ky fakt nuk duhet të lihet anash.

### 5. Radhitja: të dëgjuarit/ të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit

Posaçërisht në mësimin fillestar do të duhej të ruhet radha e katër shkathtësive, d.m.th.:

- Nxënëset/sit nuk do të duhej të flasin asgjë që nuk e kanë dëgjuar më parë,
- Ata nuk do të duhej të lexojnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar dhe folur më parë,
- Ata nuk do të duhej të shkruajnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar, folur dhe lexuar më parë.

Për t’ iu përmbajtur kësaj radhitjeje posaçërisht te fillestarët, flasin këto arsye:

- Nëse flitet një fjalë e re, logjikisht ajo do të duhej të dëgjohej më parë. Në anën tjetër leximi i një fjale të re është më i lehtë kur ajo

më parë është dëgjuar ose folur. Edhe të shkruarit do të duhej të ishtë më i lehtë, kur ajo fjalë është dëgjuar, folur apo lexuar më parë.

- Grafemat e gjermanishtes dhe të shqipes nuk përputhen në çdo rast. Pasi që nxënset/sit janë mësuar me alfabetin e gjuhës shqipe, mund të paraqitet "përgjithësimi" ose interferenca, nëse fillohet herët me shkrimin në gjuhën gjermane. Pikërisht kjo mund të shmanget, nëse mësimi fillon me të dëgjuarit dhe pastaj lëviz mbi stacionet e të folurit dhe të lexuarit në drejtim të të shkruarit.

### 6. Puna aktive dhe konkrete

Një dallim mes mësimit të gjuhës gjermane në Gjermani- pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gjermanishten si gjuhë amtare ose për gjermanishten si gjuhë e dytë ose e huaj- dhe në Kosovë është, ndër të tjera, se mjedisi kosovar mund të japë pak ose aspak informacione për RFGJ-në dhe, përveç orës së mësimit, pothuajse nuk ekziston ndonjë mundësi per t'u zbatuar ajo që është mësuar. Kështu që bie mundësia që ajo që është mësuar në shkollë të thellohet jashtë orëve të mësimit si përmes ekskursioneve, zhvillimit të intervistave etj. Në këtë kontekst nuk duhet mbiçmuar apo nënçmuar televizionin.

Prodhimi (krijimi) i pllakateve, mozaiqeve dhe i posterëve, prodhimi i punëdoreve të vogla janë gjithashtu të rëndësishme.

Një arsye tjetër për aktivitete të këtilla janë njohuritë nga psikologjia e të mësuarit: sipas saj, rezultati (arritja) është më i madh, sa më shumë që të mbështeten veprimet gjuhësore nga veprimet konkrete.

### 7. Kohë e mjaftueshme për ushtrime dhe zbatim

Për nxënien dhe zotërimin e sigurt të një gjuhë nevojiten në përgjithësi tri gjëra: kohë, kohë dhe prapë kohë.

Ne e dimë se ekzistojnë 3 tipa të ndryshëm të nxënësve:

**Tipat akustikë** (ata e nxënë-mësojnë gjuhën më shpejt përmes dëgjimit- veshit);

**Tipat vizuelë**- (pamor) (ata e nxënë gjuhën në radhë të parë përmes syrit);

**Tipat motorikë** (ata e nxënë gjuhën më se shpejti përmes të shkruarit).

Për këtë arsye është e rëndësishme, që ushtrimi të zgjedhet gjithashtu edhe përmes këtij këndvështrimi, që gjuha të mësohet njëkohësisht

përmes kanaleve të shumta, pasi që te shumica e atyre që mësojonë gjuhën bëhet fjalë për tipa të ashtuquajtur të përzier.

### 8. Llojllojshmëria në fazat e ushtrimeve

Secili mësues dhe mësuese e di saktësisht se në orën e gjuhës të ushtruarit monoton të strukturës së fjalisë ka më shumë ndikim negativ sesa që e arrin atë që është synuar.

Nxënësit dhe nxënset do ta humbin interesimin për mësim dhe nuk do të marrin pjesë aktivisht në të. Në anën tjetër, e dimë se motivimi i synuar dhe dhënia e detyrave interesante mund ta ngrisin dëshirën për mësim dhe gatishmërinë për punë (rezultate).

Ndërrimi i formave të punës (puna e veçantë, puna në çifte ose në grupe) është shumë më frytdhënëse, por edhe lojërat në mësim, këngët dhe poezitë dhe tregimet duhet të bëhen pjesë përbërëse të mësimit.

### 9. Korrigjimi i shprehjeve të nxënësve

Pothuajse asnjë çështje nuk diskutohet aq shpesh dhe në mënyrë kundërthënëse në rrethin e mësimdhënësve sesa mënyra e korrigjimit.

Derisa korrigjimin disa e vështrojnë si pengesë të rrjedhjes gjuhësore, të tjerët mbështeten në atë se gabimet duhet korrigjohen menjëherë që të mos përvidhen.

Ndoshta mund të bëhet një kompromis i arsyeshëm gjatë korrigjimit dhe ai do të dukej kështu:

- Në fazën e kontaktit të parë me temën e re, për shembull, përmes një fotografie, mësueset dhe mësuesit presin një të shprehur të lirë të nxënësve të tyre.

Po të bëjnë korrigjimin masiv gjatë kësajë faze të mësimit, nxënësit ndoshta do të tërhiqeshin menjëherë dhe në fund do të heshtnin plotësisht.

Në këtë fazë është e drejtë që korrigjimet, ndër të tjera, të parashtrohen në atë mënyrë, për shembull, një fjalë e thënë gabimisht të përsëritet nga mësuesi edhe një herë, por natyrisht në mënyrë të drejtë.

- Situata në fazën e zbatimit dhe të ushtrimit është tjetër. Këtu bëhet fjalë për trajnimin e vokabularit dhe të strukturave dhe këtu korrigjimi natyrisht është i pakushtëzueshëm.

S'ka diskutim se nxënëset/sit nuk bën t'i turpërojmë para klasës, por të tregojmë takt pedagogjik.

## 10. Diferencimi

Ndodh shpesh që rezultatet e ndryshme gjuhësore të nxënësve në mësim të paraqesin pjesërisht vështirësi të mëdha.

Derisa një nxënës ta ketë kryer tanimë detyrën e tij, të mërzitet në mësim apo të pengojë të tjerët, duke kryer detyrat, tjetri nuk është ende gati, edhe pse ka mjaft kohë në dispozicion.

Për mësueset dhe mësuesit ekzistojnë këtu dy mundësi: të bëjnë kinse nuk ka dallime në rezultate, por atëherë do të duhej të merrej parasysh edhe ajo që herët apo vonë do të paraqiten vështirësitë nga ngarkesat (kërkesat tona) e vogla, përkatësisht të mëdha.

Mundësia tjetër mbështetet në praktikimin e masave të diferencimit të brendshëm, e kjo pa dyshim për nxënësen/sin do të thotë të punojë.

Dallohen forma të ndryshme të diferencimit, të cilat nuk do të diskutohen këtu, sepse ato tanimë janë të njohura.

Vetëm dy forma duhet të shikohen më për së afërmi:

*Diferencimi kuantitativ dhe kualitativ*

- *Diferencimi kuantitativ* do të thotë se detyrat dallohen në kuantitetin e tyre, pra në sasinë e tyre. Kjo s'do të thotë asgjë tjetër, veçse nxënësit " e shpejtë" marrin detyra plotësuese. Masa zbatohet lehtë, sepse mësueset dhe mësuesit duhet vetëm të mendojnë detyra shtesë, të cilat pastaj, nëse është nevoja, ua japin disa nxënësve. Ky lloj i diferencimit, megjithatë, i ka edhe të metat e tij, sepse me anë të detyrave shtesë prej nxënësve kërkohet edhe më shumë, e në këtë mënyrë bëhen gjithnjë e më të mirë. Me fjalë të tjera: dallimi mes të mirëve dhe më pak të mirëve bëhet gjithnjë më i madh. Gjithashtu, shtrohet pyetja, mos ndoshta nxënësit më të vjetër i shohin këto detyra shtesë si një lloj dënimi për atë që kanë punuar më shpejt.

- *Diferencimi kualitativ* shtron më shumë kërkesa. Me këtë rast jepen detyra me shkallë të ndryshme vështirësie, pa e lënë anash temën e përbashkët. Të nisemi prej asaj që brenda një klase kemi të bëjmë me tri grupe të ndryshme të rezultateve: A, B, dhe C, ku me grupin A nënkuptojmë grupin me arritje më të larta, B grupin me arritje të mesme dhe C grupin me arritje më të dobëta. Skema e rrjedhës së një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

<table>
<tr><td colspan="3">Sprachbegegnung - Kontakti i parë me temën e re (Evokimi)<br>e përbashkët për të gjithë nxënësit</td></tr>
<tr><td colspan="3">Spracherarbeitung - Përpunimi i temës (Realizimi)<br>e përbashkët për të gjithë nxënësit</td></tr>
<tr><td colspan="3">Sprachübung - Ushtrimet rreth temës (Reflektimi)<br>diferencimi i grupeve sipas shkallës së arritshmërisë, p.sh.</td></tr>
<tr><td>Grupi A<br>Përpunimi i tërë tekstit.<br>Detyra kreative shtesë</td><td>Grupi B<br>Përpunimi i tërë tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe</td><td>Grupi C<br>Përpunimi i një pjese të tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe.</td></tr>
</table>

Shpesh dëgjohet edhe një argument që flet kundër kësaj forme të diferencimit, e që është:

Te kjo mënyrë e zhvillimit të mësimit nuk mësojnë të gjithë nxënësit të njëjtën gjë, sepse profili i kërkesave është i ndryshëm, në këtë rast treshkallësh.

- Një analizë e këtij argumenti tregon megjithatë shumë shpejt se kjo nuk mund të vlejë gjithmonë, sepse: nxënësit nuk e arrijnë parimisht kurrë njësoj shpejt dhe mirë objektivin e orës mësimore.
- Ajo çka arrihet me anë të këtij procesi, është shmangia nga kërkesa e tepërt apo e pakët, sepse aftësitë e nxënësve për të nxënë janë të ndryshme, pavarësisht nga ajo se a praktikohen masat e diferencimit apo jo.

## 11. Ndarja e një ore mësimore

Rrjedha e një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

| Artikulationsstufen | Methodische Absichten |
|---|---|
| ***1. Sprachbegegnung*** | Begegnung mit der neuen Sprachsituation, z.B. durch Bild, Tonaufnahme, Filmausschnitt, Lehrer- oder Schülervortrag. |
| ***2. Spracherarbeitung*** | Bereitstellen und Erarbeiten von neuem Wortschatz oder neuen Strukturen. |
| ***3. Sprachübung*** | Übungsbeispiele, möglichst in Form von realen Sprechhandlungen.<br>Aufgreifen und Wiederholen von bekanntem Wortschatz mit neuen Strukturen und umgekehrt.<br>Differenzierungsmaßnahmen Sprachlernspiele |
| ***4. Sprachanwendung*** | Übertragen des Gelernten auf neue Situationen:<br>Im Klassenzimmer<br>Im außerschulischen Bereich |

## GRADUALITETI (SHKALLSHMËRIA) NDËRPROGRAMOR

Para se t'i hyjmë punës për planin e detajizuar për klasë, ne kemi punuar një lloj plani të përafërt "global" për katër vjet, në mënyrë që të kemi sado pak të qartë se ku duam të arrijmë pas përfundimit të katër klasave (një niveli), d.m.th. klasat gjashtë - nëntë ose dhjetë – trembëdhjetë.

Arsyeja tjetër është që planet e punuara për klasë të kenë një ndërlidhje programore dhe të vazhdojnë përafërsisht aty ku janë ndërprerë vitin paraprak, të mos ketë përsëritje të objektivave të përgjithshëm ose kthim drastik prapa.

Ky plan është punuar sipas taksonomisë së Blumit dhe është i konceptuar ashtu që të mund të lexohet vertikalisht (përparimi sipas taksonomisë për një vit shkollor) dhe horizontalisht që dmth. përcjellja e një objektivi prej vitit në vit në një shkallë më të lartë.

Për ta pasur më të qartë, ja në vijim paraqitja tabelare e shkallëzuar e niveleve dhe e përmbajtjeve:

| | **1. Lernjahr** | **2. Lernjahr** | **3. Lernjahr** | **4. Lernjahr** |
|---|---|---|---|---|
| **Lernziel 1** | Einfache sprachliche Kontakte herstellen | Miteinander sprechen | In mündlichen und schriftlichen Kontakten persönliche Mitteilungen machen | Über Ereignisse berichten |
| **Lernziel 2** | Gegenstände und Tätigkeiten benennen und beschreiben, nach Gegenständen fragen | Über Gegenstände und Tätigkeiten Aussagen machen | Sachinformationen einholen und weitergeben | Gegenstände und Vorgänge beschreiben |
| **Lernziel 3** | Anweisungen verstehen und Fragen beantworten | Anweisungen verstehen und erteilen | Anweisungen geben und Aufforderungen äußern | Tätigkeiten und Vorgänge beschreiben |
| **Lernziel 4** | Sich orientieren und verständigen | Angaben zur örtlichen Umgebung machen | Angaben zu Zeit, Lage und Raum machen | Mitteilungen sachlichen Inhalts machen |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Lernziel 5** | Sprachliche Kontakte knüpfen | Wünsche und Gefühle äußern | Erlebtes und Gehörtes wiedergeben | Vorgegebene Geschichten und Erlebnisse mündlich und schriftlich darstellen |
| **Lernziel 6** | Einfache Auskünfte einholen und erteilen | Persönliche Daten erfragen und Angaben machen | Die eigene Meinung darstellen | Über Zukünftiges und Erdachtes berichten |

## NDËRLIDHJA NDËRLËNDORE

Në të vërtetë, gjuha që pikësëpari shërben si mjet komunikimi, nuk mësohet ekskluzivisht në orët e gjuhës, por në një formë a në një tjetër te të gjitha lëndet mësimore përderisa në to aftësitë, pikëpamjet e ndryshme e njohuritë zhvillohen përmes rrugëve gjuhësore.

Për aq sa gjuha ndihmon te lëndët e tjera, aq mund të ndihmojnë lëndët e tjera për arritjen e objektivave brenda mësimit të gjuhës gjermane. Para së gjithash, edhe temat e zgjedhura kanë të bëjnë me shumë fusha të jetës, e me këtë edhe me shumë lëndë mësimore, njohuritë e të cilave na ndihmojnë në mësimin e gjuhës gjermane.

Natyrisht, gjuha, para së gjithash, është e ndërlidhur me artet, sepse çdo fjalë a nocion i ri mund (duhet) të shpjegohet përmes këngës, vizatimit, fotografisë a lojës (qoftë te fëmijët (niveli II) apo te të rinjët (niveli III)).

Edhe njohuritë nga shkencat, qoftë natyrore apo shoqërore, duhet t'i shfrytëzojmë gjatë trajtimit të temave të ndryshme të parapara për klasën e tetë.

Këto njohuri shfrytëzohen sidomos në fazën e parë të orës (EVOKIMI), ku, varësisht nga temat që do të trajtojmë, përdorim njohuritë nga lëndët e tjera (nxënësit i parapërgadisim për temën).

Të ndërlidhura më shkencat shoqërore, e që vetëdijësojnë nxënësit për çështje të shumta jetësore si dhe u ndihmojnë të arrijnë shkathtësitë e duhura jetësore e komunikative, janë temat e shumta në klasën e shtatë (e sidomos me edukatën qytetare)

Ndërlidhja ekziston edhe me shkencat natyrore, sidomos të potencuara janë ato njohuri që kanë të bëjnë me mjedisin, ruajtjen e tij, shëndetin (ruajtjen e shëndetit të vet e të të tjerëve), ushqimin etj.

## TEKSTET MËSIMORE

Grupi i ekspertëve për gjuhë gjermane propozon këto tekste mësimore:

Klasa 8: Wer? Wie? Was? Band 3, VUB-Gilde Verlag, Köln

Klasa 9: Wer? Wie? Was? Band 4, VUB-Gilde Verlag, Köln

**alternativ**:

Klasa 8: Ping Pong 3 (gjysma e parë e leksioneve) - Neu, Hueber Verlag, Ismaning

Klasa 9: Ping Pong 3 (gjysma e dytë e leksioneve) - Neu, Hueber Verlag, Ismaning

# MATEMATIKË

**(3 orë në javë, 105 orë në vit)**

## HYRJE

Matematika gjithmonë është konsideruar shkencë mbi madhësitë, numrat, figurat, hapësirën dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Por, sot, në këtë shekull të kompjuterizimit, matematika është më shumë se aritmetikë dhe gjeometri, ajo është një disiplinë e përgjithshme që shqyrton të dhënat, madhësitë, modelimet dhe vrojtimet shkencore të fenomeneve natyrore, me arsyetime dhe vërtetime deduktive. Ajo, gjithashtu, konsiderohet si një gjuhë universale, që përmban simbole, formula, diagrame e grafe, nëpërmjet të të cilave shprehen idetë, interpretohen ato, përshkruhen dhe shpjegohen kuptimet matematike dhe proceset shoqërore.

Jeta bashkëkohore sot, në të gjitha format e veta është mjaft komplekse. Ajo përballet me ndryshime të shumta dhe probleme që kërkojnë zgjidhje të shpejta dhe të drejta. Prandaj, programi i matematikës për klasën IX synon jo vetëm përforcimin, zgjerimin dhe thellimin e njohurive, por edhe zhvillimin e shprehive për punë të pavarur e sistematike, zhvillimin e shkathtësive për të kuptuar botën fizike dhe proceset shoqërore. Ky program synon të kultivojë te nxënësit aftësitë për përshkrimin e objekteve dhe të proceseve me saktësi, aftësitë për të hamendësuar dhe për të ndërtuar argumente që shpjegojnë arsyetimet e tyre; zhvillimin e aftësive të nxënësve të tanishëm, punëtorëve dhe qytetarëve të ardhshëm, për të sfiduar me të gjitha problemet me të cilat ballafaqohen.

Gjithashtu, programi i matematikës në klasën IX fokuson zhvillimin e aftësive të nxënësve për të menduar në mënyrë krijuese e kritike. Rritja e përgjegjësisë së nxënësve për të mësuar dhe punuar në mënyrë individuale dhe në bashkëpunim me të tjerët u mundëson atyre të përgatiten për jetën e tyre, si punëtorë dhe qytetarë të ardhshëm të shoqërisë sonë.

## QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së matematikës për klasën e nëntë ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive dhe të shkathtësive të nxënësit për të njohur dhe për të kuptuar drejt matematikën si disiplinë.
- Zhvillimin intelektual e shpirtëror të nxënësit, formimin e cilësive të të menduarit për qasje kritike të informacioneve dhe të përdorimit të tij.
- Formimin dhe përgatitjen e të gjithë nxënësve për marrjen e përgjegjësive për edukimin e ardhshëm të tyre dhe jetën në përgjithësi.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- **Të njohin**
  terminologjinë, faktet specifike, konceptet dhe parimet, metodat dhe procedurat për veprime me numra realë, për matjen e madhësive, shqyrtimin e transformimeve dhe veprimet me ngjarje e eksperimente.

- **Të kuptojnë**
  përkthimin e informacioneve prej fjalëve në simbole dhe anasjelltas, zbatimin e fakteve dhe të parimeve në situata të reja, interpretimin e diagrameve, arsyetimin e metodave dhe të procedurave gjatë veprimeve me numra realë, figura e transformime dhe ngjarje e modele statistikore.

- **Të zbatojnë**
  njohuritë, faktet, parimet dhe rezultatet e matjeve gjatë modelimeve dhe zgjidhjes së problemeve praktike nga jeta e përditshme dhe të shfrytëzojnë teoritë, në situata të reja dhe në lëmenj të tjerë.

- **Të analizojnë**
  identifikimin e informatave të përshtatshme, interpretimin e ideve dhe të shprehjeve, përfundimet e të dhënave dhe procedurat e

strategjitë e zgjidhjes së problemeve matematike dhe atyre nga jeta e përditshme.

- **Të sintetizojnë**
  njohuritë gjatë përgjithësimit të fakteve, rregullave, parashikimeve dhe nxjerrjes së përfundimeve, të interpretojnë grafet dhe diagramet gjatë përpunimit, organizimit dhe klasifikimit të të dhënave.

- **Të vlerësojnë**
  përfundimet e zgjidhjes së problemeve, duke u bazuar në prova dhe në kritere; proceset matematike dhe përdorimin e strukturave algjebrike; lidhjen e matematikës me teknologji e shkenca të tjera dhe shfrytëzimin e saj në jetën e përditshme.

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

| Kategoritë | Nënkategoritë | Nr. i orëve | % |
|---|---|---|---|
| ARITMETIKA DHE ALGJEBRA | Numrat realë | 58 | 55.24% |
| | Shprehjet shkronjore racionale | | |
| | Ekuacionet lineare me dy ndryshore | | |
| | Sistemet e ekuacionet lineare me dy dhe tri ndryshore | | |
| | Përpjesëtimi i drejtë dhe i zhdrejtë | | |
| GJEOMETRIA DHE MATJET | Kuptimet themelore të gjeometrisë në rrafsh | 34 | 32.40% |
| | Vektorët | | |
| | Homotetia dhe ngjashmëria | | |
| STATISTIKA DHE PROBABILITETI | Disa njohuri nga statistika dhe probabiliteti | 13 | 12.36% |

| ARITMETIKA DHE ALGJEBRA | | |
|---|---|---|
| **Nënkategoritë** | **Përmbajtja programore** | **Rezultatet e pritura** |
| NUMRAT REALË | • bashkësia e numrave natyralë<br>• bashkësia e numrave racionalë<br>• numrat irracionalë<br>• numrat realë dhe vlera absolute | Nxënësi do të jetë në gjendje:<br>• të dallojë numrat dhjetorë që mund të shkruhen si numra thyesorë<br>• të identifikojë numrat irracionalë<br>• të krahasojë dy numra realë<br>• të paraqesë numrat realë në boshin numerik<br>• të përkufizojë vlerën absolute të numrave realë<br>• të kryejë veprimet themelore me numra realë |
| SHPREHJET SHKRONJORE RACIONALE | • shprehjet racionale<br>• domeni i shprehjeve racionale<br>• thjeshtimi i shprehjeve racionale<br>• veprimet me shprehje racionale<br>• shprehjet e përbëra racionale<br>• ekuacione lineare me një të panjohur<br>• ekuacionet lineare me një të panjohur me vlerë absolute<br>• inekuacionet lineare me një të panjohur<br>• inekuacionet lineare me një të panjohur me vlerë absolute | • të përkufizojë shprehjet shkronjore (mon., bin.,..,polin.)<br>• të përcaktojë domenin e shprehjeve shkronjore racionale<br>• të thjeshtojë shprehjet shkronjore racionale<br>• të përkthejë shprehjet nga gjuha e zakonshme në atë algjebrike dhe anasjelltas<br>• të zbërthejë në faktor të thjeshtë shprehjet racionale<br>• të kryejë veprimet me shprehjet racionale<br>• të përdorë formulat algjebrike gjatë veprimeve me shprehje shkronjore<br>• të paraqesë gjeometrikisht shprehjet shkronjore racionale<br>• të zgjidhë ekuacionet sipas shkronjave<br>• të zgjidhë ekuacionet me vlerë absolute<br>• të përdorë ekuacionet për zgjidhje problemore matematike<br>• të diskutojë zgjidhjen e ekuacioneve dhe të inekuacioneve<br>• të paraqesë zgjidhjet e inekuacioneve në boshtin numerik |

| | | |
|---|---|---|
| | | • të zgjidhë inekuacionet me vlerë absolute dhe të paraqesë grafikisht bashkësitë e zgjidhjeve të tyre<br>• të përdorë ekuacionet në fizikë, kimi dhe lëmenj të tjerë të zbatojë ekuacionet dhe inekuacionet në zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme |
| EKUACIONET LINEARE ME DY NDRYSHORE | • sistemi i koordinatave kënddrejta në rrafsh<br>• ekuacioni linear me dy ndryshore $y = kx + m$<br>• grafiku i ekuacionit linear me dy ndryshore<br>• kuptimi i pjerrësisë së drejtëzës | • të përcaktojë pozitën e pikës në rrafshin e koordinatave, kur janë dhënë koordintat dhe anasjelltas<br>• të paraqesë grafikisht ekuacionin linear me dy ndryshore<br>• të diskutojë grafikun e ekuacionit linear me dy ndryshore në varësi të parametrave k dhe m<br>• të përdorë ekuacionet lineare me dy ndryshore për zgjidhjen e problemeve matematike dhe atyre nga jeta e përditshme.<br>• të përcaktojë pozitën e drejtëzës në lidhje me boshtet e koordinatave në varësi nga koeficienti i pjerrësisë |
| SISTEMET E EKUACIONEVE LINEARE | • sistemi i ekuacioneve lineare me dy ndryshore<br>• metodat për zgjidhjen e sistemit të ekuacioneve lineare me dy ndryshore<br>• zbatimi i sistemit të ekuacioneve lineare me dy ndryshore<br>• sistemi i ekuacioneve lineare me tri ndryshore<br>• metodat për zgjidhjen e sistemit të ekuacioneve lineare me tri ndryshore | • të përcaktojë kur një dyshe e renditur është zgjidhje e sistemit<br>• të zgjidhë sistemin e ekuacioneve lineare me metoda të ndryshme<br>• të arsyetojë zgjidhshmërinë e sistemit të ekuacioneve lineare<br>• të diskutojë zgjidhjen e sistemeve në varësi të parametrave<br>• të zbatojë sistemet e ekuacioneve lineare në zgjidhjen e problemeve praktike |

| | | |
|---|---|---|
| PËRPJESËTIMI I DREJTË DHE I ZHDREJTË | • përpjesët dhe përpjesëtimi<br>• përpjesëtimi i drejtë dhe përpjesëtimi i zhdrejtë<br>• përpjesëtimi i thjeshtë dhe i zgjeruar<br>• llogaritja e ndarjes dhe llogaritja e përzierjes<br>• llogaritja e përqindjes, e promilit dhe e kamatës | • të përkufizojë përpjesën dhe përpjesëtimin<br>• të identifikojë përpjesëtimin e drejtë dhe atë të zhdrejtë<br>• të përkufizojë përpjesëtimin e thjeshtë dhe të zgjeruar<br>• të dallojë madhësitë të cilat janë në përpjesëtim të drejtë nga ato që janë në përpjesëtim të zhdrejtë<br>• të llogarisë përqindjen, kamatën dhe promilin<br>• të zbatojë vetitë e përpjesës në zgjidhjen e detyrave praktike<br>• të përdorë formulat për llogaritjen e përqindjes, promilit dhe kamës<br>• të përdorë kalkulatorin dhe kompjuterin për zgjidhjen e problemeve të ndryshme |
| **GJEOMETRIA DHE MATJET** | | |
| KUPTIMET THEMELORE TË GJEOMETRISË NË RRAFSH | • kuptimet themelore të gjeometrisë në rrafsh (objektet themelore dhe aksioma)<br>• gjysmëdrejtëza, segmenti, këndi dhe gjysmërrafshi<br>• aksiomat e kongruencës<br>• drejtëzat normale, aksioma e paraleleve<br>• kongruenca e figurave në rrafsh, rregullat për kongruencën e trekëndëshave<br>• vijat dhe pikat karakteristike të trekëndëshit | • të përkufizojë kuptimet themelore dhe të nxjerra gjeometrike<br>• të dallojë objektet themelore gjeometrike<br>• të përkufizojë pohimet themelore në gjeometri<br>• të përdorë aksiomat për vërtetimin e pohimeve themelore gjeometrike<br>• të dallojë kur dy trekëndësha janë kongruent<br>• të zbatojë kongruencën e trekëndëshave për zgjidhjen e detyrave praktike<br>• të konstruktojë disa nga vendet gjeometrike të pikave në rrafsh<br>• të përkufizojë vektorët dhe t'i kryej disa veprime me ta (mbledhjen, zbritjen e vektorëve dhe shumëzimin e tyre me skalarë) |

| | | |
|---|---|---|
| | • disa nga vendet gjeometrike të pikave<br>• vektorët | |
| HOMOTETIA DHE NGJASHMËRIA | • përpjesa (proporcioni, raporti) e dy segmenteve<br>• vetitë e proporcionit<br>• homotetia dhe teorema e Talesit<br>• ngjashmëria e dy figurave në rrafsh<br>• rregullat për ngjashmërinë e trekëndëshave<br>• zbatimi i homotetisë dhe ngjashmërisë në zgjidhjen e detyrave të ndryshme | • të përkufizojë rregullën për raportin e segmenteve dhe T e Talesit<br>• të zbatojë T. e Talesit për raportin e segmenteve<br>• të zbatojë vetitë e proporcionit gjatë zgjidhjes së detyrave<br>• të emërtojë rregullat për ngjashmërinë e trekëndëshave.<br>• të zbatojë homotetinë dhe vetitë e saj për zgjidhje të problemeve praktike<br>• të zbatojë kriteret e ngjashmërisë në detyra konstruktive<br>• të zbatojë rregullat e kongruencës së trekëndëshit . |
| **STATISTIKA DHE PROBABILITETI** | | |
| DISA NJOHURI NGA STATISTIKA DHE PROBABILITETI | • popullacioni . mostra<br>• paraqitja grafike e të dhënave statistikore<br>• vlera mesatare, moda dhe mediana<br>• ngjarjet e rastit<br>• veprimet dhe relacionet me ngjarje të rastit<br>• përkufizimi klasik i probabilitetit<br>• përkufizimi statistikë i probabilitetit<br>• vetitë e probabilitetit | • të përcaktojë populacionin dhe mostrën gjatë një hulumtimi<br>• të listojë rezultatet e matjeve<br>• të interpretojë në forma të ndryshme të dhënat statistikore<br>• të llogaritë vlerën mesatare, modën dhe medianën<br>• të klasifikojë ngjarjet e provave<br>• të zbatojë veprimet dhe relacionet me ngjarje të rastit<br>• të interpretojë përkufizimin klasik dhe statistikor të probabilitetit<br>• të identifikojë vetitë e probabilitetit dhe të zbatojë atë gjatë zgjidhjes së problemeve matematikore. |

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe të programit të matematikës për klasën IX, mësimdhënësit duhet të veçojnë aftësitë themelore dhe shkathtësitë e domosdoshme të nxënësve me qëllim të zgjidhjes me saktësi dhe pa vështirësi të detyrave mësimore që parashikohen në objektiva. Praktikat mësimore kanë treguar se, jo të gjithë nxënësit, mësojnë në të njëjtën mënyrë, në të njëjtën kohë dhe me ritëm të njëjtë. Për këtë arsye, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies duhet të jene të larmishme dhe t'u përshtaten nevojave dhe interesit të nxënësve.

Njëri nga faktorët që ndikon në suksesin e mësimdhënies dhe të nxënies është, pa dyshim, efektshmëria e *planifikimit të orës mësimore*. Mësimdhënësit duhet të hartojnë plane, të cilat u ndihmojnë nxënësve për të kuptuar konceptet themelore, dhe i motivojnë ata për të zgjedhur modele, për të bërë pyetje logjike, dhe për të shfrytëzuar teknologjinë gjatë kërkimeve dhe hulumtimeve matematike.

Gjatë planifikimit të një mësimi, mësimdhënësit duhet të kenë të qartë përgjigjen e këtyre pyetjeve:

- Çfarë do të mësohet? Cilat shkathtësi paraprake u duhen nxënësve? Cila është përmbajtja që do të transmetohet? Çfarë aftësish do të arrijnë nxënësit?
- Si do të planifikohen detyrat dhe aktivitetet mësimore? Cilat metoda dhe strategji do të përdoren? Cilat burime do të shfrytëzohen? Si do të punohet (në grupe apo në mënyrë individuale)?
- Si do ta mësojmë se çfarë është arritur? Si do të bëhet vlerësimi dhe rishikimi i procesit mësimor?

Kështu, mësimdhënia, bëhet një proces që përfshin mundësinë për:

- shpjegimet e mësimdhënësit;
- diskutime ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësve, dhe ndërmjet vetë nxënësve;
- përshtatje të punës praktike;
- përforcim dhe ushtrim të shkathtësive themelore;
- zgjidhje të problemeve dhe përfshirje të matematikës në jetën e përditshme dhe
- punë kërkimore.

**Zgjidhja e problemeve** është tipar i të menduarit, që në matematikë zë një vend të rëndësishëm. Ajo është pjesë e integruar në të gjitha kategoritë e përmbajtjeve mësimore. Në klasën e nëntë mbi bazën e njohurive të fituara nxënësit vlerësojnë cilësinë dhe rrjedhimet e metodave komplekse të zgjidhjes së problemeve.

Zgjidhja e problemeve është një proces "provues" që përmban fillime e mbarime, suksese e dështime, dhe verifikime e mospranime të disa përfundimeve. Është e rëndësishme që mësimdhënësit të provojnë këtë proces në klasat e tyre dhe të bashkëpunojnë me nxënësit për kërkime të përgjigjeve. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit inkurajojnë nxënësit që të bëjnë të njëjtën gjë dhe u ndihmojnë atyre të fitojnë përvoja të reja e të vlerësojnë sukseset gjatë zgjidhjes së problemeve. Veprimtaritë që organizohen në klasë gjatë zgjidhjes së problemeve duhet të gërshetojnë punën individuale, në çifte dhe në grupe, me qëllim të rritjes së përgjegjësisë së nxënësit për të ndërtuar të kuptuarit.

**Pyetjet dhe teknika e pyetjeve.** Nëse dëshirojmë të nxisim të menduarit e nxënësve, si pjesëmarrës aktivë në procesin e të nxënit, është e domosdoshme të planifikohen pyetje të të gjitha niveleve. Kur të gjitha pyetjet janë të nivelit riprodhues, atëherë ndodh pak ose aspak të menduarit. Pyetjet e nivelit të lartë si: "Pse…?", "Çfarë, nëse…?" , "A shihni ndonjë model..?", " Jepni një shembull për ..!", A është gjithmonë e vërtetë?" e të tjera, janë pyetje nxitëse që u ndihmojnë nxënësve të zgjerojnë njohuritë, të arsyetojnë dhe të reflektojë për atë që kanë mësuar.

**Komunikimi**. Është me rëndësi që gjatë procesit të të nxënit, nxënësit të dëgjojnë, të pyesin, të diskutojnë , të lexojnë dhe të shkruajnë. Përdorimi i saktë i gjuhës matematike, shprehja e ideve dhe diskutimi i tyre luan një rol të rëndësishëm në të kuptuarit e koncepteve. Simbolet dhe diagramet e pasurojnë gjuhën e zakonshme të nxënësve, e zgjerojnë fjalorin shprehës dhe u mundësojnë atyre të komunikojnë në të gjitha fushat.

**Lidhja ndërlëndore** paraqet një aspekt të rëndësishëm në edukimin matematik. Përvojat që sjellin në klasa mësimdhënësit, u mundësojnë nxënësve të shohin se si konceptet dhe shkathtësitë nga një kategori e matematikës janë të lidhura me ato të kategorive të tjera. Në rastet e tilla, nxënësit ndihmohen të zotërojnë parimet e përgjithshme matematike. Po ashtu, lidhja e matematikës me lëndët e tjera dhe me situatat e jetës së përditshme paraqet një tjetër fakt, që e bën matematikën më shumë se një shkencë të izoluar.

Edukata fizike ofron raste të panumërta të matjeve si pjesë të natyrshme të aktiviteteve, për shembull kohëmatjet ose matjet e gjatësive gjatë kërcimeve. Krijimi i figurave simetrike dhe asimetrike në mësimet e gjimnastikës gjithashtu paraqesin shfrytëzimin real të koncepteve mate-

matike. Gjuha matematike haset në të gjitha fushat, për shembull leximi i notave muzikore apo përshkrimi i figurave në aktivitetet e artit pamor. Po ashtu, përkthimi i gjuhës së përditshme në atë algjebrike dhe anasjelltas është pjesë e leximit të formulave të lëndëve shkencore. Zgjidhja e ekuacioneve shkronjore mundëson zgjidhjen e problemeve nga fizika dhe kimia. Kështu, lidhjet dhe zbatimi i njohurive matematike në fusha të ndryshme e rrit interesimin e nxënësve për mësimin e matematikës.

Paraqitja e qartë e objektivave, përdorimi i metodave bashkëvepruese dhe përkrahja e të nxënit aktiv dhe të pavarur u mundëson nxënësve të drejtojnë të nxënit e tyre, të thellojnë njohuritë, dhe t'i zbatojnë ato gjatë zgjidhjes së problemeve të ndryshme.

## VLERËSIMI

Procesi i vlerësimit është pjesë e integruar e mësimdhënies dhe e të nxënit. Përmes vlerësimit të vazhdueshëm gjykohet jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësit, por edhe vlefshmëria e programit dhe e metodologjisë mësimore në përgjithësi. Mësimdhënësi duhet të fokusohet në identifikimin e njohurive ekzistuese të nxënësit dhe shqyrtimin e aftësive dhe të shkathtësive të ndryshme të tyre. Në klasën IX, nxënësit pësojnë ndryshime të mëdha në arritjet matematike, ndryshime të shpejta në rritjen e tyre intelektuale dhe në zhvillimin emocional. Prandaj, gjatë vlerësimit përcaktohet jo vetëm çfarë din nxënësi dhe çfarë mund të bëjë ai, por edhe çfarë ndjen dhe çfarë beson ai. Këto informata i mundësojnë mësimdhënësit të organizojë orët mësimore në mbështetje të nevojave dhe të interesave të ndryshme të nxënësve. Të dhënat dhe mbledhja e informatave ndihmojnë gjithashtu në marrjen e vendimeve të vlefshme për motivimin dhe inkurajimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënit.

Ndonëse aftësitë në llogaritje janë qenësore, vlerësimi duhet të përfshijë edhe verifikimin e aftësive të nxënësit për përdorimin e saktë të gjuhës e të simboleve matematike gjatë komunikimit matematik, si dhe vlerësimin e shkathtësive për zgjidhjen e problemeve. Për këto arsye në orët e matematikës shfrytëzohen teknika të ndryshme vlerësimi, si:

*Vrojtimi* dhe regjistrimet në klasë vlerësojnë shkathtësitë e nxënësve për të shprehur qartë idetë matematike;

*Detyrat kontrolluese* shërbejnë për kontrollimin e përparimit të nxënësve dhe identifikimin e vështirësive në të mësuar;

*Dosja* paraqet koleksione të punimeve të përzgjedhura të mbajtura në një folder, të cilat sigurojnë një model të punës së nxënësit, të kryer gjatë

një periudhe të caktuar kohore; vlerësimi i dosjes bëhet nga mësimdhënësi dhe nga vetë nxënësi;

*Projektet* e nxënësve mundësojnë vlerësimin e punës në bashkëpunim dhe kreativitetin e nxënësve;

*Testet dhe provimet* shërbejnë për qëllime të shumëfishta. Testet e llojeve të ndryshme, të ndërtuara nga mësimdhënësi janë instrumente mjaft të përdorshme për vlerësimin e nxënësve.

Zbatimi i teknikave të shumta të vlerësimit mundësojnë sigurimin e informacioneve për çdo nxënës në përmbushje të rezultateve të pritshme dhe të objektivave të lëndës së matematikës, identifikimin e vështirësive në të mësuar dhe tejkalimin e tyre dhe vlerësimin e gatishmërisë së nxënësve për kryerjen me sukses të testit kombëtar dhe përgatitjes për të ardhmen.

Për shënimin e përparimit të nxënësve dhe vënien e notave, mësimdhënësi mund të përdorë modele të ndryshme, që janë më të përshtatshme dhe që japin informacione të pasura. Këto shënime dhe informacione kanë rëndësi të madhe për të kontribuar në motivimin dhe përparimin e mëtejshëm dhe për të komunikuar me prindërit dhe të gjitha institucionet e interesuara.

## LITERATURA

1. R. Zejnullahu, R. Gjergji, Fevzi Berisha A. Zejnullahu
   **Matematika 9,** Prishtinë, 2004, botoi Dukagjini, Pejë

2. I. Shehu, R. Gjergji, M. Kadriu, S. Bilalli
   **Matematika 9 "Detyra të zgjedhura",** Prishtinë, 2004, botoi Dukagjini

# BIOLOGJI

**(2 orë në javë, 70 orë në vit)**

## HYRJE

Praktika tregoi se plani dhe programi pilot për klasën IX kishte shpërputhje ndërmjet përmbajtjes programore dhe fondit të orëve (1 orë në javë). Kjo shtroi nevojën që të rritet numri i orëve (2 orë në javë) dhe të bëhet një rishikim, rikonceptim, ristrukturim dhe riradhitje e përmbajtjes për hir të koherencës në përmbajtjet e reja programore për klasën VI, VII, VIII. Kështu, u krijua hapësirë e nevojshme manevruese që nxënësve të kësaj klase t'u sigurohet baza e nevojshme teorike dhe praktike për biologjinë e njeriut, e justifikueshme për shkollat tona dhe e përdorshme për rrethanat tona. Në këtë kontest, përmbajtja interesante e propozuar e programit të biologjisë për këtë klasë, e bazuar në planet dhe programet e kohës në rajon e më gjerë, i kontribuon zhvillimit të mendimit kritik, aftësive kognitive dhe shkathtësive psikomotorike të nxënësve.

Në trungun e përmbajtjes lënda ka tri kategori dhe katër nënkategori. Kategoria e parë (Ndërtimi i qenieve të gjalla) përfshin vetëm një nënkategori (Indet, organet dhe sistemet e organeve), kategoria e dytë (Proceset jetësore) përfshin dy nënkategori (1. Cikli jetësor i njeriut dhe 2. trashëgimia te njeriu), kategoria e tretë (qeniet e gjalla dhe mjedisi) përfshin vetëm një nënkategori (Evolucioni i njeriut).

Përmbajtja programore e kësaj lënde është koherente, logjike dhe e aplikuar konformë kërkesave të kohës. "Përzierja " e temave nga fushat specifike të biologjisë së njeriut (anatomi, fiziologji, biokimi, embriologji, gjenetikë dhe evolucion), u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri bazë për ndërtimin, zhvillimin dhe evolucionin e njeriut, aplikojnë masat preventive kundër sëmundjeve me etiologji të ndryshme, vlerësojnë pasojat e toksikomanisë si dhe të zhvillojnë qëndrime dhe vlera shoqërore. Me këto përmbajtje programore ne konsiderojmë se nxënësit e kësaj moshe pajisen me njohuri, shprehi, shkathtësi, qëndrime dhe vlera për t'u

ballafaquar me sukses me sfidat e jetës. Se sa është e qëlluar kjo përmbajtje programore, vlerësues më të mirë janë nxënësit dhe arsimtarët, ndërsa gjykatësi më i mirë është koha.

## QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për kl.IX ka për qëllim:

- Të zhvillojë aftësi te nxënësi për të njohur ndërtimin dhe funksionin e trupit të njeriut (indeve, organeve dhe sistemit të organeve, evolucionin e tij) si dhe për të kuptuar ligjet themelore te proceseve jetësore (trashëgiminë, ciklin e zhvillimit jetësor).
- Të krijojë vetëdije për unitetin e ndërtimit dhe të funksionit të strukturave të organizmit të njeriut dhe të zhvillojë aftësi për të kuptuar se njeriu është qenie biologjike dhe shoqërore.
- Të fitojë shprehi për mbajtjen e higjienës përsonale dhe shkathtësi për zbatimin e njohurive të fituara në situta konkrete (ndihma e parë në rast të gjakderdhjeve, thyerjes së eshtrave, reanimimit etj.).
- Të kontribojë në zhvillimin e vetëdijës së nxënësit se proceset, funksionet dhe manifestimet jetësore janë reciprokisht të kushtëzuara.
- Të zhvillohet një personalitet stabil dhe vetëkritik i aftë për t'u ballafaquar me sfidat e jetës.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nga përmbajtja programore e klasës IX, nxënësi duhet të jetë në gjendje:

O **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat**

- Të ndërgjegjësohet dhe të ngritë përgjegjësinë për ruajtjen e shëndetit personal e kolektiv.
- Të kultivojë sjellje personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik, të luftojë teoritë pseudoshkencore për racat etj.).

O **Të njohë**

- Tiparet kryesore të indeve, të organeve dhe të sistemit të organeve të njeriut
- Fjalorin (terminologjinë biologjike) nga fushat e biologjisë humane
- Faktet, konceptet dhe parimet që i përkasin këtij lëmi
- Procedurat dhe metodat që aplikohen në në këtë lëmë

O **Të kuptojë**

- Se proceset, funksionet dhe manifestimet jetësore mund të sqarohen, duke u bazuar në ndërtimin e indeve, të organeve dhe të sistemit të organeve të njeriut.
- Rëndësinë e funksionimit normal të indeve të organeve dhe të sistemit të organeve për ruajtjen e homeostazës në organizëm
- Se njeriu është qenie biologjike dhe shoqërore.
- Rëndësinë e shumëzimit për ruajtjen e kontinuitetit të jetës së llojit njeri, pas vdekjes individuale të organizmit.

O **Të zbatojë**

- Njohuritë e fituara për rëndësinë e ushqimit të larmishëm për shëndetin e njeriut si dhe masat higjieniko-sanitare në jetën e përditshme
- Të përdorë veglërine themelore (aparatin për matjen e shtypjes së gjakut, mikroskopin etj.).
- Njohuritë për zgjidhjen e problemeve të natyrës biologjike në situata të ndryshme (ndihma e parë në rast të gjakderdhjes, të thyerjes së eshtrave, të helmimit me ushqim, preventiva kundër graviditetit të padëshiruar etj.).

O **Të analizojë**

- Shkaqet e prishjes së homeostazës së organizmit si pasojë e funksionit jo normal të indeve, organeve dhe sistemit të organeve
- Shkaqet e shfaqjes së deformiteteve dhe të sëmundjeve gjatë zhvillimit ontogjenetik të njeriut
- Pse dhembja (ndonëse na duket paradoksale) është miku i organizmit tonë

O **Të vlerësojë**

- Rolin e ushqimit të larmishëm dhe rëndësine e ndërrmarrjes së masave higjieniko-sanitare për shëndetin e njeriut
- Rolin e organeve shqisore për ekzistencën dhe mbrojtjen e organizmit (p.sh., ushqimi i prishur kundërmon, ka shije dhe koekzistencë tjetër, andaj ne i shmangemi).
- Saktësinë e gjykimit të tij me anë të fakteve dhe të eksperimenteve

O **Të sintetizojë**

- Njohuritë teorike dhe praktike për shpjegimin e drejtë të procesve, të fuksioneve dhe të manifestimeve jetësore
- Të përfundojë se puna e të gjitha sistemeve në organizëm drejtohet nga sistemi nervor dhe endokrin

O **Të komunikojë informatat në kontekste të ndryshme**

- Shkrimi i raportit nga një punë praktike ose hulumtim (p.sh., frekuenca e grupeve te gjakut të sistemit ABO në popullatë)
- Të paraqesë rezultatet e hulumtimit, duke konsultuar shumë burime të informacionit
- Të kontribojë në debate dhe diskutime (p.sh., për evitimin e toksikomanisë, AIDS-it, sëmundjeve ngjitëse etj.)

O **Të zhvillojë të menduarit kritik në biologji**

- Të dallojë informatën relevante nga ajo jorelevante (p.sh., se në planet ekziston vetëm një lloj njeri dhe të luftojë pikëpamjet pseudoshkencore për racat).
- Të dallojë faktin nga gjykimi (p.sh., fakt është se determinimi i seksit te njeriu bëhet me bashkëveprimin e gjeneve që gjenden në kromozomin X dhe Y etj.).

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Mbarështrimi i përmbajtjes programore të lëndës së biologjisë për klasën e nëntë bëhet për 35 javë, përkatësisht për 70 orë mësimi për një vit shkollor, sipas trajtës:

- Kategoria

- Nënkategoria
- Përmbajtja programore
- Rezultatet e pritura
- Lidhja ndërlëndore

| KATEGORITË | NËNKATEGORITË | Nr. i orëve | % |
|---|---|---|---|
| **I. Ndërtimi i qenieve të gjalla** | **I.1. Indet, organet dhe sistemet e organeve te njeriu** | **40** | **57.2** |
| **II. Proceset jetësore** | **II.1. Cikli jetësor i njeriut** | **8** | **11.4** |
| | **II.2. Trashëgimia te njeriu** | **5** | **7.1** |
| **III. Qeniet e gjalla dhe mjedisi** | **III.1. Evolucioni i njeriut** | **4** | **5.7** |
| | **Punë praktike** | **9** | **12.9** |
| | **Orë në dispozicion** | **4** | **5.7** |
| | **Gjithsej:** | **70** | **100 %** |

| Kategoria | Nënkategoria | Përmbajtja programore | Rezultatet e pritura | Lidhja ndërlëndore |
|---|---|---|---|---|
| **I.1.<br>Ndërtimi i qenieve të gjalla** | **I.1.<br>Indet, organet dhe sistemet e organeve** | **Veprimtaria e ndersjellë e eshtrave dhe e muskujve<br>- Sistemi pasiv për lëvizje - eshtrat**<br><br>- ndërtimi i eshtrave<br>- lidhja ndërmjet eshtërave<br>- sëmundjet e sistemit eshtëror | **Nxënësi duhet të:**<br>- definojë termat: qelizë, ind, organ dhe sistem i organeve<br>- emërtojë indet kryesore në trupin e njeriut, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre<br>- hulumtojë dhe të përshkruajë veprimtarinë e ndërsjelltë të eshtrave dhe të muskujve<br>- emërtojë pjesët kryesore që e përbëjnë skeletin e njeriut<br>- përshkruajë si janë të lidhur eshtrat ndërmjet vete dhe të emërtojë llojet e nyjëtimeve<br>- përshkruajë funksionet e ndryshme te skeletit të njeriut | Me lëndën e fizikës, kimisë, anatomisë, fiziologjisë dhe higjienës. |
| **I.1.<br>Ndërtimi i qenieve të gjalla** | **I.1.<br>Indet, organet dhe sistemet e organeve te njeriu** | **- Sistemi aktiv lokomotor:**<br>- muskujt, ndërtimi, klasifikimi, funksioni<br>- dëmtimet dhe sëmundjet më të shpeshta të muskujve | - klasifikojë muskujt e njeriut, të përshkruajë tiparet e muskujve të vullnetshëm dhe të pavullnetshëm<br>- analizojë ndërtimin e muskulit skeletik.<br>- identifikojë organet që janë të përbëra nga muskujt e lëmuar, përkatësisht nga muskujt e strijuar.<br>- vlerësojë rolin e kujdesit dhe të | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | higjienës për sistemin lëvizor<br>- përshkruajë si jepet ndihma e parë në rast të lëndimit të sistemit lëvizor | |
| **I.1. Ndërtimi i qenieve të gjalla** | **I.1. Indet, organet dhe sistemet e organeve te njeriu** | **Ushqimi dhe tretja**<br>-grupet kryesore te lëndëve ushqyese<br>-pjesët kryesore te sistemit tretës,<br>-tretja në:<br>- gojë<br>-lukth<br>-zorrë<br>- funkcioni i mëlqisë dhe i pankreasit.<br>- sëmundjet më të shpeshta të organeve të tretjes | Emërtojë grupet kryesore të lëndëve ushqyese dhe të përshkruajë rolin biologjik të tyre<br>- numërojë ushqimet që janë të pasura me vitamina dhe të përshkruajë rolin biologjik të vitaminave<br>- emërtojë pjesët kryesore të sistemit tretës dhe të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e tyre<br>- shpjegojë rolin e mëlçisë dhe të pankreasit në tretjen e ushqimit<br>- emërtojë disa çrregullime në zhvillimin e organeve të tretjes si dhe sëmundjet më të shpeshta të sistemit tretës<br>- vlerësojë rolin e higjienës për shëndetin e njeriut | |
| **I.1. Ndërtimi i qenieve të gjalla** | **I.1. Indet, organet dhe sistemet e organeve te njeriu** | **Gjaku dhe sistemi i organeve për qarkullimin e gjakut:**<br>- Përbërja dhe rëndësia e gjakut,<br>- qarkullimi i madh dhe i vogël i gjakut<br>- sëmundjet më të shpeshta të | - përshkruajë përbërjen kimike dhe qelizore të gjakut dhe të vlerëson rolin biologjik të eritrociteve, leukociteve dhe trombociteve<br>- numërojë pjesët përbërëse të sistemit limfatik dhe të vlerësojë | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | sistemit të organeve për bartjen e lëngjeve trupore<br>- aftësitë mbrojtëse të organizmit<br>- imuniteti dhe alergjia<br>- gjaku dhe transfuzioni i gjakut | rolin biologjik të tyre<br>- përshkruajë si formohet limfa, të numrojë elementet përbërëse të saj<br>- përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e zemrës dhe të enëve të gjakut, përkatësisht sistemin e organeve të qarkullimit të gjakut<br>- shpjegojë rrugëtimin që bënë gjaku në qarkullimin e madh dhe të vogël të tij<br>- emërtojë dhe të përshkruajë disa sëmundje të gjakut, të zemrës dhe të enëve të gjakut.<br>- përshkruajë si kryhet transfuzioni i gjakut dhe si caktohen grupet e gjakut të sistemit ABO<br>- përshkruajë reaksionet imunolo-gjike të organizmit (imunitetin qelizor dhe humoral-kimik)<br>- dallojë antigjenin prej antitrupthit dhe të përshkruajë si shfaqet imuniteti dhe alergjia<br>- emërtojë rrugët nëpërmjet të së cilave depërtojnë alergjenet në organizmin e njeriut.<br>- numërojë disa sëmundje imunologjike dhe të përshkruajë si | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | shfaqen ato<br>- dallojë vaksinën prej serumit. | |
| **I.1. Ndërtimi i qenieve të gjalla** | **I.1. Indet, organet dhe sistemet e organeve te njeriu** | **Organet e frymëmarrjes:**<br>- rrugët e frymëmarrjes - ndërtimi, funksioni<br>- këmbimi i gazrave dhe mekanizmi i frymëmarrjes<br>- sëmundjet e organeve të frymëmarrjes, reanimimi | Emërtojë rrugët e frymëmarrjes, të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e tyre.<br>- përshkruajë mekanizmat e frymëmarrjes mushkërore dhe rregullimin e saj<br>- krahasojë këmbimin e gazrave në alveole dhe në qelizë<br>- emërtojë disa sëmundje që barten nëpërmjet të ajrit dhe vlerëson pasojat e pirjes së duhanit dhe ajrit të ndotur për rrugët e frymëmarrjes<br>- përshkruajë si kryhet masazhi i zemrës, frymëmarrja artificiale dhe reanimimi | |
| **I.1. Ndërtimi i qenieve të gjalla** | **I.1. Indet, organet dhe sistemet e organeve te njeriu** | **Menagjimi me mbeturina – tajitja:**<br>- sistemi i organeve për tajitje, ndërtimi dhe funksioni<br>- sëmundjet më të shpeshta të organeve për tajitje | - definojë termin tajitje dhe të emërtojë organet kryesore për tajitje te njeriu<br>- emërtojë pjesët e veshkës, që duken në prerje tërthore dhe të përshkruajë funksionin e tyre<br>- identifikojë pjesët e nefronit dhe të përshkruajë procesin e formimit të urinës<br>emërtojë strukturat nëpër të cilat | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | rrugëton urina prej veshkës deri në mjedisin e jashtëm<br>- numrojë disa sëmundje të organeve për tajitje<br>- vlerësojë rolin e higjienës së organeve gjinore, posaçërisht te gratë gjatë menstruacionit. | |
| **I.1. Ndërtimi i qenieve të gjalla** | **I.1. Indet, organet dhe sistemet e organeve te njeriu** | **Mbulesa trupore – lëkura:** Struktura dhe funksionet e lëkurës, higjiena dhe kujdesi për të. | emërtojë tri shtresat kryesore të lëkurës, të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e tyre.<br>- emërtojë derivatet e lëkurës<br>- shpjegojë rolin mbrojtës dhe termorregullues të lëkurës<br>- vlerësojë rolin e higjienës së lëkurës (posaçërisht të duarve) për të evituar sëmundjet e sistemit tretës | Me lëndën e fizikës, kimisë, anatomisë, fiziologjisë, higjienës. |
| **II. Proceset jetësore** | **II.1.Cikli jetësor i njeriut** | Lidhmëria me mjedisin, mekanizmat rregullues.<br>**- Sistemi nervor**, ndërtimi, funksioni<br>- Sistemi nervor qendror dhe sistemi nervor periferik<br>- Kujdesi dhe sëmundjet e sistemit nervor | - përshkruajë strukturën e qelizës nervore dhe rolin e trupit të neuronit, dendriteve dhe neuritit<br>- numërojë dy karakteristika themelore të sistemit nervor, (ngacmueshmëria, përcjellshmëria) dhe të përshkruajë si bëhet transmetimi i sinjalit<br>- klasifikojë sistemin nervor (SNQ dhe SNP) | Me lëndën e fizikës, kimisë, anatomisë, fiziologjisë, imunologjisë, higjienës, hematologjisë etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | - përshkruajë rolin e sistemit nervor simpatik dhe parasimpatik.<br>- emërtojë pjesët e SNQ<br>- përshkruajë rolin biologjik të trurit dhe të palcës kurrizore<br>- sjellë shembuj dhe të argumentojë se palca kurrizore është qendër e veprimeve reflektore pa ndërmjetësim të trurit (refleksi i gjurit) | |
| | | **Organet shqisore:**<br>Ndërtimi dhe funksioni.<br>Me anë të shqisave ne shikojmë, nuhasim, shijojmë, dëgjojmë, mbajmë ekuilibrin, kemi ndjesinë e të ftohtit, të ngrohtit etj.<br>Kujdesi dhe sëmundjet më të shpeshta të organeve shqisore. | emërtojë oganet shqisore në trupin tonë dhe të numërojë pjesët e çdo shqise.<br>- përshkruajë ndërtimin e shqisës së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore dhe të analizojë funksionin e tyre.<br>- arsyetojë funksionin mbrojtës të shqisës për nuhatje dhe shije<br>- shpjegojë në saje të të cilëve receptorë njerëzit e verbër e lexojnë alfabetin e Brailit dhe si i dallojnë banknotat sipas vlerës së tyre<br>- numërojë funksionet mbrojtëse te lëkurës( nga ftohtësia, nxehtësia, mikroorganizmat etj.). | Me lëndën e fizikës, kimisë, anatomisë, fiziologjisë, higjienës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **Sistemi endokrin**<br>- gjëndrat me tajitje të brendshme: hipofiza, tiroidea, pankreasi endokrin, gjëndrat mbiveshkore, gjëndrat seksuale<br>- sëmundjet hormonale dhe shërimi i tyre. | - definojë termin sistem endokrin<br>- dallojë gjëndrat endokrine prej gjëndrave egzokrine<br>- emërtojë gjëndrat me tajitje të brendshme te njeriu dhe të përcaktojë pozitën e tyre në trup<br>- përshkruajë si gjëndrat endokrine kontrollojnë organe e funksione të caktuara nëpërmjet hormoneve<br>- emërtojë hormonet më të rëndësishme të gjëndrave endokrine dhe të përshkruajë rolin fiziologjik të tyre<br>- emërtojë disa sëmundje që shfaqen si pasojë e çrregullimit të funksionit të sistemit endokrin | Me lëndën e fizikës, kimisë, anatomisë, fiziologjisë, imunologjisë, gjenetikës, evulucionit, higjienës etj. |
| | | **Shumimi te njeriu:**<br>- veçoritë gjinore, organet seksuale, ndërtimi<br>- shumimi i qelizave gjinore (mejoza dhe gametogjeneza)<br>- frytnimi dhe zhvillimi i frytit (shtatzënësia dhe kontracepcioni)<br>- zhvillimi embrional dhe pasembrional i njeriut<br>- higjena e organeve gjinore | - përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e gjëndrave seksuale te njeriu<br>- numërojë karakteristikat primare dhe sekondare seksuale te femrat dhe te meshkujt<br>- dallojë qelizat seksuale mashkullore nga ato femërore dhe të përshkruajë si formohen ato<br>- shpjegojë si kryhet frytnimi dhe formimi i zigotës | Me lëndën e fizikës, kimisë, anatomisë, fiziologjisë, endokrinologjisë, gjenetikës, evolucionit, higjienës etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | - përshkruajë si zhvillohet shtatzënësia (graviditeti)<br>- shpjegojë rolin e gjendrave sek-suale në kontrollin dhe rregullimin e procesit të riprodhimit | |
| | **II.2. Trashëgimia te njeriu** | **Bazat e trashëgimisë te njeriu:**<br>- kromozomet dhe gjenet, -mutacionet dhe faktorët mutagjenë; sëmundjet trashëguese dhe bartja,<br>-sëmundjet e lidhura me gjininë sindromet. | - numërojë dhe të përshkruajë etapat e zhvillimit embrional dhe pasembrional te njeriu<br>- shpjegojë shkaqet e paraqitjes së sëmundjeve seksuale dhe vlerëson rolin e higjienës personale për evitimin e tyre.<br>- përshkruajë si formohen kromozomet dhe të arsyetojë pse dallohet numri i kromozomeve në qelizat trupore dhe në gamete<br>- numërojë disa cilësi që i përcaktojnë kromozomet autosome dhe kromozomet seksuale<br>- hulumtojë me cilin kombinim të kromozomeve seksuale përcaktohet seksi mashkullor dhe femëror te njeriu<br>- arsyetojë se çdo cilësi, ashtu edhe sëmundja, përcaktohet nga gjenet<br>- shpjegojë se te njeriu çdo njëri nga dy gjenet mund te jetë dominant apo | Me lëndën e fizikës, kimisë, anatomisë, fiziologjisë, imunologjisë gjenetikës, evolucionit etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | recesiv<br>- definojë termin mutacion dhe të emërtojë disa faktor mutagjenë<br>- emërtojë disa sëmundje që lidhen me seksin dhe përshkruan si shfaqen ato<br>- përkufizojë termin sindrom dhe të përshkruajë si shfaqet ai | |
| **III. Qeniet e gjalla dhe mjedisi** | **III.3. Evolucioni i njeriut** | **Antropogjeneza:**<br>- provat paleontologjike dhe etapat kryesore te antropogjenezës<br>- njeriu qenie biologjike dhe shoqërore<br><br>- kushtet që kanë ndikuar në shfaqjen e racave<br>- racat kryesore të njeriut dhe racat e përziera | - kuptoj se njeriu është produkt i përzgjedhjes natyrore dhe i kushteve jetësore<br>-përshkruajë origjinën e njeriut dhe të numërojë paraardhësit e tij<br>- shpjegojë kushtet që kanë ndikuar në lindjen e racave njerëzore,<br>- emërtojë racat kryesore dhe të interpretojë pikëpamjet pseudoshkencore për racat<br>- arsyetojë, pse në planetin tonë ekziston vetëm një lloj njeriu, përkundër dallimeve fenotipe ndërmjet racave<br>- shpjegojë si rregullohet jeta shoqërore e njeriut (me norma shoqërore, morale dhe ligje juridike). | Me lëndën e fizikës, kimisë, anatomisë, fiziologjisë, gjenetikës, antropologjisë, paleontologjisë, ekologjisë dhe embriologjisë. |

**Punë praktike:**

Me fjalën punë praktike kuptojmë aktivitetet që kryejnë nxënësit në natyrë dhe në labarator. Këto punë kryhen me qëllim të konkretizimit të pjesës teorike të lëndës.

Në mungesë të laboratoreve, punët praktike mund të kryhen edhe në klasë, me kusht që materiali dhe mjetet e punës praktike paraprakisht të sillen në klasë.

Punët laboratorike nuk janë ndonjë metodë e veçantë e mësimit, por janë formë e organizimit të punës mësimore, gjatë së cilës nxënësi në bashkëpunim me arsimtarin vrojtojnë strukturat, proceset dhe fenomenet e ndryshme jetësore.

Punët praktike, të cilat do të duhej të realizoheshin në mësimin e biologjisë për klasën e nëntë, janë:

- Vrojtimi i ndërtimit të lëkurës (në preparatin e përhershëm).
- Vrojtimi i ndërtimit të eshtrave dhe nyjëtimeve.
- Vrojtimi i indit nervor në preparatin e përhershëm.
- Hulumtimi i mprehtësisë së të parit.
- Prova e $CO_2$ në ajrin e nxjerrë jashtë.
- Matja e kapacitetit të mushkërive me anë të spirometrit.
- Vështrimi i qelizave të gjakut në preparatin e përhershëm.
- Matja e pulsit dhe e shtypjes së gjakut.
- Njohja e ndërtimit të veshkave në model.
- Vrojtimi me anë të mikroskopit i ndarjes qelizore dhe i kromozomeve te qepa.
- Diseksioni i syrit dhe vrojtimi i pjesëve të syrit (te delja, lopa).
- Diseksioni i veshkave, i zemrës apo i ndonjë organi tjetër (te delja, te lopa apo ndonjë kafshë tjetër).
- Mbetet kompetencë e arsimtarit që, varësisht nga kushtet dhe rrethanat që punon shkolla, varësisht nga pajisjet që disponon kabineti i biologjisë apo laboratori, të përzgjedhë përmbajtjen dhe mënyrën e implementimit praktik të programit mësimor.

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Mësimi në biologji, si dhe në çdo lëmë tjetër mund të kryhet në disa mënyra, d.m.th. mund te zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks i tërë procedurash, p.sh., informacioni i ri, përsëritje, përforcim, ushtrime, punë praktike. Krahas kësaj, përdoren edhe mjete materiale dhe teknike: modele, aparate dhe instrumente si dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore, si kompjuter, internet etj. Praktika ka treguar se është i suksesshëm vetëm ai mësim i cili realizohet me metoda të ndryshme, ku secila sosh ka rol dhe rëndësi të veçantë metodike. Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përputhje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtes mësimore, me bazën didaktike etj. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe të zbatimit më të shpejtë dhe më të saktë të njohurive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera.

Për përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës, p.sh.:

- Metoda e leximit dhe e punës me tekst;
- Metoda e punës praktike në laborator;
- Metoda e të mësuarit dhe të nxënit ndërveprues (p.sh., nepërmjet mjeteve multimediale, kompjuterit, programeve simuluese kompjuterike);
- Diskutimi dhe të nxënit me bashkëpunim (puna në grupe);
- Mësimdhënia përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

Në të gjitha rastet, zbatimi i metodave dhe i teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

## BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohen me sukses objektivat e planit dhe të programit të biologjisë për klasën e nëntë, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme të informacionit:

- tekste përkatëse shkollore
- revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi,

- fotografi, modele, atlasë anatomikë, histologjikë, embriologjikë, diagrame, skema, preparate.
- pajisje multimediale (programe kompjuterike, internet, CD etj.)
- aparat TV me video rekorder, grafoskop, grafofolie, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për biologjinë e njeriut.

**Videokasetat me tema nga biologjia, të titulluara në gjuhën shqipe, mund t'i siguroni në qendrat rajonale në: Ferizaj, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Gjilan.**

**Burime nga interneti**

http://curry.edschool.virginia.edu/go/frog/home.html,This site has a virtual frog dissection, ***Sistemet e organeve***

http://arbl.cvmbs.colostate.edu/hbooks/pathphys/endocrine/basics/control.html,

endokrinologji, feed-back,

http://www.psych.umn.edu/psylabs/mtfs/special.htm.

***Zhvillimi i shtazëve, zigota, embrioni, fetusa***

http://vector.cshl.org/dnaftb/DNA, ***acidet nukleike***

http://www.biology.arizona.edu/cell_bio.html cell cycle tutorial, ***reprodukimi***

http://www.stg.brown.edu/ëebs/Mendelëeb/links to mendels, ***trashëgimi***

http://www.massinteraction.org/html/genome/sickle cell information-***trashëgimi***

Është kompetencë dhe liri e arsimtarit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjidhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Kjo liri e burimeve mësimore duhet ti takojë edhe nxënësit.

## VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vrojtimit, i mbledhjes sistematike, i analizës dhe i interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në ç'shkallë nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues. Ai duhet të mbështetet në objektivat e dijes (rezultatet e prituara) të programit të lëndës përkatëse dhe të nivelit përkatës.

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo teme mësimore jep rezultate të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por vlerëson edhe shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ, i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënit nga nxënësit (merren parasysh përgjigjjet me gojë, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë ata gjatë punës eksperimentale, rezultatet e testimeve dhe të punimeve me shkrim).

Vlerësimi i nxënësve përfshin njohjen, të kuptuarit, analizën, sintezën dhe aftësitë emocionale (afektive) dhe psikomotore te nxënësve. Nxënësi " din 100 gjuhë " të të shprehurit (me gojë, shkrim, eksperiment, shkathtësi manovruese etj.), prandaj arsimtari nuk duhet të kufizohet në vlerësim të tij vetëm në një "gjuhë", siç ka qenë traditë deri më tani (vetëm përgjigjja gojore e tij).

Ky proces mbështetet në disa parime themelore:

- Përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- Zbatimi i instrumenteve përkatëse të matjes në përputhje me qëllimin, në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- Sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të të nxënit përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- Matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- Vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- Zbatimi i teknikave të vlerësimit me anë të të cilave bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

### Instrumentet e vlerësimit

Është me rëndësi sa për veçoritë që duam t`i vlerësojmë, duhet të përdorim mjetin apo instrumentin përkatës të matjes. Me çfarëdo mjeti që përdoret nuk mund të maten të gjitha veçoritë e arritshmërisë së nxënësit,

andaj duhet përdorur sa më shumë që të jetë e mundshme mjete dhe teknika të ndryshme, në mënyrë që të mbledhim informacione të mjaftueshme për të vlerësuar shkallën e arritshmërisë së nxënësit.

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- Vrojtimi;
- Pyetësori;
- Raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- Të shprehurit me gojë;
- Të shprehurit me shkrim;
- Fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- Dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- Testi i bazuar në kritere dhe në objektiva;
- Testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesat,

Si dhe teste me:

- përgjigje alternative të shumta;
- përgjigje të hapura e të shkurtuara;
- përgjigje të hapura të zgjeruara, dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

**Shkalla e përfitimit**

Pas zhvillimit të përmbajtjes së programit, nxënësit vlerësohen me notë ose me shkronjë (për një temë, për një tërësi temash, për një gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor).

Në fund të vitit mësimor, çdo nxënës duhet të arrijë njërën prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumë mirë (arritje e lartë)
- mirë (arritje mesatare)
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme)

Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

# FIZIKË

**(2 orë në javë, 70 orë në vit)**

## HYRJE

Në këtë vit, niveli shkencor i fizikës ngritet më lart, por gjithnjë duke pasur parasysh moshën dhe aftësitë psiko-fizike të nxënësve. Nxënësit do të marrin njohuri të reja për disa lëmenj të fizikës. Me disa prej tyre ata do të njihen për të parën herë (dinamika e lëngjeve, lëvizja rrethore, ekuilibri i trupave, fizika bashkëkohore), e disa prej tyre janë vazhdim i tërësive mësimore të klasës VII dhe VIII (trupat dhe vetitë e tyre, dukuritë elektrike dhe magnetike), me ç'rast bëhet zgjërimi i njohurive, përshkrimi dhe sqarimi i dukurive fizike. Për shkak të rëndësisë së tyre, këto njësi mësimore duhet të përsëriten në mënyrë që njohuritë e fituara më parë të kuptohen më mirë, si dhe të ngritet niveli i tyre shkencor, duke futur koncepte të reja.

Nëpërmjet lëndës së fizikës, nxënësit do të njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e ligjeve të natyrës. Në këtë mënyrë ata formojnë qëndrim të drejtë ndaj ruajtjes së mjedisit jetësor, kursimit të energjisë si dhe fitojnë shkathtësi jetësore dhe shprehi të punës.

Fizika si shkencë e natyrës, së bashku me shkencat e tjera, ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit të njeriut, në ngritjen e tij kulturore dhe profesionale.

## QËLLIMET

**Programi mësimor i lëndës së fizikës për klasën e nëntë ka për qëllim:**

- Zvillimin e aftësive të nxënësit për vrojtimin e dukurive fizike, përgjithësimin dhe zbatimin e tyre në zgjidhjen e detyrave praktike dhe të problemeve të jetës së përditëshme.

- Zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive të përhershme për të matur madhësitë e ndryshme fizike, përpunimin e të dhënave eksperimentale si dhe zbatimin e tyre në situata konkrete.
- Zhvillimin e shprehive për kursimin e energjisë dhe për shfrytëzimin racional të saj.
- Zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësimin për të përdorur literaturë dhe burime të tjera për nxënie.
- Të vetëdijesohet dhe të aftësohet për vlerësimin dhe ruajtjen e mjedisit jetësor.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHËSHËM DHE SPECIFIKË

Nga përmbajtja programore e klasës së tetë, nxënësit duhet të jenë në gjendje:

**Të njohin:**

- llojet e lëvizjeve (lëvizjet periodike, rrethore, lëkundjet e lira) dallimet dhe ngjashmëritë mes tyre, madhësitë që i ndërlidhin ato dhe njësitë e tyre matëse
- Instrumentet matëse optike (qelqin smadhues, syrin, mikroskopin dhe dylbitë)
- difraksionin dhe interferencën e valëve
- dukuritë radioaktive, llojet e rrezeve radioaktive dhe vetitë themelore të tyre
- strukturën e atomit dhe të bërthamës së tij.

**Të kuptojnë:**

- lidhjen e dukurive fizike me ato periodike
- përbërjen dhe zbërthimin e forcave si dhe llojet e ekuilibrit
- ç'është moti, rrymimi i ajrit, lagështia e ajrit, reshjet atmosferike
- burimet e ndotjes së ambientit jetësor, pasojat lokale dhe ato globale të ndotjes së ambientit
- proceset themelore në gaze
- paraqitjen simbolike të madhësive fizike (kapacitetin elektrik, potencialin, temperaturën absolute etj.) dhe të njësive për matjen e tyre (F, V, K etj.)
- lidhjen kualitative dhe kuantitative ndërmjet madhësive të ndryshme fizike

- procesin e matjes, grumbullimin, sistematizimin dhe përpunimin e të dhënave.

**Të zbatojnë:**

- njohuritë e fituara për matjen e madhësive të ndryshme fizike në zgjidhjen e detyrave praktike nga jeta e përditshme;
- njohuritë e fituara teorike dhe eksperimentale në zgjidhjen e problemeve praktike dhe në jetën e përditshme.
- vlerat e matjeve për ndërtimin e diagrameve të proceseve të ndryshme fizike.

**Të analizojnë:**

- me eksperimente dhe matje dukuritë e ndryshme fizike dhe nga matjet e tyre të nxjerrin përfundime të duhura.
- dukurinë fizike ose ndonjë proces, duke e zbërthyer atë në madhësi të rëndësisë së dorës së parë, dorës së dytë etj.

**Të sintetizojnë:**

- njohuritë teorike, demonstrimet dhe matjet eksperimentale për shpjegimin e drejtë të dukurive fizike
- njohuritë e reja me ato të vjetra dhe të vënë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë me anë të ndonjë modeli të përshatshëm (*duke marrë parasysh ndërtimin molekuklar të lëndës, të sqarojë dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë*).
- dhe të klasifikojnë faktorët që shkaktojnë ndryshime brenda një sistemi fizik (p.sh., *shpejtësia, forca, dhe nxehtësia*) dhe të parashikojë se ç'do të ndërrohet dhe çka jo, kur lënda i nënshtrohet veprimit të forcave të jashtme ose ndryshimit të energjisë.

**Të vlerësojnë:**

- rëndësinë e zbatimeve praktike të njohurive fizike në ndërtimin e aparateve dhe të paisjeve të ndryshme që mundësojnë jetë më të lehtë dhe më të mirë
- saktësinë e gjykimeve të tyre me anë të fakteve dhe eksperimenteve.

**Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:**

- të kuptojë përparësitë dhe kufizimet që i ofron lënda
- në ndikimin e sjelljeve personale (*të jetë i ndershëm, tolerant, i hapur, të ketë vullnet, të jetë kooperativ, kritik, krenar etj.)*

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

| Kategoritë | Nënkategoritë | Kapitujt mësimorë | Nr. i orëve | Përqindja % |
|---|---|---|---|---|
| **I. Pozita dhe lëvizja e trupave** | **I.1. Trupat dhe vetitë e tyre** | I.1.1. Dinamika e lëngjeve | 3 | 4,29 % |
| | | I.1.2. Lëvizja rrethore dhe periodike | 5 | 7,15 % |
| | **I.2. Dukuritë periodike në mjedise të vazhduara** | I.1.3. Ekuilibri i trupave | 7 | 10,01 % |
| | | I.2.4. Proceset valore | 6 | 8,58 % |
| **II. Lëvizja kaotike dhe dukuritë termike** | **II.1. Struktura molekulare - kinetike e lëndës** | II.1.5. Teoria kinetike molekulare e gazeve | 4 | 5,72 % |
| | | II.1.6.Termodinamika | 6 | 8,58 % |
| | | II.1.7. Dukuritë atmosferike dhe ndotja e mjedisit | 3 | 4,29 % |
| **III. Dukuritë elektrike dhe magnetike të lëndës** | **III.1. Vetitë elektrike dhe magnetike të lëndës** | III.1.8. Fusha dhe potenciali elektrostatik | 5 | 7,15 % |
| **IV. Drita dhe paraqitja e saj.** | **IV.2. Instrumentet optike** | IV.2.9. Optika gjeometrike | 5 | 7,15 % |
| **V. Fizika bashkëkohore** | **V.1.Atomi dhe bërthama e tij** | V.1.10. Struktura e atomit dhe bërthama e tij | 4 | 5,17 % |
| | **V.2. Vetitë mikroskopike të gjendjes së ngurtë** | V.2.11. Struktura e trupave të ngurtë | 4 | 5,17 % |
| **VI. Astronomi** | **VI.1 Toka dhe dukuritë astronomike rreth saj (5 orë)** | VI.1.12. Graviteti dhe Gjithësia | 5 | 7,15 % |
| | **VI.2. Yjet dhe galaktikat (3 orë)** | | 3 | 4,29 % |
| | | **Gjithsej** | 60 | 85,80 % |

Gjithsej 60 orë (42 +18) + 10 orë ushtrime laboratorike 10 orë 14,30 %.

| Kategoria | Nënkategoria | Përmbajtja programore | Rezultatet e pritura | Lidhja ndërlëndore |
|---|---|---|---|---|
| **I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE** | **I.1. Trupat dhe vetitë e tyre, (17 orë)**<br><br>**(3+5+7)** | **I.1.1. Dinamika e lëngjeve**<br>1.1. Lëvizja e lëngjeve (vijat dhe tubi i rrymimit. Ekuacioni i kontinuitetit)<br>1.2. Viskoziteti i lëngjeve | **Nxënësi duhet të jetë në gjendje**:<br>- të shpjegojë lëvizjen e lëngjeve ideale me anë të shembujve të ndryshëm<br>- të paraqesë ekuacionin e kontinuitetit me formulë | Me kimi, matematikë |
| | | **I.1.2 Lëvizja rrethore dhe periodike**<br>2.1. Si formohet lëvizja rrethore.Forca centrifugale<br>2.2. Lëvizja periodike. Lavjerrësi<br>2.3. Lëvizja lëkundëse (lëkundjet harmonike). Lidhja e lëvizjeve rrethore me ato periodike. | - të tregojë si formohet lëvizja rrethore në praktikë dhe në natyrë<br>- të numërojë lëvizje të ndryshme periodike dhe lëvizje rrethore në praktikë dhe në natyrë<br>- të dallojë forcën centri-fugale nga ajo centripetale në shembujt e dhënë<br>- të bëjë lidhjen e lëvizjeve rrethore me ato periodike me anë të shembujve. | Me astronomi, teknologji, industri, matematikë |
| | | **I.1.3. Ekuilibri i trupave**<br>3.1.Ekuilibri i forcave. (disa | - të tregojë se ç'është ekuilibri i forcave në | Me makineri, industri, kimi, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | veprime me vektorë)<br>3.2. Përbërja dhe zbërthimi i forcave<br>3.3. Qendra e rëndimit të trupave. Llojet e ekuilibrit<br>3.4. Momenti i forcës. Llozi në ekuilibër<br>3.5. Rendimenti te makinat e thjeshta. (Rregulla e artë e mekanikës) | shenbujt e dhënë<br>- të shpjegojë rregullen e artë të mekanikës<br>- të llogaritë rendimentin te makinat e thjeshta<br>- të llogaritë përbërjen dhe zbërthimin e forcave si dhe momentin e forcës në detyrat e dhëna. | matematikë |
| **I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE** | **I.2. Dukuritë periodike në mjedise të vazhduara**<br>**(6 orë)** | **I.2.4. Proceset valore**<br>4.1.Valët bartin energji<br>4.2. Përhapja e valeve në mjedise të vazhduara. Parimi i Hajgensit dhe zbatimi<br>4.3. Ultrazëri dhe infrazëri<br>4.4. Interferimi dhe difraktimi i valëve mekanike. | **Nxënësi duhet të jetë në gjendje** :<br>- të shpjegojë parimin e Hajgensit me anë të shembujve (viz.)<br>- të tregojë për apliki-min e ultrazërit në praktikë<br>- të identifikojë interfe-rencën dhe difraksionin e valëve në shembujt e dhënë. | Me teknologji, mjekësi |
| **II. LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE** | **II.1. Struktura molekulare-kinetike e lëndës**<br>**(14 orë)**<br><br>**(4+6+3)** | **II.1.5. Teoria kinetike molekulare e gazeve**<br>5.1. Përbërja e lëndës dhe lëvizja kaotike e molekulave<br>5.2. Gazet ideale dhe reale.<br>5.3. Proceset themelore në gaze | **Nxënësi duhet të jetë në gjendje** :<br>- të tregojë me fjalë të tij se ç'është gazi ideal dhe gazi real<br>- të shpjegojë ndërtimin e | Me lëndën e kimisë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | lëndës nga grimacat dhe t'i emërtojë ato<br>- të shpjegojë proceset themelore në gaze | |
| | | **II.1.6.Termodinamika**<br>6.1. Energjia e brendshme dhe nxehtësia<br>6.2. Puna gjatë bymimit të gazeve. Parimi i parë i termodinamikës<br>6.3. Proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme .Parimi i dytë i termodinamikës<br>6.4. Motorët me djegie të brendshme. | - të përkufizojë parimin e parë dhe të dytë të termodinamikës<br>- të tregoj lidhjen e ener-gjisë së brendshme dhe të nxehtësisë<br>- të tregojë sesi kryhet pu-na gjatë bymimit të gazit ideal<br>- të shpjegojë parimin e punës së motorëve me djegie të brendshme | Me kimi, industri, teknologji, matematikë |
| | | **II.1.7. Dukuritë atmosferike dhe ndotja e ajrit**<br>7.1. Lagështia e ajri.<br>Reshjet atmosferike<br>Ç'është moti.<br>a) Rrymimi i ajrit.<br>b) Erërat.<br>7.2. Ndotja e ajrit dhe e mjedisit jetësor | - të trgojë burimet e ndot-jes lokale dhe të asaj globale<br>- të tregojë mënyra të ndryshme për zvogëlimin e ndotjes dhe mbrojtjen e ajrit nga ndotja<br>- të shpjegojë krijimin e lagështisë së ajrit, | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | a). Burimet e ndotjes së mjedisit dhe pasojat (lokale dhe globale) | reshjeve atmosferike, erërave dhe rrymimit të ajrit me fjalë të veta. | |
| **III. DUKURITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE TË LËNDËS** | **III.1. Vetitë elektrike dhe magnetike të lëndës (5 orë)** | **III.1.8. Fusha dhe potenciali elektrostatik**<br>8.1. Ligji i Kulonit. Forcat elektrike dhe fusha.<br>8.2. Potenciali elektrik. Tensioni<br>8.3. Kapaciteti elektrik.Kondensatorët (lidhja) | **Nxënësi duhet të jetë në gjendje**:<br>- të shpjegojë nocionin e fushës elektrostatike (elektrike) me fjalë (viz.)<br>- të përkufizojë ligjin e Kulonit me fjalë dhe formulë matematike<br>- të përkufizojë poten-cialin elektrik, tensionin dhe kapacitetin elektrik<br>- të llogaritë kapacitetin elektrik me anë të formu-lës përkatëse për lloje të ndryshme të konden-satorëve. | Me matematikë, industri, teknologji etj. |
| **IV. DRITA DHE PARAQITJA E SAJ** | **IV.2. Instrumentet optike (5 orë)** | **IV.2.9. Optika gjeometrike**<br>9.1.Thyerja e dritës nëpër pllakë dhe prizm optik. Dispersioni i dritës<br>9.2. Thjerrat optike<br>9.3. Instrumentet optike (Qelqi zmadhues. Mikroskopi optik, | **Nxënësi duhet të jetë në gjendje**:<br>- të tregojë ngjyrat spektrale të dritës sipas renditjes që kanë<br>- të pëkufizojë disa madhësi nga: fotometria, | Me mjekësi, astronomi, kimi, biologji, industri, teknologji etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | syri, dylbitë etj).<br>9.4. Fotomotri (fluksi, intensiteti, ndriçimi, energjia ) | si: fluksi, intensiteti, ndriçimi etj.<br>- të dallojë thjerrat optike konvergjente nga ato divergjente<br>- të shpjegojë thyerjen e dritës te thjerrat optike<br>- të dallojë instrumentet e ndryshme optike, njërin nga tjetri, p.sh., qelqi zmadhues, mikroskopi, syri, dylbitë etj. | |
| **V. FIZIKA BASHKË-KOHORE** | **V.1. Atomi dhe bërthama e tij**<br>**( 4 orë )**<br><br>**V.2. Vetitë mikroskopike të gjendjes së ngurtë** | **V.1.10. Struktura e atomit dhe bërthama e tij**<br>10.1.Bërthama dhe forcat bërthamore<br>a) Ndërtimi i bërthamës<br>b) Forcat bërthamore<br>c) Shndërrimi i bërthamave<br>10.2. Dukuritë radioaktive (rrezet $\alpha$ , $\beta$ , $\gamma$ )<br>10.3. Shfrytëzimi dhe përdorimi i energjisë bërthamore<br><br>**V.2.11. Struktura e trupave të ngurtë**<br>11.1. Molekulat, atomet dhe | **Nxënësi duhet të jetë në gjendje**:<br>- të tregojë vetitë e forcave bërthamore<br>- të përshkruajë vetitë kryesore të rrezeve radioaktive ( $\alpha$ , $\beta$ , $\gamma$ )<br>- të tregojë mundësitë e shfrytëzimit të energjisë bërthamore<br><br>- të pëshkruajë strukturën e trupave të ngurtë (kristaleve) | Me kimi, mjekësi, teknologji etj.<br><br>Me kimi, teknologji, shkencën e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **(4 orë)** | kristalet<br>11.2. Gjysmëpërçuesit.<br>Supërpërçuesit<br>11.3.Transistorët | - të përshkruajë gjysmëpërçuesit dhe superpërçuesit e rrymës elektrike. | materialeve, elektronikë |
| **VI. ASTRONOMI** | **VI.1. Toka dhe dukuritë astronomike rreth saj**<br><br>**(5 orë)** | **VI.1.12. Graviteti dhe Gjithësia**<br>12.1. Ligji i Njutonit mbi gravitacionin<br>12.2. Lëvizja e trupave në fushën e gravitetit. Shpejtësitë kozmike. Gjendja pa peshë e trupave<br>12.3. Sistemi diellor, përbërja dhe madhësia.<br>12.4. Planetet dhe satelitët e tyre. | **Nxënësi duhet të jetë në gjendje**:<br>- të shpjegojë ligjin e Njutonit mbi gravitacionin<br>- të pëkufizojë shpejtësitë kozmike<br>- të përshkruaj sistemin diellor, planetet dhe satelitet e tyre | Me astronomi, gjeografi |
| | **VI.2. Yjet dhe galaktikat**<br>**(3 orë )** | 12.5.Yjet dhe galaktikat (Dielli, yjet dhe galaktikat). Formimi dhe zhvillimi i gjithësisë Fluturimet kozmike<br>12.6. Gjithësia. Kozmologjia | -të përshkruaj yjet, galaktikat, formimin dhe zhvillimin e gjithësisë gjatë kohës<br>- të tregojë fluturi-met kozmike sipas kronologjisë ose sipas radhës. | Me astronomi, kosmologji |

**Ushtrime laboratorike 10 orë**

1.Përcaktimi i viskozitetit të lëngut
2.Përcaktimi i nxitimit të rëdimit tokësor me anë të lavjerrësit matematik
3.Përcaktimi i lagështisë absolute dhe relative të ajrit.
4.Përcaktimi i largësisë fokale
5.Vërtetimi i ligjit të Bojl- Mariotit
6.Vërtetimi ligjit të Gej –Lisakut
7.Vërtetimi i ligjit të Sharlit
8.Përcaktimi i koeficientit të fërkimit me anë të rrafshit të pjerrët
9.Mledhja e forcave që formojnë një kënd ndërmjet tyre
10.Mledhja e dy forcave paralele me kahje të njëjta
11. Mledhja e dy forcave paralele me kahje të kundërta
12 Përcaktimi i dendësisë së lëngjeve dhe i trupave të ngurtë
13. Përcaktimi i shpejtësisë së zërit me anë të rezonancës së shtyllës së ajrit
14. Përcaktimi i gjatësisë valore te valët e qendrueshme
15.Vëretetimi i ligjit të Omit për një pjesë të qarkut (për rrymat e vijueshme)

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përvoja ka treguar se realizimi i procesit të mësimdhënies me metoda të ndryshme është shumë më efektiv dhe më i suksesshëm. Prandaj, edhe mësimi i fizikës duhet të bëhet duke shfrytëzuar dhe duke kombinuar metodat e ndryshme të mësimit. Këtu do t'i numërojmë vetëm ato metoda të cilat më shpesh dhe më shumë përdoren, e këto janë:

- Metoda e të shprehurit me gojë
- Metoda e bashkëbisedimit (këtu hyn edhe metoda aktive e mësimdhënies)
- Metoda e demonstrimit
- Metoda e punës eksperimentale.

Përveç këtyre metodave, përdoren edhe metoda dhe teknika të tjera të mësimëdhënies, p.sh., **metoda interaktive**, e cila është mjaft produktive me punën në grupe dhe ekipe të nxënësve. Arsimtari i fizikës duhet t'i përdorë të dy këto metoda, edhe atë **aktive** edhe atë **interaktive.**

Mirëpo, kombinimi i këtyre metodave mësimore është më i suksesshëm, sepse zgjon kureshtjen dhe nxit interesimin e nxënësve. Mandej, pasojnë zbatimi konkret dhe praktik i njohurive në zgjidhjen e detyrave, që te nxënësi krijon kujtesë të pashlyeshme.

## VLERËSIMI I DITURIVE TË NXËNËSVE

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike dhe të vazhdueshme, analizës dhe interpretimit të të dhënave me qëllim të përcaktimit se në ç'shkallë nxënësi i ka zotëruar objektivat e përgjithshëm dhe specifikë të lëndës së fizikës.

**Qëllimi i vlerësimit** tregon cakun përfundimtar të një lloj vlerësimi, rezultatin përfundimtar që shtrohet për t'u arritur me një metodë të caktuar të vlerësimit.

Në mënyrë që arsimtarit t'i lehtësohet puna e tij me nxënës, i sugjerohet të punojë me këto teknika dhe lloje të vlerësimit:

- **Vlerësimi sipas aktivitetit**

Arsimtari duhet ta pranojë nxënësin si partner të bashkëbisedimit. Prandaj, duke provuar që nxënësin ta kyç në bashkëbisedim gjatë procesit të mesimit, njëkohësisht do ta vlerësojë sa është në gjendje të përvetësojë njësinë mësimore. Në këtë mënyrë, nxënësi do të jetë vazhdimisht aktiv në marrjen e përfundimeve për ligjshmëritë që udhëheqin një dukuri fizike. Nxënësit e ndryshëm, për të njëtën problematikë, mund të arrijnë në përfundime të ndryshme.

- **Vlerësimi me gojë (intervista)**

Ka nxënës që janë mjaft të përgatitur, por janë të tërhequr, jo aq aktivë dhe nuk marrin pjesë në bashkëbisedim. Për këtë arsye arsimtari duhet që këta nxënës t'i thërrasë dhe t'i pyesë me gojë në mënyrë klasike, në mënyrë që arsimtari të kuptojë nivelin e arritshmërisë së tyre. Edhe kjo mënyrë realizohet në formë bashkëbisedimi me tërë nxënësit e klasës dhe veç e veç.

- **Vlerësimi nga zgjidhja e detyrave në klasë dhe në shtëpi**

Në programin e fizikës për klasën IX janë paraparë zgjidhje detyrash, detyra për përsëritje dhe detyra kontrolli. Në këtë rast, nxënësit duhet vazhdimisht të kyçen në zgjidhjen e këtyre detyrave në tabelë apo në

fletore. Ky aktivitet i nxënësve duhet të merret si parametër për vlerësimin e diturisë.

- **Vlerësimi me anë të testeve**

Mënyra e vlerësimit të njohurive të nxënësve të tërë klasës me teste arsimtarit i ofron një pasqyrë për nivelin e zotërimit të lëndës mësimore. Kjo metodë do të jetë aq më e saktë sa më tepër kohë që arsimtari do t'i kushtojë mënyrës së drejtë të përpilimit të testeve, duke pasur parasysh kriteret e hartimit të testeve sipas taksonomisë së Blumit, të cilat janë: niveli i njohjes (kognitiv), kuptimi, zbatimi, analiza dhe sinteza. Në çdo gjysmëvjetor përpilohet nga një test vlerësues dhe nga një test i përparimit dhe, në fund të vitit, një test përfundimtar (përmbledhës).

- **Vlerësimi sipas aktivitetit në laboratorin e shkollës**

Në ato shkolla ku ekziston kabineti i fizikës, arsimtari sipas programit do të demonstrojë ose do të kryejë ndonjë matje të ndonjë madhësie ose dukurie fizike.

Gjithashtu, është me rëndësi kreativiteti i mësimdhënësit me rastin e organizimit të orës së mësimit, me ç'rast duhet përdorur shpesh teknika të reja duke sjellë kësisoji risi në mënyrën e punës dhe duke ngritur njëkohësisht shkallën e interesimit të nxënësit për mësimin e fizikës.

Pikërisht gjatë këtij angazhimi të arsimtarit, disa nxënës nga kureshtja do të jenë më aktiv se të tjerët. Ata do t'i ndihmojnë arsimtarit në procesin e demonstrimit apo matjes, apo do ta kryejnë në mënyrë të pavarur. Edhe ky aktivitet duhet të vlerësohet.

- **Vlerësimi i punës së pavarur praktike të nxënësve në shkollë dhe në shtëpi**

Vlerësimi i diturive të nxënësve kryhet edhe nga përcjellja e aktivitetit të tyre në punë praktike individuale dhe në grupe. Nxënësit do të marrin nga arsimtari detyra konkrete, të cilat do t'i realizojnë në mënyrë praktike.

Vlerësimi i raportit me shkrim të një pune praktike apo një hulumtimi të pavarur.

# KIMI

**(2 orë në javë, 70 orë në vit)**

## HYRJE

Lënda Kimia 9 paraqet vazhdimësi të lëndës që është zhvilluar në Kiminë 7 dhe Kiminë 8. Njëherësh, kjo lëndë është finalizim i përmbajtjeve të parapara për këtë nivel shkollor. Në këtë klasë do të përfshihen përmbajtjet nga kimia e komponimeve të karbonit. Konkretisht ,do të shtjellohen hidrokarburet, komponimet organike me oksigjen dhe azot, si dhe ato me rëndësi të veçantë për jetë (karbohidratet, yndyrat, proteinat).

## QËLLIMET

Nxënësit të:

- Zhvillojnë njohuritë themelorë për komponimet e karbonit dhe vetitë karakteristike të tyre përmes qasjeve dhe aktiviteteve të ndryshme dhe punëve eksperimentale.
- Vlerësojnë rëndësinë fundamentale e praktike dhe shumëllojshmërinë e komponimeve të karbonit si përbërës të organizmave të gjallë dhe si pjesë e jetës sonë, si dhe rëndësinë e tyre në lëmë të ndryshme të ekonomisë dhe për jetën e përditshme.
- Zhvillojnë dhe të kultivojnë shprehitë dhe shkathtësitë për punë të pavarur teorike, eksperimentale e praktike dhe të krijojnë kulturën për mbrojtjen e mjedisit.
- Formohen si personalitet me qëndrim kritik dhe me kulturë për bashkëpunim të ndërsjelltë, me arsimtarë, prindër dhe me komunitete shkollore dhe jashtëshkollore për avancimin e të menduarit kritik dhe të pavarur.

**OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM dhe specifikË:**

Nxënësit duhet:

**Të njohin:**

- Terminologjinë, konceptet, dukuritë, faktet, teoritë dhe ligjet themelore në kiminë organike.
- Vetitë e karbonit dhe të komponimeve më të rëndësishme të tij, përbërjen dhe strukturën e komponimeve organike, metodat e përfitimit të disa komponimeve organike dhe përdorimin e tyre.

**Të kuptojnë:**

- Proceset më të rëndësishme në bazë të të cilave zhvillohen reaksionet organike.
- Vetitë e komponimeve organike varen nga struktura dhe grupet funksionore që i përmbajnë në molekulat e tyre.

**Të zbatojnë:**

- Rregullat e Unionit Ndërkombëtar për Kimi të Pastër dhe të Zbatuar (IUPAC) për emërtimin e komponimeve organike.
- Përdorimin e modeleve molekulare për paraqitjen e strukturës së komponimeve të thjeshta organike.

**Të analizojnë:**

- Përbërjen dhe vetitë e komponimeve organike.
- Shdërrimet kimike dhe mënyrën e zhvillimit të disa reaksioneve të thjeshta organike.

**Të sintetizojnë:**

- Komponimet e thjeshta organike.
- Komponimet organike me përdorim në jetën e përditshme.

**Të vlerësojnë:**

- Rëndësinë e komponimeve organike për proceset jetësore në organizëm dhe për nevojat industriale dhe jetësore.

- Lidhmërinë midis e komponimeve organike dhe të atyre inorganike si dhe dallimet, duke u bazuar në strukturën dhe në vetitë e tyre.
- Efektet eventuale negative të disa komponimeve organike për mjedisin dhe ruajtjen e tij.

## PËRMBAJTJA PROGRAMORE

| Kategoritë | Nënkategoritë | Numri i orëve | % |
|---|---|---|---|
| **I. Komponimet organike të karbonit** | 1. Konceptet themelore në kiminë organike | **12** | |
| | 2. Hidrokarburet | **16** | |
| | 3. Komponimet organike me oksigjen dhe azot | **18** | |
| | 4. Komponimet organike me rëndësi jetësore | **24** | |

| Kategoria | Nënka-tegoria | Përmbajtja programore | Rezultatet e pritshme | Lidhjet ndërlëndore |
|---|---|---|---|---|
| **I. Kompo-nimet organike të karbonit** | **I. 1. Kup-timet themelore në kiminë organike** | **I. 1. 1.Kimia organike dhe rëndësia e saj**<br>(zhvillimi historik, rëndësia e saj në teknikë, ekonomi, bujqësi, mjekësi, jetën e përditshme)<br>**I.1.2 Atomi i karbonit element përbërës i të gjitha komponimeve organike**<br>(konfiguracioni elektronik dhe valenca e tij)<br>**I. 1.3. Veçoritë e komponimeve organike dhe klasifikimi i tyre**<br>(vetitë e komponimeve orga-nike, klasifikimi sipas struk-turës dhe grupeve funksionore)<br>**I. 1. 4. Përbërja e komponimeve organike**<br>(elementet përbërëse në komponimet organike)<br>**I. 1. 5. Lidhjet kimike në komponimet organike**<br>(lidhjet kovalente, strukturat e Luisit) | ***Nxënësit do të jenë në gjendje:***<br>1. Të përshkruajnë zhvillimin historik të kimisë organike dhe rëndësinë e saj.<br>2. Të përshkruajnë strukturën elektronike të atomit të karbonit,valencën dhe mënyrën e lidhjes.<br>3. Të dallojnë komponimet organike nga ato inorganike sipas vetive të tyre fizike e kimike.<br>4. Të klasifikojnë komponimet organike në bazë të elementeve përbërëse dhe grupeve funksionore.<br>5. Të paraqesin komponimet organike me formula molekulare dhe strukturore të Luisit, të Kekuleut dhe me ato racionale. | ▪ **Fizikë** konstantat fizike të komponimeve organike<br>▪ **Informatikë** (shfrytëzimi i informatave nga interrneti për hidrokarbure)<br>▪ **Industri** (përdorimi i hidrokarbureve në industri) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **I. Kompo-nimet organike të karbonit** | **I. 2. Hidro-karburet** | **I. 2. 1.Hidrokarburet dhe klasifikimi i tyre**<br>(alifatike dhe aromatike)<br>**I. 2. 2. Alkanet**<br>(përbërja, emërtimi, seria homologe, izomeria strukturore, vetitë, përhapja, përdorimi)<br>**I. 2. 3. Alkenet**<br>(përbërja, struktura, emërtimi, izomeria cis-trans, vetitë, përfitimi, përdorimi)<br>**I. 2. 4. Alkinet**<br>(përbërja, struktura, emërtimi, vetitë, përfitimi, përdorimi )<br>**I. 2. 5. Hidrokarburet aromatike -benzeni**<br>(përbërja, struktura, vetitë, përfitimi, reaksionet, përdorimi)<br><br>**1.2.6.Lëndët e djegshme**<br>(qymyri, nafta, gazi natyror) | ***Nxënësit do të jenë në gjendje:***<br>1.Të klasifikojnë hidrokarburet sipas vetive të tyre dhe sipas strukturës së vargut karbonik.<br>2.Të emërtojnë hidrokarburet sipas nomenklaturës "IUPAC"<br>3.Të dallojnë izomerët vargorë dhe pozicionalë të alkaneve<br>4.Të përshkruajnë përbërjen, vetitë, reaksionet e alkaneve, alkeneve dhe alkineve.<br>5.Të paraqesin hidrokarburet alifatike dhe ato aromatike me formula molekulare dhe të strukturës.<br>6.Të dallojnë izomerët cis dhe trans tek alkenet.<br>7.Të ndërtojnë modele molekulare për paraqitjen e hidrokarbureve në shembuj të thjeshtë.<br>8.Të përshkruajnë origjinën, përbërjen, vetitë, përhapjen dhe përdorimin e lëndëve të djegshme.<br>9.Të vlerësojnë rëndësinë e hidrokarbureve si lëndë të djegshme dhe si lëndë të para industriale dhe efektet negative në mjedis. | ▪ **Fizikë** (vetitë fizike të komponimeve organike, caktimi i konstanteve fizike.)<br>▪ **Informatikë** (shfrytëzimi i informatave nga interneti për hidrokarbure)<br>▪ **Industri** (përdorimi i hidrokarbureve në industri) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **I. Kompo-nimet organike të karbonit** | **I. 3. Kompo-nimet organike me oksigjen dhe me azot** | **I. 3. 1. Alkoolet dhe fenolet**<br>(definimi, përftimi, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përfitimi, përdorimi)<br><br>**I. 3. 2. Aldehidet dhe ketonet**<br>(definimi, struktura, emërtimi, përfitimi, vetitë, reaksionet, përdorimi)<br><br>**I. 3. 3. Acidet karboksilike**<br>(definimi, struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, përftimi, reaksionet, derivatet, përdorimi)<br><br>**I. 3. 4. Esteret**<br>(definimi, struktura, vetitë, përhapja reaksionet, përdorimi)<br><br>**I. 3. 5. Aminat**<br>(definimi, struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, përfitimi, përdorimi) | ***Nxënësit do të jenë në gjendje:***<br>1. Të paraqesin alkoolet me ndihmën e formulave strukturore për shembuj të tjeshtë.<br>2. Të përshkruajnë përfitimin, vetitë dhe përdorimin e alkooleve.<br>3. Të dallojnë alkoolet sipas strukturës së vargut karbonik.<br>4. Të klasifikojnë alkoolet sipas numrit të grupeve hidroksile.<br>5. Të emërtojnë alkoolet në bazë të sistemit "IUPAC" dhe sistemit klasik (të vjetër).<br>6. Të dallojnë fenolet nga alkoolet në bazë të vetive të tyre.<br>7. Të përshkruajnë vetitë e fenolit.<br>8. Të përshkruajnë strukturën e aldehideve dhe të ketoneve dhe të bëjnë dallimin midis tyre.<br>9. Të emërtojnë aldehidet dhe ketonet sipas sistemit "IUPAC"dhe klasik.<br>10. Të përshkruajnë strukturën,vetitë dhe përdorimin e acideve karboksilike dhe derivative të tyre.<br>11. Të emërtojnë acidet karboksilike sipas ssistemit klasik dhe "IUPAC".<br>12. Të klasifikojnë acidet karboksilike sipas numrit të grupava funksionore. | ▪ **Fizikë** (konstantet fizike të komponimeve organike me oksigjen<br>▪ **Biologji** (përhapja dhe funksioni i komponimeve organike me oksigjen në organizmat e gjallë)<br>▪ **Informatikë** (shfrytëzimi i informatave nga interneti për komponimet organike me oksigjen)<br>▪ **Mjekësi** (përdorimi i alkoolit në mjekësi)<br>▪ **Industri** (prodhimi dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 13. Të përshkruajnë përftimin, vetitë, emërtimin dhe rolin e estereve.<br>14. Të paraqesin aminat me formula strukturore.<br>15. Të klasifikojnë aminat sipas strukturës së tyre<br>16. Të emërtojnë aminat sipas sistemit "IUPAC" dhe klasik.<br>17. Të demonstrojnë mënyrën e përftimit të komponimeve organike me oksigjen dhe azot. | përdorimi i komponimeve organike me oksigjen në industri |
| **I. Kompo-nimet organike të karbonit** | **I. 4. Kompo-nimet organike me rëndësi jetësore** | **I. 4. 1. Lipidet (yndyrat dhe vajrat)**<br>(përbërja,përftimi, vetitë, klasifikimi dhe rëndësia e lipideve)<br><br>**I. 4. 2. Sapunet dhe deterxhentet**<br>(përfitimi, vetitë, klasifikimi, përdorimi)<br><br>**I. 4. 3. Karbohidratet dhe klasifikimi i tyre**<br>(përbërja, klasifikimi, vetitë, përdorimi) | ***Nxënësit do të jenë në gjendje:***<br>1. Të përshkruajnë lipidet, karbohidratet dhe proteinat si përbërës kryesor të ushqimit.<br>2. Të përshkruajnë përbërjen e gliceridеve (yndyrat dhe vajrat) të thjeshta.<br>3. Të përshkruajnë vetitë e lipideve dhe përhapjen e tyre.<br>4. Të vlerësojnë rëndësinë e lipideve për organizmat e gjallë.<br>5. Të dallojnë sapunet nga detergjentët.<br>6. Të paraqesin karbohidratet me formula molekulare,strukturore dhe me modele molekulare.<br>7. Të klasifikojnë karbohidratet në bazë të vargut karbonik dhe numrit të njësive | ▪ **Fizikë** (vetitë fizike të komponimeve organike me azot)<br>**Informatikë** (shfrytëzimi i informatave nga interneti për komponimet organike me rëndësi biologjike)<br>▪ **Biologji** (funksioni i komponimeve |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **I. 4. 4. Monosakaridet**<br>(përbërja, klasifikimi, vetitë, përdorimi)<br><br>**I. 4. 5. Disakaridet**<br>(përbërja, vetitë, përdorimi)<br><br>**I. 4. 6. Polisakaridet**<br>(amidoni, celuloza, glikogjeni, struktura, vetitë, përhapja, përdorimi)<br><br>**I. 4. 7. Alkaloidet dhe vitaminat**<br>(vetitë e përgjithshme, veprimi fiziologjik në organizëm)<br><br>**I. 4. 8. Aminoacidet dhe proteinat**<br>(përbërja, emërtimi, klasifikimi, vetitë, veprimi fiziologjik në organizëm)<br><br>**I. 4. 9. Polimerët**<br>(përbërja, përftimi, vetitë, klasifikimi, rëndësia) | përbërëse.<br>8. Të përshkruajnë vetitë e karbohidrateve dhe rëndësinë e tyre.<br>9. Të paraqesin disakaridet dhe polisakarideve me formula kimike dhe modeleve molekulare.<br>10. Të klasifikojnë alkaloidet sipas veprimit të tyre.<br>11. Të përshkruajnë veprimin fiziologjik të alkaloideve dhe të vitaminave në organizëm.<br>12. Të vlerësojnë rëndësinë e alkaloideve dhe të vitaminave për funksionimin normal të organizmit dhe për mbrojtjen e tij.<br>13. Të përshkruajnë strukturën e aminoacideve dhe të proteinave.<br>14. Të klasifikojnë aminoacidet sipas pozitës së grupeve funksionore.<br>15. Të përshkruajnë strukturën e proteinave.<br>16. Të vlerësojnë rëndësinë e proteinave për zhvillimin e proceseve jetësore.<br>17. Të përshkruajnë mënyrën e formimit të polimerëve.<br>18. Të klasifikojnë polimerët sipas prejardhjes së tyre.<br>19. Të vlerësojnë rëndësinë e polimerëve për jetë e industri dhe ndikimin e tyre në ndotjen e mjedisit. | organike në organizmat e gjallë)<br>▪ **Industri** (prodhimi dhe përdorimi i polimerëve |

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe të programit të kimisë është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks i tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforcim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike, siç janë: vizatime, diagrame, modele, grafikone, kimikate, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore, kompjuter etj).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, ngase nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të të lehtë të përmbajtieve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të kimisë, e veçanërisht të atyre që u nevojiten për zgjedhjen e problemeve të përditshme.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma të punës dhe teknika të ndryshme:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejt (përmes shpjegimit, sqarimit, ushtrimeve praktike dhe shembujve);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (përmes shqyrtimit, zbulimit, zgjidhjes së problemeve);
- Konstruktivizmi dhe mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (përmes grupeve të vogla, grupeve më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes demonstrimit dhe eksperimentit;

- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Vetë hulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe objekte industriale;

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

## VLERËSIMI

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi.Vlerësimi si një sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënit të nxënësve përfshin këto

Kategori të vlerësimit:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo teme mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ, i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënit e nxënësit (përgjigjet me gojë, projektet, punimet seminarike, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testimeve dhe provimeve etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshinë tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta të vlerësimit dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit, nxënësit

vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një semestër ose gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimit duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimi i shërbejnë mësimdhënësit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojnë përparimin e nxënësve
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojnë për përmirësimin e mësimdhënies bazuar në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

## BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet me sukses mësimdhënia dhe mësimnxënia e planit dhe e programit të kimisë, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme të informimi:

1) Laboratori (kabineti) i kimisë ose laboratori mobil.
2) Teksti i kimisë, doracak për mësimdhënës, praktikume, fletore pune dhe libra të tjerë të ngjashëm në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja.
3) Sistem periodik të elementeve, fotografi, modele, skema, diagrame, makete, koleksionar të materialeve të ndryshme.
4) Revista profesionale dhe shkencore, fjalor, enciklopedi.
5) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
6) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
7) FJALORI I KIMISË, SH.B. '8 Nëntori" Tiranë.

8) Bardhyl Musai, METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, Tiranë, 2003.

9) Grup autorësh, METODAT E MËSIMDHËNIES (Manual për mësuesit e rinj).

10) Literatura tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjetet e tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimdhënësit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuele, e me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

## GJEOGRAFI - KOSOVA ME VENDET PËRRETH

**(1 orë në javë, 35 orë në vit)**

### HYRJE

Gjeografia e klasës IX ka për objekt studimi hapësirën e Gadishullit Ballkanik, Kosovën, Shqipërinë dhe shtetet e tyre fqinje, duke i njohur karakteristikat e përgjithshme e të veçanta të hapësirës së tyre dhe rolin e kushteve natyrore e shoqërore-ekonomike në zhvillimin e ndryshëm të këtyre vendeve.

### QËLLIMET

- **Zhvillimin e aftësive për të njohur dhe për të kuptuar pozitën gjeografike, veçoritë e natyrës** (ndërtimin gjeologjik, relievin, klimën, ujërat, llojet e tokave dhe botën bimore e shtazore), **veçoritë humane** (popullsinë, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike) të Kosovës dhe të vendeve përreth, **duke kuptuar lidhjet** ndërmjet veçorive natyrore dhe shoqërore dhe **ndikimin e tyre** në aktivitetet njerëzore, **sfidat dhe perspektivat**.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësve **për të çmuar trashëgiminë kulturore e natyrore** të Kosoves dhe të vendeve përreth.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësit **për të fituar shkathtësi dhe shprehi** për përdorimin e të dhënave verbale, sasiore dhe simbolike të tekstit, fotografive, tabelave, diagrameve dhe hartave.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për të krijuar gatishmëri **për të përdorur drejt dhe me përgjegjësi njohuritë**, shkathtësitë dhe shprehitë e fituara nga mësimi i gjeografisë së Kosovës dhe i vendeve përreth.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësit **për të respektuar të drejtat njerëzore** në Kosovë dhe vendet përreth, barazi kombëtare, fetare,

gjuhësore, kulturore, gjinore dhe angazhim për të kërkuar zgjidhje të problemeve lokale, kombëtare dhe rajonale etj.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

➢ **Të njoh:**
- Faktet për veçoritë natyrore e humane të Kosovës dhe të vendeve përreth.
- Konceptet për karakteristikat natyrore e humane të Kosovës dhe të vendeve përreth.

➢ **Të kuptojë**:
- Specifikat gjeografike të Kosovës dhe të vendeve përreth (specifikat natyrore, shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike të tyre).

➢ **Të zbatojë**:
- Përdorimin e grafikëve, diagrameve, hartave tematike, nga të dhënat statistikore për Kosovën dhe vendet përreth.
- Punimin e hartave, grafikëve, diagrameve etj. nga të dhënat statistikore për Kosovën dhe për vendet përreth.

➢ **Të analizojë**:
- Ndikimin e kushteve natyrore, të faktorëve shoqërorë e politikë në Kosovë dhe të vendeve përreth.
- Rolin e kushteve natyrore, faktorëve shoqërorë në zhvillimin shoqëror e ekonomik të Kosovës dhe të vendeve përreth.

➢ **Të vlersojë**:
- Rolin e kushteve natyrore dhe të faktorëve shoqërorë në zhvillimin e ndryshëm ekonomik të Kosovës dhe të vendeve përreth.
- Ndikimin e veprimtarive njerëzore në mjedisin jetësor.

➢ **Të zhvillojë qëndrime dhe vlera**:
- Për larminë e veçorive natyrore, humane dhe kulturore të Kosovës dhe të vendeve përreth, vlerësimin e resurseve natyrore e njerëzore.

Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik, i aftë për punë në grupe, çifte, përdorimin e literaturës, leksikoneve, enciklopedive, internetit, programeve arsimore televizive, aftësive për punë në bashkëpunim me komunitetet të tjera etj.

**Planifikimi i përmbajtjeve programore në bazë të përkatësisë nacionale për klasën e IX**

| **Kate-goria** | **Nënka-tegoria** | **Tërësitë mësimore** | **Shqiptarët** | | **Serbët dhe malazeztë** | | **Boshnjakët** | | **Turqit** | | **Kroatët** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nr.orëve | % | Nr.orëve | % | Nr.orëve | % | Nr.orëve | % | Nr.orëve | % |
| | | - Gad. Ballkanik | 1+0 | 2.7 | 1+0 | 2.7 | 1+0 | 2.7 | 1+0 | 2.7 | 1+0 | 2.7 |
| Regjioni | Kosova dhe vendet përreth | - Kosova | **15+8** | **62.2** | **15+8** | **62.2** | **15+8** | **62.2** | **15+8** | **62.2** | **15+8** | 62.2 |
| | | - Shqipëria | **5+2** | **18.9** | 2+1 | 8.1 | 2+1 | 8.1 | 2+1 | 8.1 | 2+1 | 8.1 |
| | | - Maqedonia | 1+0 | 2.7 | 1+0 | 2.7 | 1+0 | 2.7 | 1+0 | 2.7 | 1+0 | 2.7 |
| | | - Serbia & Mal i Zi | 1+1 | 5.4 | **4+2** | **16.2** | 1+1 | 5.4 | 1+1 | 5.4 | 1+1 | 5.4 |
| | | - Bosna-Herceg. dhe Kroacia | 1+0 | 2.7 | 1+0 | 2.7 | **4+1** | **13.5** | 1+0 | 2.7 | **4+1** | **13.5** |
| | | -Turqia | 1+1 | 5.4 | 1+1 | 5.4 | 1+1 | 5.4 | **4+2** | **16.2** | 1+1 | 5.4 |
| | | **Gjithsej** | 25+12 | 100 | 25+12 | 100 | 25+12 | 100 | 25+12 | 100 | 25+12 | 100 |

## Planifikimi i përmbajtjeve programore në bazë të përkatësisë nacionale në klasën IX

| Kategoria | Nënkategoria | Tërësitë mësimore | Numri i orëve | Nr.orëve gjithsej | % e orëve |
|---|---|---|---|---|---|
| Regjioni | Kosova dhe vendet përreth | **Gadishulli Ballkanik** | 1+0 | 1+0 | 2.7 |
| | | **Kosova**, pozita gjeografike, madhësia, kufijtë<br>Natyra e Kosovës<br>Popullsia dhe vendbanimet<br>Ekonomia<br>Regjionet e Kosovës | 1+1<br>4+2<br>4+2<br>4+2<br>2+1 | 15+8 | 62.2 |
| | | **Shqipëria për shqiptarë**<br>Pozita gjeografike, veçoritë fizike dhe humane<br>Regjioni Perëndimor<br>Regjioni Verior<br>Regjioni Qendror<br>Regjioni Jugor | 1+0<br>1+1<br>1+0<br>1+1<br>1+0 | 5+2 | 18.9 |
| | | **Shqipëria (për minoritete)**<br>Pozita dhe veçoritë natyrore<br>Popullsia, vendbanimet, ekonomia | 1+0<br>1+1 | 2+1 | 8.1 |
| | | **Maqedonia**<br>Pozita, veçoritë natyrore, popullative, ekonomike | 1+0 | 1+0 | 2.7 |
| | | **Serbia dhe Mali i Zi**<br>Pozita, veçoritë natyrore, popullative, ekonomike | 1+1 | 1+1 | 5.4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **Serbia dhe Mali i Zi (për serbë e malazez)**<br>Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore<br>Popullsia dhe vendbanimet<br>Zhvillimi ekonomik dhe struktura e saj<br>Regjionet e Unionit | 1+0<br>1+1<br>1+0<br>1+1 | 4+2 | 16.2 |
| | | **Bosna-Hercegovina dhe Kroacia**<br>Pozita, veçoritë natyrore,popullative dhe ekonomike | 1+0 | 1+0 | 2.7 |
| | | **Bosna e Hercegovina dhe Kroacia (për boshnjakë e kroatë)**<br>Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore<br>Popullsia dhe vendbanimet<br>Zhvillimi ekonomik dhe struktura e saj<br>Regjionet | 1+0<br>1+1<br>1+0<br>1+0 | 4+1 | 13.5 |
| | | **Turqia**<br>Pozita, veçoritë natyrore, popullative dhe ekonomike | 1+1 | 1+1 | 5.4 |
| | | **Turqia (për turq)**<br>Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore<br>Popullsia dhe vendbanimet<br>Zhvillimi ekonomik dhe struktura e ekonomisë<br>Regjionet | 1+0<br>1+1<br>1+1<br>1+0 | 4+2 | 16.2 |
| | | **Gjithsej** | **25+12** | **25 + 12** | **100.0** |

## Përmbajtjet programore të lëndës Kosova dhe vendet përreth

| Kate-goria | Nënka-tegoritë | Përmbajtja pro-gramore-temat | Rezultatet e pritura | Lidhja ndërlendore |
|---|---|---|---|---|
| **Regjioni** | **Kosova dhe vendet përreth** | **Gadishulli Ballkanik** | - Të shpjegojë veçoritë e pozitës gjeografike dhe veçoritë natyrore të Gadishullit Ballkanik<br>- Të evidencojë tiparet themelore të popullsisë dhe të veprimtarive ekonomike | Ndërlidhja mes njohurive gjeografike, gjeologjike, klimatike, hidrografike, biogjeografike etj. |
| | | **Kosova**, pozita gjeografike, madhësia dhe kufijtë | - Të analizojë rolin e pozitës në Gadishull dhe zhvillimin ekonomik të saj<br>- Të krahasojë madhësinë e Kosovës me shtetet e regjionit<br>- Të tregojë se përmes cilave lugina, gryka e qafa malore lidhet Kosova me vendet përreth dhe me cilat shtete ka kufij natyrorë dhe etnikë. | Ndërlidhja e njohurive historike, gjeografike, ekonomike e kulturore. |
| | | **Natyra e Kosovës**, ndërtimi gjeologjik, relievi, klima, hidrografia, llojet e tokave, bota bimore dhe shtazore. | - Të shpjegojë veçoritë kryesore të ndërtimit gjeologjik<br>- Të dallojë llojet kryesore të shkëmbinjve<br>- Të dallojë format kryesore të relievit dhe veçoritë e tyre<br>- Të argumentojë rolin e formave të relievit në aktivitetet njerëzore<br>- Të shpjegojë faktorët dhe elementet klimatike<br>- Të përshkruajë veçoritë kryesore të tipave klimatikë<br>- Të vlerësojë rolin e klimës në ekonomi e në shoqëri<br>- Të shpjegojë karakteristikat themelore hidrografike | Ndërlidhja e njohurive gjeologjike, fiziko - gjeografike, humano-gjeografike, biogjeografike e mjedisore. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | - Të dallojë pellgjet lumore dhe veçoritë e tyre në Kosovë<br>- Të dallojë tipat e liqeneve dhe veçoritë e tyre<br>- Te vlerësojë rolin e ujërave në zhvillimin ekonomik<br>- Të dallojë tipat kryesorë të tokave dhe veçoritë e tyre<br>- Të argumentojë shkaqet e degradimit, të erozionit, të ndotjes dhe të keqpërdorimit të tokave.<br>- Të shpjegojë veçoritë kryesore të botës së gjallë në Kosovë | |
| | | **Popullsia dhe vendbanimet**. Popullimi, numri, dendësia, lëvizjet natyrore, mekanike, strukturat e popullsisë, tipat e vendbanimeve, fshatrat, veçoritë e tyre, qytetet, numri dhe rritja e popullsisë në qytete. | - Të tregojë shkaqet e popullimit të hershëm të Kosovës<br>- Të argumentojë lashtësinë e popullsisë shqiptare dhe të popujve të tjerë në Kosovë<br>- Të arsyetojë shkaqet e ndryshimit të numrit të popullsisë shqiptare dhe të popujve të tjerë gjatë periudhave historike<br>- Të komentojë dallimet në dendësinë e popullsisë<br>- Të shpjegojë faktorët e shkallës së lartë të natalitetit dhe të shtimit natyror dhe mortalitetin e ulët, duke arsyetuar shkaqet kryesore të tyre<br>- Të përshkruajë veçoritë kryesore të popullsisë së Kosovës.<br>- Të shpjegojë shkaqet kryesore që Kosova ka më shumë popullsi të re, dallime mes gjinive, strukturë të pavolitshme ekonomike, analfabetizëm etj.<br>- Të tregojë grupet kryesore të popullsisë sipas përkatësisë kombëtare e fetare<br>- Të shpjegojë faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në migrimet e popullsisë dhe fazat kryesore të tyre<br>- Të analizojë lidhjet e diaspores me vendlindje më parë dhe tani<br>- Të dallojë tipat kryesorë të vendbanimeve në Kosovë | Ndërlidhja e njohurive historike, demografike, ekonomike, kulturore e politike. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | - Të shpjegojë kriteret e ndarjes së vendbanimeve dhe funksionet e tyre<br>- Të argumentojë lidhjet mes industrializimit, urbanizimit dhe deagrarizimit | |
| | | **Ekonomia, faktorët e zhvillimit ekonomik**. Bujqësia dhe degët e saj, xehetaria dhe industria, transporti, tregtia, zejtaria dhe turizmi. | - Të dallojë faktorët natyrorë dhe shoqërorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës.<br>- Të vlerësojë rolin e kushteve historike, politike dhe shoqërore në zhvillimin ekonomik të Kosovës.<br>- Të shpjegojë ç'vend ka zënë dhe zë ekonomia bujqësore në tërësinë e ekonomisë së Kosovës.<br>- Të komentojë ndikimin e kushteve historike, politike e shoqërore në zhvillimin e bujqësisë së Kosovës.<br>- Të tregojë degët kryesore të bujqësisë dhe nivelin e tyre të zhvillimit.<br>- Të argumentojë përshtatshmërinë e mjedisit gjeografik për zhvillimin e ekonomisë bujqësore.<br>- Të tregojë ç'pasuri nën dhe mbitokësore ka Kosova për zhvillimin e industrisë.<br>- Të shpjegojë se si kanë ndikuar kushtet politike dhe shoqërore në zhvillimin industrial të Kosovës.<br>- Të tregojë degët kryesore të industrisë së Kosovës, duke përshkruar veçoritë kryesore të tyre.<br>- Të përcaktojë në hartë qendrat dhe rajonet më të rëndësishme industriale të Kosovës.<br>- Të komentojë se prej kujt varet zhvillimi i ardhshëm industrial i Kosovës.<br>- Të dallojë faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e | Ndërlidhja mes zhvillimit ekonomik, historik e politik. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | transportit.<br>- Të përshkruajë anët pozitive dhe negative të transportit automobilistik, hekurudhor dhe ajror dhe zhvillimin e tyre.<br>- Të shpjegojë kushtet kryesore natyrore, kulturore dhe shoqërore që ndikojnë në zhvillimin e turizmit në Kosovë.<br>- Të komentojnë rolin e turizmit, të tregtisë, të transportit, të shërbimeve dhe të artizanateve në zhvillimin ekonomik të Kosovës. | |
| | | **Regjionet e Kosovës:** Regjioni Lindor dhe Perëndimor | - Të dallojë regjionet kryesore të Kosovës, duke përdorur veçoritë karakteristike natyrore, shoqërore dhe ekonomike të tyre.<br>- Të shpjegojë cilat janë regjionet më të rrezikuara nga ndotja e ajrit, e ujit dhe e tokave.<br>- Të komentojë rrezikun që po paraqitet nga ndotja e mjedisit gjeografik në shumë anë të Kosovës. | Të ndërlidhë njohuritë fiziko-gjeografike, humano-gjeografike, biologjike e mjedisore. |
| | | **Shqipëria,** pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore, shoqërore dhe ekonomike | - Të shpjegojë veçoritë gjeografike të Shqipërisë<br>- Të shpjegojë veçoritë kryesore natyrore të Shqipërisë<br>- Të evidencojë karakteristikat kryesore të popullsisë dhe të ekonomisë së Shqipërisë<br>- Të dallojë në hartë regjionet kryesore të Shqipërisë<br>- Të shpjegojë karakteristikat kryesore të pozitës, ndërtimit gjeologjik, relievit, klimës, hidrografisë, tokave, popullsisë, vendbanimeve dhe ekonomisë të regjionit Perëndimor, Verior, Qendror, Jugor të Shqipërisë. | |
| | | **Shqipëria për minoritetet.** Pozita, veçoritë | - Të shpjegojë veçoritë e pozitës gjeografike dhe ato natyrore të Shqipërisë.<br>- Të evidencojë karakteristikat kryesore të popullsisë, të | Ndërlidhja mes njohurive natyrore, huma- |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | natyrore, shoqë-rore, ekonomike dhe regjionet | vendbanimeve dhe të ekonomisë së Shqipërisë<br>- Të dallojë regjionet gjeografike dhe tiparet kryesore të tyre | ne, demografike, ekonomike e regjionalo-gjeografike. |
| | | **Maqedonia**, pozita gjeografike, veçoritë natyrore, popullative, ekonomike dhe regjionet. | - Të analizojë rolin e pozitës gjeografike të Maqedonisë<br>- Të dallojë veçoritë kryesore natyrore të këtij vendi<br>- Të evidencojë veçoritë e popullsisë dhe të ekonomisë<br>- Të dallojë regjionet kryesore, tiparet karakteristike të tyre | Ndërlidhja mes njohurive natyrore, humane e regjionale në shembullin e Maqedonisë. |
| | | **Serbia dhe Mali i Zi**, pozita gjeografike, veçoritë natyrore, popullative dhe ekonomike, ndarja regjionale. | - Të shpjegojë veçoritë e pozitës gjeografike dhe kushtet natyrore.<br>- Të dallojë veçoritë kryesore të popullsisë dhe të ekonomisë<br>- Të shpjegojë organizimin dhe ndarjen politike e regjionale të Serbisë dhe të Malit të Zi. | Të kuptuarit e ndërlidhjeve mes dukurive fiziko-gjeografike dhe humano-gjeogra-fike në hapësirat tipike të shteteve të veçanta. |
| | | **Serbia e Mali i Zi për serbët dhe malazeztë** Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, popullative dhe ekonomike, ndarja regjionale. | - Të analizojë rolin e pozitës gjeografike të Serbisë dhe të Malit të Zi.<br>- Të shpjegojë veçoritë kryesore natyrore të Serbisë dhe të Malit të Zi.<br>- Të dallojë tiparet themelore të popullsisë dhe të ekonomisë.<br>- Të shpjegojë ndikimin e kushteve historike, politike dhe shoqërore në zhvillimin e ekonomisë dhe të degëve kryesore. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | - Të dallojë degët dhe rajonet kryesore industriale. | |
| | | **Bosna, Hercego-vina dhe Kroacia (**për boshnjakë dhe kroatët). Pozita gjeografi-ke, veçoritë e na-tyrës, të popull-sisë, ekonomisë dhe regjioneve. | - Të shpjegojë veçoritë e pozitës dhe të kushteve natyrore<br>- Të evidencojë tiparet themelore të popullsisë së këtyre vendeve<br>- Të dallojë kushtet natyrore dhe faktorët shoqërorë në zhvillimin ekonomik të BH-së dhe të Kroacisë.<br>- Të tregojë degët kryesore ekonomike dhe veçoritë e tyre.<br>- Të dallojë llojet, rezervat dhe prodhimtarinë e xeheve kryesore në BH dhe në Kroaci. | Ndërlidhja e natyrës me shoqërinë dhe problemet ekonomike e politike në hapësirat e caktuara. |
| | | **Turqia për të tjerët**. Pozita, natyra, po-pullsia, ekonomia dhe regjionet kryesore. | - Të shpjegojë pozitën interesante, veçoritë e natyrës, të popullsisë dhe të ekonomisë.<br>- Të dallojë regjionet kryesore dhe veçoritë specifike të tyre. | |
| | | **Turqia për Turqit.** Pozita gjeografike, natyra, popullsia, ekonomia dhe regjionet tipike. | - Të shpjegojë veçoritë e pozitës dhe veçoritë natyrore të Turqisë.<br>- Të evidencojë tiparet themelore të popullsisë dhe të zhvillimit ekonomik të Turqisë.<br>- Të dallojë kushtet natyrore dhe faktorët shoqërorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik.<br>- Të tregojë degët kryesore të ekonomisë dhe nivelin e zhvillimit të tyre.<br>- Të dallojë regjionet kryesore gjeografike të Turqisë dhe t'i shënojë tiparet kryesore të tyre. | |

## METODOLOGJIA E TË MËSUARIT

Zbatimi i metodave, teknikave, strategjive dhe formave të ndryeshme të organizimit të procesit është një e drejtë profesionale e mësuesve. Rekomandohet që për aspektet e shumta të rrafshit metodologjik, si ato teorike dhe ato aplikative, të tregohet kujdes i veçantë. Metodologjia duhet të zgjidhet paraprakisht në përshtatje me përmbajtjen e temës që do të zhvillohet, por edhe në varësi të bazës didaktike dhe nivelit të formimit gjeografik të nxënësve.

Metodologjia është mirë të jetë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe të përdorimit më të shpejtë e me të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive dhe vlerave gjeografike, në radhë të parë të atyre që duhen për t'u zgjidhur problemet e jetës së përditshme.

Metodat didaktike është mirë të ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë gjithë orës së mësimit në përputhje me karakterin e dijeve, të objektivave lëndorë dhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësuesit dhe nxënësit.

Në grupin e metodave verbale rekomandohen të përdoren: metoda e shpjegimit, e bashkëbisedimit, e demonstrimit, e ilustrimit, e rrëfimit, e diskutimit të lirë etj.

Mësimdhënia me në qendër nxënësin është shumë e kërkuar për t'u zbatuar në klasë, me qëllim që të ndodhë të nxënit aktiv dhe afatgjatë. Diskutimet mund të bëhen me tërë klasën, në dyshe, në grupe etj., ndërsa të nxënit në bashkëpunim mund të bëhet përmes teknikave të ndryshme, si: brainsturming (stuhi mendimesh), pema e mendjes (klaster), teknika e hartimit dhe e drejtimit të pyetjeve, inserti, tabela e insertit, diskutimi që zgjidh problemin, mësimi zbulues, tabela (harta) e koncepteve, di-dua të mësoj, rrjeti i diskutimit, termat paraprakë, ditari dypjesësh, fjalën e fundit ruaje për mua, grupet e ekspertëve (xhigso me ndërthurje), diagrami i Venit, kubimi, pesëvargëshi, eseja, turi i galerisë, programi televiziv etj.

### Format e punës në mësimin e gjeografisë

Në procesin mësimor të realizimit të përmbajtjeve programore të gjeografisë së Kosovës dhe të vendeve përreth mund të zbatohen forma të ndryshme të punës:

- individuale,
- në çifte (dyshe),

- në grupe,
- në tërë klasën etj.

### Metodologjia e vlerësimit

Verifikimi dhe vlerësimi i shkallës së përvetësimit të diturive gjeografike nga nxënësit është proces tepër i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të këtij programi. Për këtë arsye rekomandohet që vlerësimet të përqendrohen më tepër në aspektet sasiore e cilësore të nivelit të arritjes nga nxënësit e objektivave të përgjithshëm e specifikë të paracaktuar. Prandaj, më të frytshme janë verifikimet, notimet dhe vlerësimet sistematike e të përditshme, mundësisht për të gjithë nxënësit.

### VLERËSIMI

Vlerësimi kërkon:

- objektiva të qartë mësimorë
- motivim të nxënësve
- njohjen e përvojës dhe të aftësive të nxënësve
- kërkesa të qarta të nxënësve dhe metoda e teknika mësimore efikase

Vlerësimi bazohet në:

- Ç'thonë, ç'shkruajnë dhe ç'bëjnë nxënësit

### Instrumentet e vlerësimit

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- Vrojtimi
- Pyetësori (vetëvlerësimi)
- Raporti me shkrim i një pune praktike apo i një hulumtimi
- Të shprehurit me gojë
- Të shprehurit me shkrim

- Fleta kontrolluese përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit
- Dosja apo portofoli (vetëvlerësimi)
- Testi i bazuar në kritere dhe në objektiva
- Testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje);
  - me përgjigje alternative të shumta
  - me përgjigje të hapura të shkurtra
  - me përgjigje të hapura të zgjedhura etj. dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

**Etapat e vlerësimit**

- Kontroll, p.sh., ç'din (ç'është arritur), dhe ç'farë nuk din nxënësi (ç'nuk është arritur),
- Matja, ajo që kontrollohet matet,
- Vlerësimi nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi sasior ose cilësor e bazuar në matje mendore.

**Kategoritë e vlerësimit**

- formues
- diagnostifikues
- përmbledhës (testimi)
- motivues

Të gjitha vlerësimet e mësipërme bëhen nga arsimtari, d.m.th. vlerësimi i brendshëm

**Shkalla e përfitimit**

Në fund të vitit shkollor çdo nxënës duhet të arrijë njërën nga shkallët e përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë)
- shumë mirë (arritje e lartë)

- mirë (arritje mesatare)
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar)
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme)

**Përdorimi i teksteve dhe i burimeve të tjera mësimore**

- teksti shkollor përkatës
- doracaku
- atlasi
- globi
- hartat e ndryshme
- broshurat
- fotografitë, posterët, skemat, diagramet, tabelat, grafikonet etj.
- fotoslajdet, filmat, videokasetat
- programet kompjuterike, interneti, CD etj.

# EDUKATË QYTETARE

**(1 orë në javë, 35 orë në vit)**

## HYRJE

Programi i Edukatës qytetare për klasën IX është hartuar, duke pasur parasysh nevojat e nxënësve për fitimin e njohurive dhe krijimin e shkathtësive që lidhen me moshën në përfundim të ciklit të dytë të shkollimit. Nxënësit e kësaj moshe janë të rinj adoleshentë dhe gjenden në prag të orientimit të tyre profesional. Të rinjtë e kësaj moshe, zakonisht, janë të interesuar të angazhohen në klube, shoqata ose organizime të ndryshme shoqërore, dhe programi i kësaj lënde për klasën e nëntë u ofron atyre njohuri për këto forma të organizimeve dhe për funksionet dhe efektet e këtyre organizimeve në komunitet dhe në shoqëri.

Përgjatë shkollimit të deritashëm ata kanë arritur një përvojë dhe kanë krijuar përshtypje të ndryshme për lëndët mësimore. Përvoja e arritur atyre u shërben bazë për përcaktimet e ardhshme vlerore dhe për përgatitjet për ciklet më të larta të shkollimit. Për të hyrë në ciklin e ri të shkollimit në mënyrë më të përgaditur, programi i edukatës qytetare për klasën IX nxënësve u ofron një mori temash për çështjet e ndryshme të kulturës, të komunikimeve dhe të mjedisit.

Nga tetë kategoritë tematike që i ka gjithsej edukata qytetare, vetëm dy nga ato mësohen në klasën e nëntë. Këto dy kategori shumë të gjera tematike nxënësve u ofrojnë, nga njëra anë, mundësi për fitimin e dijeve dhe krijimin e shprehive, e, nga ana tjetër, përvojë në aktivitete dhe në organizime konkrete shoqërore.

Natyrisht, mësimi për këto çështje nuk do të jetë mësim teorik dhe i ngarkuar me abstraksione të panevojshme, por do të jetë një mësim praktik, i bazuar në realitetet dhe në shembujt konkretë nga jeta e grupeve dhe e institucioneve shoqërore, e kulturës dhe e komunikimeve, e vlerave dhe e besimeve si dhe e mjedisit.

Këto dy kategori tematike, për nxënësit e klasës IX ofrojnë shembuj të shumtë të zbatimit të njohurive dhe të shkathtësive për qytetarinë.

## QËLLIMET E LËNDËS

- Të zhvillojë te fëmijët aftësitë për t'u përshtatur, integruar dhe për të vepruar në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme nëpër grupet elementare sociale, si: familja, shkolla, klubet, shoqatat dhe institucionet e ndryshme.
- Të zhvillojë te fëmijët ndjenjën e përgjegjësisë dhe të përkushtimit për pjesëmarrje aktive në jetën qytetare, duke respektuar parimet demokratike të punës, qoftë në organizatat ose institucionet joqeveritare, qoftë në ato qeveritare.
- T'u mundësojë fëmijëve një parapërgatitje për t'u bërë pjesëtarë aktivë të shoqërisë civile dhe para organeve të pushtetit të dinë t'i artikulojnë kërkesat për zgjidhje të problemeve individuale dhe grupore ose kolektive.
- T'u ndihmojë fëmijëve në formimin e shprehive për komunikim të drejtë, për sjellje tolerante dhe mirëkuptim në komunikimin ndërkulturor, si dhe t'i nxisë në formimin e aftësive për përdorimin e teknologjive bashkëkohore të komunikimit.
- T'u ndihmojë fëmijëve në krijimin e aftësive për respektimin e dinjitetit njerëzor, diversitetit njerëzor e kulturor si dhe diversitetit ekologjik, si dhe të krijojë shprehitë e ruajtjes së mjedisit.

## OBJEKTIVAT E LËNDËS

Në bazë të qëllimeve të lëndës së edukatës qytetare, nxënësi i klasës IX duhet të arrijë këta objektiva:

**Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:**

- të jetë i hapur e tolerant ndaj personave me përkatësi tjetër gjinore, etnike, fetare, kulturore, racore ose edhe ndaj personave të trafikuar;
- të kundërshtojë format e ndryshme të paragjykimeve dhe të diskriminimit mbi bazën e moshës, gjinisë, përkatësisë fetare,

kombëtare, racore, duke përfshirë edhe viktimat e trafikimit njerëzor;

- të jetë kureshtar dhe i vullnetshëm në pjesëmarrjen në aktivitetet e klubeve dhe të shoqatave që merren me zhvillimin e kulturës dhe të vetëdijes qytetare që veprojnë në komunitetin ku jeton dhe në shoqëri;
- të jetë kureshtar dhe i vullnetshëm në pjesëmarrjen në aktivitetet e institucioneve dhe të organizatave që zhvillojnë projekte për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, prostitucionit, narkomanisë.

**Të njohë**

- konceptet, si: klub, shoqatë, institucion, qeverisje demokratike, shoqëri civile dhe koncepte të tjera që lidhen me fushën e aktiviteteve të klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve joqeveritare dhe qeveritare;
- gjendjen dhe format e ndryshme të organizimeve të shoqërisë civile në Kosovë;
- llojet e ndryshme të institucioneve shoqërore;
- mënyrat e ndikimit dhe të pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjidhjen e problemeve individuale ose të përbashkëta për komunitetin dhe shoqërinë;
- dukurinë dhe karakteristikat e trafikimit të qenieve njerëzore;
- trendet e zhvillimit të teknologjive bashkëkohore të komunikimit.

**Të kuptojë**

- rëndësinë e mësimit të gjuhëve botërore për të komunikuar dhe për të shkëmbyer informatat me bashkëmoshatarët anekënd botës;
- detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesve dhe të anëtarëve ose të pjesëtarëve të klubeve, të shoqatave ose të institucioneve tjera që veprojnë në komunitet dhe në shoqëri;
- rolin dhe mënyrat për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenive njerëzore në komunitetin e tij;
- rolin e shkollës dhe të nxënësit në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore;

- rolin e teknologjisë informative në komunikimet transkulturore dhe transnacionale;
- rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të aktiviteteve shoqërore, duke u mbështetur në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

**Të vlerësojë**

- aktivitetet e klubeve dhe të shoqatave që veprojnë në komunitet dhe në shoqëri;
- rëndësinë e luftimit të paragjykimeve dhe të stereotipeve që e pengojnë komunikimin ndërkulturor si dhe rëndësinë e respektimit të dinjitetit njerëzor, diversitetit kulturor dhe ekologjik;
- ndikimin e klubeve dhe të shoqatave në jetën e përditshme të komunitetit dhe të shoqërisë.

**Të zbatojë**

- detyrat dhe përgjegjësitë personale, që kanë të bëjnë me jetën në familje, në klub, në shoqatë, në shkollë, duke përfshirë planin antitrafik në shkollë, në komunitet dhe në shoqëri;
- të respektojë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin njerëzor të viktimave të trafikimit ose të formave të tjera të dhunës njerëzore;
- rregullat, procedurat dhe ligjet që kanë të bëjnë me aktivitetin e klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve;
- parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në aktivitetet e klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve.

**Të analizojë**

- shkaqet që ndikojnë në cenueshmërinë e një individi apo të komunitetit, si dhe kushtet socioekonomike që e bëjnë të mundshëm trafikimin e qenieve njerëzore;
- efektet e veprimtarive të klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve në Kosovë;
- faktorët që ndihmojnë si dhe ata që pengojnë komunikimin ndërkulturor.

**Të sintetizojë**

- rolin e shoqërisë civile në zhvillimin e demokracisë dhe të vlerave qytetare në Kosovë;
- rolin e institucioneve shoqërore në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, të prostitucionit, të narkomanisë dhe të dukurive të tjera negative;
- mundësinë, nevojën dhe rëndësinë e komunikimit ndërkulturor në shoqërinë bashkëkohore.

## STRUKTURA E LËNDËS

| KATEGORITË | NËNKATEGORITË | NUMRI I ORËVE |
|---|---|---|
| **GRUPET DHE INSTITUCIONET** | **Familja** | 11 |
| | **Shkolla** | |
| | **Klubet, shoqatat dhe institucionet** | |
| **KULTURA** | **Gjuha dhe komunikimi** | 21 |
| | **Vlerat kulturore dhe besimet** | |
| | **Komunikimi ndërkulturor** | |
| | **Kujdesi për ambientin** | |

## PËRMBAJTJA PROGRAMORE

### Familja

Nxënësit të mësojnë për:

Tipat e ndryshëm të familjeve dhe për rolin e tyre në socializimin e individit; strukturën e roleve dhe raportet gjinore e gjenerative në familje; ndryshimet në familjen bashkëkohore; komunikimin dhe bashkëpunimin prindër-fëmijë si nevojë e domosdoshme për edukimin dhe zhvillimin e shëndoshë të fëmijëve; trafikimin i qenieve njerëzore / dhunën gjinore dhe dhunën në familje

**Rezultatet e pritura**

Nxënësi:

- dallon familjen bashkëkohore nga familja tradicionale
- analizon rolet gjinore dhe gjenerative në familje
- analizon rolet familjare në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore
- analizon faktorët socialë, ekonomikë dhe teknologjikë, që ndikojnë në ndryshimet e roleve dhe të funksioneve në familje
- analizon faktorët socioekonomik dhe ndikimin e tyre në cenueshmërinë e individit dhe të grupit social
- kupton nevojën për një bashkëpunim dhe komunikim më të hapur ndërmjet prindërve dhe fëmijëve
- vlerëson rëndësinë e kujdesit, të mirëkuptimit dhe të harmonisë familjare në formimin e personalitetit të shëndoshë dhe socializimin e fëmijëve.

**Shkolla**

Nxënësit të mësojnë për:

Shkollën si faktor i pazëvendësueshëm arsimor dhe socializues; strukturën dhe sistemin e shkollimit në Kosovë dhe në disa vende të tjera; rolin e shkollës në transmetimin e vlerave te nxënësit; llojet e ndryshme të shkollave dhe të profesioneve; shkollimin permanent.

**Rezultatet e pritura**

Nxënësi:

- dallon rolin e shkollës në edukimin dhe në socializimin e fëmijëve;
- kupton rolin e shkollës në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore;
- analizon sistemin e shkollimit në Kosovë dhe e krahason atë me vende të tjera;
- vlerëson rëndësinë e shkollimit dhe të aftësimit profesional;
- vlerëson nevojën për arsimim permanent.

### Klubet, shoqatat dhe institucionet

Nxënësit të mësojnë:

Llojet e klubeve/shoqatave dhe llojet e aktiviteteve që zhvillohen në to; cili është roli i klubeve dhe i shoqatave në shoqërinë bashkëkohore; llojet e institucioneve sipas aktivitetit ose veprimtarisë; Ç'është shoqëria civile dhe cili është roli i saj në shoqërinë demokratike; roli dhe zhvillimi i shoqërisë civile në Kosovë.

**Rezultatet e pritura**

Nxënësi:

- dallon llojet e ndryshme të klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve që gjenden në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- shpjegon rolin e shoqërisë civile në demokraci;
- vlerëson rolin e shoqërisë civile në Kosovë;
- vlerëson rolin e të rinjve në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë;
- vlerëson rolin e të rinjve në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për reintegrimin e viktimave të trafikimit.

### Gjuha dhe komunikimi

Nxënësit të mësojnë për:

Gjuhën si mjet komunikimi; mënyrat e të folurit ose komunikimi nëpërmjet zhargonit, dialektit, gjuhës letrare, gjuhës së huaj dhe gjuhës botërore; format e komunikimit joverbal (gjuha e trupit, e shenjave ose i simboleve); format e komunikimi publik dhe teknologjitë bashkëkohore të komunikimit.

**Rezultatet e pritura**

Nxënësi:

- kupton rëndësinë e kulturës gjuhësore dhe të kulturës së komunikimit
- shpjegon format dhe nivelet e ndryshme të komunikimit gjuhësor

- analizon format joverbale të shprehjes dhe rëndësinë e tyre në komunikim
- vlerëson rolin e teknologjive bashkëkohore (mediat elektronike, telefonia mobile, interneti, komunikimi satelitor) në komunikimin global.

### Vlerat kulturore dhe besimet

Nxënësit të mësojnë:

Ç'është kultura dhe cilat janë elementet përbërëse të kulturës; sistemet vlerore si elementet kryesore të sistemeve kulturore; vlerat demokratike të qytetarëve (toleranca, barazia, drejtësia, paqja, solidariteti etj.); ndryshimet kulturore në Kosovë dhe në botë; identiteti kulturor në epokën e globalizmit; besimet dhe llojet e tyre (fetë kryesore, sektet, kultet, mitet etj.).

**Rezultatet e pritura**

Nxënësi:

- dallon komponentet kryesore të kulturës.
- identifikon sistemet e ndryshme vlerore dhe bazat mbi të cilat ngriten sistemet vlerore dhe subkulturore
- shpjegon rëndësinë e respektimit të vlerave njerëzore, qytetare e demokratike, duke përfshirë dinjitetin njerëzor të viktimave të dhunës ose të trafikimit
- analizon zhvillimet bashkëkohore të kulturës në Kosovë
- dallon qytetërimet dhe veçoritë e feve kryesore botërore,
- kupton ç'janë sektet, kultet fetare dhe organizatat e tjera religjioze.

### Komunikimi ndërkulturor

Nxënësit të mësojnë:

Ç'është komunikimi ndërkulturor - nevojat dhe mënyrat e komunikimit ndërkulturor; multikulturalizmin, integrimet kulturore, ndikimet kulturore; diversiteti kulturor në Kosovë.

**Rezultatet e pritura**

Nxënësi:

- identifikon nevojat dhe mënyrat e komunikimit ndërkulturor
- shpjegon ç'është multikulturalizmi ose diversiteti kulturor
- vlerëson komunikimin ndërkulturor në Kosovë
- analizon ndikimet dhe zhvillimet aktuale kulturore në Kosovë

**Kujdesi për ambientin**

Nxënësit të mësojnë për:
Kulturën dhe vetdijen ekologjike; krizën ekologjike dhe format e manifestimit të saj - prishjen e baraspeshës ekologjike dhe pasojat; masat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe nevojat e ruajtjes së ekosistemit; gjendjen e mjedisit në Kosovë.

**Rezultatet e pritura**

Nxënësi:

- shpjegon elementet e vetëdijes dhe të kulturës ekologjike
- shpjegon shkaqet dhe pasojat e krizës ekologjike
- kupton urgjencën e masave ligjore për mbrojtjen e mjedisit
- vlerëson gjendjen e mjedisit në Kosovë.

**QASJA NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE**

Programi i Edukatës qytetare në klasën e nëntë ndërlidhet me lëndët: gjuhë amëtare, gjuhë e huaj, histori, gjeografi, edukatë fizike, art figurativ dhe muzikë.

Me **gjuhën amëtare** edukatën qytetare e lidhin temat që pasurojnë përvojat e komunikimit gjuhësor dhe ndërkulturor. Këto tema kanë të bëjnë me: klubet, shoqatat, komunikimin ndërkulturor, vlerat kulturore etj. Këto tema programin e edukatës qytetare e lidhin edhe me atë të **gjuhës së huaj**.

Lidhjen me **historinë** e mundësojnë përmbajtjet programore që kanë të bëjnë me zhvillimin e institucioneve, kulturës dhe identitetit kulturor,

fesë dhe qytetërimit. Përmbajtjet mësimore të këtyre temave do të lidhen edhe me aspektet historike të zhvillimit të tyre.

Edukata qytetare ka lidhje të ngushtë edhe me **gjeografinë,** sepse trajtohen probleme që kanë të bëjnë me popuj, me vende dhe rajone të ndryshme. Temat që edukatën qytetare e bëjnë të ketë lidhje me gjeografinë janë temat mbi multikulturalizmin, kujdesin për mjedisin, besimet etj.

Me **artin figurativ** dhe me **artin muzikor** ndërlidhet nëpërmjet temave për klubet, shoqatat, kulturën.

Edukata qytetare e klasës IX lidhet me **TIK** nëpërmjet përmbajtjeve që dalin nga temat: komunikimi ndërkulturor, interneti, mediat dhe komunikimi, mjedisi dhe mbrojtja e tij etj. Lidhjen me TIK-un e mundëson edhe nevoja e përdorimit të mjeteve teknike (kompjuterëve, kasetofonave, kamerave, diktafonëve, fotoaparateve etj.) në mësimin e edukatës qytetare.

## METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES DHE E MËSIMNXËNIES

Meqenëse edukata qytetare është lëndë multidisiplinare, realizimi i planit dhe programit të saj duhet të bëhet në mënyrë fleksibile dhe transparente. Kjo do të thotë se metoda intearktive e kombinuar me teknika të llojllojshme ia shton kreativitetin dhe aktivitetin praktik të realizimit të programit. Mjeshtëria metodologjike e mësimdhënies së kësaj lënde qëndron pikërisht në përzgjedhjen dhe në përdorimin e një varg metodash dhe teknikash, varësisht nga përmbajtjet dhe detyrat që duhet t'i realizojnë nxënësit përmes shpjegimeve dhe diskutimeve në klasë, leximit të literaturës, punës në grupe, punës individuale, aktiviteteve praktike, shfrytëzimit të internetit, organizimit skenik, shfrytëzimit të multimediave, vizitave në terren, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave si dhe paraqitja dhe prezantimi i tyre.

Metodologjia e mësimdhënies dhe e mësimnxënies së të dyja palëve, d.m.th. e nxënësve dhe e mësimdhënësve, është proces i gjatë. Dinamika e këtij procesi përfshin tri etapa:

1. Planifikimin dhe përgatitjen;
2. Drejtimin dhe zhvillimin e mësimit, disiplinën dhe klimën brenda orës mësimore, vlerësimin, përcjelljen e përparimit të nxënësit etj.;
3. Vetëvlerësimin dhe reflektimin pas mësimit.

I tërë ky proces i gjatë i mësimdhënies dhe i mësimnxënies dëshmon ndërlidhjen e pozicioneve arsimtar-nxënës.

Më qartë, realizimi i planit dhe i programit të edukatës qytetare renditet nëpër tri faza:

1. Aktiviteti para mësimit;
2. Aktiviteti gjatë mësimit;
3. Aktiviteti pas mësimit

Këto faza, siç po shihet, konsistojnë në dinamikën e realizimit të të tri etapave të cekura më lart. Organizimi, mbikqyrja dhe shfrytëzimi i kohës, motivimi, përcaktimi i objektivave, vlerësimi, mbledhja e informacioneve etj., gjejnë vend në etapën e parë, përkatësisht në aktivitetin para mësimit, ndërsa struktura e orës mësimore E.R.R. si dhe llojllojshmëria e përdorimit të teknikave gjatë orës mësimore i takojnë etapës së dytë, përkatësisht aktivitetit gjatë mësimit.

Në etapën e tretë, përkatësisht në aktivitetin pas mësimit, dalin në pah si interesat e nxënësve ashtu dhe ato të mësimdhënësve. Këtu hyjnë: zgjerimi përtej temave – punë që realizohet kryesisht me veprimtari të zgjëruara, dhe gjë që dëshmon fleksibilitetin, transparencën dhe kreativitetin e kësaj lënde mësimore.

## VLERËSIMI

Përparimi i nxënësve në edukatën qytetare nuk mund të maten vetëm në momentin e pyetjes, por në tërë procesin e angazhimit dhe të pjesëmarrjes aktive në klasë, në shkollë, në komunitet. Vlerësimi bëhet me qëllim të sigurimit të informacioneve rreth përparimit të nxënësve, për t’i motivuar ata për t’i realizuar objektivat e planifikuar dhe për të vlerësuar gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen. Vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë sistematike, të përhershme dhe të llojllojshme.

Realizimi i vlerësimit, pra, bëhet në forma dhe lloje të ndryshme: me gojë, me shkrim, praktikë, tema përmbledhëse, dosje, teste, detyra. Këto lloje vlerësimesh bëhen me qëllim që nxënësit të krijojnë shprehi pune, aftësi shkrimi, leximi, aftësi studiuese, organizuese, aftësi personale dhe shoqërore, si motivimi për të punuar në grup. Ky lloj diversiteti vlerësues ndihmon në kompleksin e formimit të personalitetit të nxënësit.

Vlerësimi është proces i shumanshëm dhe i ndërsjelltë. Te nxënësit duhet të kultivohen vazhdimisht shprehitë e punës, të vlerësimit dhe të

mendimit kritik, shprehi këto që si rezultat sjellin korrigjime, përparime eventuale për vetvehten dhe shoqërinë dhe rrethin në të cilin jeton.

Me rastin e vlerësimit të nxënësve në lëndën e edukatës qytetare, nuk duhet mbështetur vetëm në informatat njohëse, por edhe në shkathtësitë e treguara në aktivitetet e ndryshme praktike, si: sjelljet me rrethin, vrojtimet në komunitet, mbledhjen e të dhënave dhe të fakteve të rëndësishme për shpjegimin e temave të parapara me plan dhe program të kësaj lënde.

Vlerësimi nuk duhet të jetë proces i njëanshëm (vetëm arsimtar – nxënës), por ai duhet të jetë proces i shumanshëm. Te nxënësit duhet të kultivohen shprehitë e vlerësimit kritik për përmbajtjet dhe për metodologjinë e mësimdhënies e të vlerësimit.

Vlerësimi i arsimtarit për nxënësit duhet të bazohet në:

- Observimet e arsimtarit
- Detyrat dhe testet
- Projektet

**Observimet e arsimtarit** do të duhej të fokusohen në shkathtësitë e nxënësit për të punuar në grupe dhe për të punuar në mënyrë të pavarur, në raportet joformale të fëmijëve ndërmjet vete, por edhe të fëmijëve me të rriturit, në kualitetin e prezantimit të punës, në shprehjen e interesimeve për aktivitete të veçanta, në pjekurinë fizike, emocionale dhe mendore të nxënësit.

**Detyrat** do të ishin krijim i situatave, kur nxënësit do të duhej të merrnin ndonjë vendim të caktuar, ose do të duhej të mbronin dhe të argumentonin mendimet ose qëndrimet e caktuara etj.

**Testet** janë instrumente me të cilat në intervale të caktuara matet dija, përkatësisht progresi në njohuritë e nxënësve, e fituar gjatë mësimit në klasë dhe jashtë klasës.

**Projektet** janë punë grupore, por edhe individuale e nxënësve që kanë të bëjnë me mbledhjen e të dhënave të caktuara, përpunimin ose publikimin e tyre.

Për të mirën e shkollës, të komunitetit, e sidomos të vetë nxënësve, do të duhej që shkolla të krijojë kushte që nxënësit jo vetëm të vlerësohen, por edhe vetë të vlerësojnë.

**LITERATURA**


1. David C. Saffell, *CIVICS Responsabilities and Citizenship*, Grade 9, Westerville, Ohio, 2000
2. James E. Davis & Phyllis Maxey Fernlund, *CIVICS Participating in Government*, New Jersey 2001
3. Center for Civic Education, *We the People…*, Level II, 1993
4. Richard Jenkins, *Social Identity*, London &New York, 1996
5. Richard T. Schaefer & Robert P. Lamm, *Sociology*, The McGraw-Hill Companies, Inc. 1998
6. Thomas J. Sullivan, *Sociology,* Northern Michigan University, 1995
7. Gordon Marshall, *Dictionary of Sociology*, Oxford University Press 1998
8. Zejnullah Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut I, II*, Universiteti i Prishtinës, 2001
9. Kurtesh Salihu, *E drejta kushtetuese I*, Universiteti i Prishtinës, 2001
10. Bajram Shatri, *Edukata qytetare 10*, Libri shkollor 2003
11. Dr. Erlehta Mato, Mr. Abdyl Ramaj, Dr. Nikoleta Mita, Dr. Kozma Grillo, *Edukatë qytetare*, Klasa VI, Libri shkollor, Prishtinë, 2000
12. Muhamet Mazreku, *Edukata qytetare*, klasa IX, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003
13. *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe A-M*, Rilindja, Prishtinë, 1981
14. Iain Mc Lean, *Fjalor politik*, Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2001
15. Shemsi Krasniqi, *Edukata qytetare VI*, “Dukagjini”, Pejë, 2004
16. Sheribane Bahtiri, Shemsi Krasniqi, Habib Aliu, *Edukata qytetare VIII*, “Dukagjini”, Pejë, 2005
17. Osman Buleshkaj – Robert C. Mizzi, *Mesazhe nga klasa*, KEDP. Prishtinë, 2003

18. Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KCSF), *Lista e OJQ-ve të Kosovës*, Prishtinë, 2001
19. Xhemali Beluli, *Kultura qytetare*, klasa VII, Shkup, 2002
20. www.dadalos,org
21. www.unicef.org

# HISTORI

**(2 orë në javë, 70 orë në vit)**

## HYRJE

Lënda e historisë për klasën e 9-të përfshin periudhën brenda viteve 1918-1999. Përmes kësaj lënde nxënësit e klasës së nëntë do të njihen me proceset (politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore), si dhe me ngjarjet e personalitetet të cilat përkufizuan, përshpejtuan dhe thelluan këto procese. Pasi që kjo lëndë merret me dimensionin historik të proceseve në vazhdim, nxënësit përmes saj do të aftësohen për të kuptuar më mirë aktualitetin, pjesë e së cilit janë (roli pragmatik i historisë).

Përmes lëndës së historisë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efikase arrihet një zhvillim i gjithanshëm: botëkuptimor, kulturor dhe human i nxënësve (roli intelektual i historisë).

Përmes lëndës së historisë synohet që te nxënësit të zhvillohet të menduarit kritik, analitik, vlerësues, krahasues si dhe aftësimi për hulumtime dhe shqyrtim kritik të burimeve historike, natyrisht krejt kjo në pajtueshmëri me mundësitë dhe aftësitë psiko-fizike dhe afinitetet e tyre.

Duke u nisur nga parimi se nxënësi, në radhë të parë, duhet të njohë vetveten dhe pas kësaj të tjerët, është bërë përpjekje që të arrihet një përpjesëtim përkatës midis historisë kombëtare, rajonale, evropiane dhe botërore.

## QËLLIMET

### Ky program mësimor ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të njohur dhe për të kuptuar ligjshmëritë themelore të proceseve shoqërore, organizimin, funk-

sionimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore që nga fundi i Luftës së Parë Botërore e deri në vitin 1999.

- Zhvillimin e aftësive për të njohur dhe për të kuptuar mënyrat e jetesës, personalitetet historike, vendet dhe institucionet shoqërore e shtetërore, besimet, të arriturat ekonomike, shkencore, kulturore etj.
- Zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive të nevojshme për njohjen, kuptimin, përpunimin dhe zbatimin e të dhënave të ndryshme historike në kohë dhe në rrethana të caktuara.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

***Të njohin***

- Domethënien e termave, nocioneve dhe shprehjeve karakteristike për historinë Bashkëkohore.

***Të kuptojnë***

- Veçoritë kryesore të zhvillimeve historike të kësaj periudhe.
- Konceptet dhe parimet e zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, arsimore, shkencore, religjioze etj.

***Të zbatojnë***

- Informacionet historike për zgjidhjen e situatave të ndryshme që paraqiten në shoqëri.
- Format e mundshme për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme në shoqëri.

***Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera***

- Të vlerësojnë dhe të çmojnë të arriturat e shoqërisë njerëzore gjatë këtyre periudhave.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri.
- Për ruajtjen dhe kujdesin e trashëgimisë kulturore, monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj.

| Kategoria | Nënkategoria | Përmbajtjet programore | Rezultatet e pritura | Ndërlidhjet programore |
|---|---|---|---|---|
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **2. Bota midis dy luftërave botërore** | ***Nxënësit mësojnë për:***<br><br>**Botën gjatë viteve 1918-1939**<br>- Gjendjen e përgjithshme në fund të luftës; Konferencën e Paqes në Paris-Versaj; Formimin e Lidhjes së Kombeve dhe rolin e saj 1920-1939;<br>- Zhvillimet politike dhe ekonomike në Demokracitë Perëndimore (Angli, Francë, SHBA); Krizën e madhe ekonomike; Luftën qytetare në Spanjë; Zhbërjen e Sistemit të Versajit.<br>- Paraqitjen dhe ngritjen e totalita-rizmave: komunizmit në Rusi-BRSS; fashizmit në Itali; nacionalsocializmit-nazizmit në Gjermani.<br>- Zhvillimet kryesore në Azi, Afri- kë dhe Amerikën Latine<br><br>**(7 orë)** | ***Nxënësit:***<br><br>- Veçojnë perandoritë-shtetet e shpërbëra dhe shtetet e reja në Evropë;<br>- Krahasojnë funksionimin shoqëror e shte- tëror të vendeve demokratike perëndimore (Britani e Madhe, Francë, SHBA) dhe to- talitare ( Gjermani, Itali, BRSS)<br>- Kuptojnë thelbin e Luftës Qytetare në Spanjë dhe atë të Krizës së madhe ekono- mike. | ***Me:***<br><br>Të drejtën ndërkombëtare, gjeografinë, ekonominë, edukatën qytetare. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **5. Të arriturat në kulturë, në shkencë e në teknikë gjatë shekullit XX** | **Arsimi, shkenca, kultura, teknika, shoqëria 1818-1939.**<br>- Zhvillimet e reja në shoqëri, në arsim, në shkencë, në teknikë dhe në kulturë.<br><br>**(1 orë)** | - Veçojnë të arriturat kryesore në arsim, shkencë, kulturë, teknikë dhe ndikimin e tyre në cilësinë e jetës së njerëzve si dhe të arriturat në barazinë gjinore. | Fizikën, artin, letërsinë, Sociologjinë, TIK, edukatën qytetare etj. |
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **2. Bota midis dy luftërave botërore** | **Evropa Juglindore në kontekstin e ri politik (1918-1939)**<br>- Për rrjedhat kryesore politike, eko-nomike e shoqërore në Jugosllavi, Rumani, Bullgari dhe Turqi, Greqi dhe marrëdhëniet midis këtyre shteteve.<br><br>**(3 orë)** | - Kuptojnë cili ishte roli i Ballkanit në Rendin e Ri Botëror –Sistemi i Versajit. | Gjeografinë, ekonominë, marrëdhëniet ndërkombëtare. |
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **2. Bota midis dy luftërave botërore** | **Shqiptarët gjatë viteve 1918-1939 (1941)**<br>*1. Shqipëria gjatë viteve 1918-1939*<br>- Aktivitetin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare brenda viteve 1918-1920 për rimëkëmbjen e Shqipërisë; Çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris; Konsolidimin e pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë | - Janë në gjendje të bëjnë analizë të përgjithshme për gjendjen e brendshme të Shqipërisë dhe të pozitës së saj ndërkombëtare<br>mbëtare 1918-1939.<br>- Të gjykojnë drejt rolin e shtresave shoqërore dhe të personaliteteve të shquara | Marrëdhëniet ndërkombëtare, sociologjinë, ekonominë, drejtësinë. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 1920-1922; Hapat e parë në jetën plurale politike dhe fundin e saj më 1924; Republikën e Shqipërisë 1925-1928; Përpjekjet e Shqipërisë për emancipim ekonomik e politik brenda viteve 1928-1935; Zhvillimet ekonomike 1925-1939; Lëvizjet me karakter shoqëror e politik 1925-1939; Reformat modernizuese-"oksidentalizuese"; Pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë 1936-1939; Emigracioni politik shqiptarë 1925-1939.<br>2. *Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi 1918-1941.*<br>- Politika e Mbretërisë SKS-Jugo-sllavisë ndaj shqiptarëve; Koloni-zimi i viseve shqiptare; Shpërngu- lja e shqiptarëve; Komiteti MKK-Komiteti i Kosovës; Rezistenca e armatosur 1918-1927; Përpjekjet në rrafshin politik të shqiptarëve për të drejtat qytetare e kombëtare; Zvillimet ekonomike 1918-1941.<br><br>**(9 orë)** | politike e kulturore në funksionalizimin dhe në modernizimin e shtetit shqiptar.<br>- Kuptojnë arsyet e emigracionit politik shqiptar 1925-1939 dhe veprimtarinë e tij.<br>- Analizojnë politikën e Beogradit karshi shqiptarëve si dhe angazhimet e këtyre të fundit për të drejtat qytetare e kombëtare.<br>- Analizojnë zhvillimet ekonomike 1918-1941. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **5. Të arriturat në kulturë, në shkencë e në teknikë gjatë shekullit XX** | **Arsimi, kultura dhe shoqëria te shqiptarët gjatë viteve 1918-1939-41; Zhvillim dhe stagnim**<br>- Zhvillimet arsimore, kulturore dhe shoqërore në Shqipëri, të shqiptarëve në Kosovë dhe në vise të tjera në Jugosllavi dhe në diasporë.<br><br>**(2 orë)** | - Janë në gjendje të shpjegojnë faktorët që ndikuan në zhvillimet arsimor e kulturor në Shqipëri dhe të stagnimit në këto fusha të shqiptarëve në Kosovë dhe në viset të tjera shqiptare në Jugosllavi. | Artin, letërsinë, sociologjinë etj. |
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **3. Bota gjatë Luftës së Dytë Botërore** | **Bota në Luftën e Dytë Botërore**<br>*1. Faza e parë e LDB 1939-1942*<br>- Shkaqet e luftës dhe fillimin e saj; Pushtimet e forcave të Boshtit-Paktit Trepalësh- shtrirja e luftës në tërë botën; Betejat kryesore të Luftës të forcave të Koalicionit Antifashist, rezultatet e tyre dhe rezistencën antifashiste brenda viteve 1939-1942; Aktivitetet diplomatike brenda Koalicionit Antifashist dhe vendimet përcaktuese për fatin e luftës.<br><br>*2. Faza e dytë e LDB 1943-1945: Zhvillimet ushtarake dhe politike*<br>- Rrjedhat e luftës në frontet kryesore në Evropë, në Afrikë dhe në gjysmën | - Bëjnë analizën e shkaqeve të luftës.<br>- Definojnë rolin e Fuqive të Mëdha në LDB.<br>- Kuptojnë pasojat për popull-sinë civile si dhe Holokaustin.<br>- Nxjerrin përfundime për pasojat e luftës (armëve për shkatërrim në masë) në planin material e shpirtëror te njerëzit e thjeshtë. | Gjeografinë, letërsinë, edukatën qytetare, Ekonominë, fizikën, sociologjinë, artet etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | lindore të hemisferës; Rrjedhat kryesore në rrafshin diplomatik, të cilat ndikuan në intensitetin e luftës dhe u bënë baza mbi të cilën u ngrit rendi i ri botëror; Holokaustin; Kriminelët e Luftës.<br><br>**(6 orë)** | | |
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **3. Bota gjatë Luftës së Dytë Botërore** | **Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore**<br>*1. Shqipëria gjatë LDB 1939-1944*<br>- Pushtimin fashist - italian të Shqipërisë dhe rezistencën e shqiptarëve 1939-1941; Politikën e pushtuesve nazist-fashist karshi Shqipërisë dhe shqiptarëve; Politika e Koalicionit Antifashist ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve; Format e organizimit politiko-ushtarak kundër pushtue- sve nazist-fashist; Përpjekjet për front të përbashkët–kombëtar; Kontributin e Shqipërisë në luftën antifashiste nacionalçlirimtare.<br><br>*2. Kosova dhe viset e tjera shqiptare gjatë LDB 1941-1944* | - Janë në gjendje të shpjegojnë qëndrimin e shtetit shqiptar dhe të shqiptarëve në përgjithësi ndaj pushtimit italian dhe gjerman.<br>- Të analizojnë qëndrimin e fuqive të boshtit (Italisë, Gjermanisë) dhe të Koalicionit Antifashist (Anglisë, SHBA-së, BRSS) ndaj Shqipërisë<br>- Analizojnë specifikat e luftës antifashiste të shqiptarëve në Kosovë.<br>- Vlerësojnë kontributin e shqiptarëve në luftën antifashiste nacionalçlirimtare. | Gjeografinë, shkencat politike, etikën etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Shkatërrimin e Jugosllavisë dhe zonat okupuese në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare;<br>Lëvizjen antifashiste dhe qëndresën e armatosur për çlirim; Formacionet politiko – ushtarake të shqiptarëve (Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe Konferenca e Bujanit); Kontributin e shqiptarëve në Luftën antifashiste;<br>Bashkëpunimi i komuniteteve në Kosovë, gjatë Luftës së Dytë Botërore.<br><br>**(7 orë)** | | |
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **5. Të arriturat në kulturë, në shkencë e në teknikë gjatë shekullit XX** | **Arsimi 1941-1944**<br>Shkollat dhe arsimin shqip 1941-1944;<br><br>**(1 orë)** | - Analizojnë dhe vlerësojnë ecurinë e arsi- mit shqip në atë kohë. | Gjeografinë, artin, etikën, letërsinë etj. |
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **4. Bota pas Luftës së Dytë Botërore** | **Evropa dhe bota gjatë viteve 1945-1999**<br>*1. Riorganizimi i ri i botës dhe zhvillimet kryesore në të*<br>- Organizmat e rinj ndërkombëtarë dhe rajonal-Rendi i Ri Botëror; | - Identifikojnë organizatat ndërkombëtare dhe rajonale.<br>- Krahasojnë gjendjen politike e ekonomike në shtetet demokratike perëndimore dhe ato socialiste lindore. | Edukatën qytetare, artin, shkencat politike, gjeografinë, sociologjinë, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Sovjetizimin e Evropës Lindore; Integrimet evropiane; Luftën e Ftohtë; Botën e Tretë, Dekolonizimin; Fundin e Aparteidit-Demokratizimin, Të drejtat e njeriut; Terrorizmin; Raportet Veri-Jug; Globalizimin; Shthurjen e sistemit socialist (Glasnost, Perestrojka); Periudhën pas Luftës së Ftohtë; Zhbërjen e Jugosllavisë.<br><br>**(4 orë)** | - Hetojnë ndërvarshmërinë ndërmjet proceseve, siç është dekolonizimi, demokratizimi dhe të drejtat dhe liritë e njeriut.<br>- Shpjegojnë shkaqet e rënies së sistemit socialist, të shpërbërjes së shteteve shumëkombëshe socialiste. | ekonominë, të drejtën ndërkombëtare. |
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE.** | **5. Të arriturat në kulturë, në shkencë e në teknikë gjatë shekullit XX** | **Shkenca, Kultura, Teknologjia, Shoqëria në Botë - Periudha e prosperitetit**<br>- Zhvillimet kryesore në shkencë, kulturë, teknologji dhe jetën e përditshme të njerëzve.<br><br>**(2 orë)** | - Vlerësojnë ndikimin e zhvillimeve shkencore, kulturore, sociologjike në cilësinë e jetës së njerëzve të rëndomtë. | Edukatën qytetare, gjeografinë, letërsinë, filozofinë, sociologjinë, fizikën, artin pamor, teknologjinë, telematikën etj. |
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **4. Bota pas Luftës së Dytë Botërore** | **Shqiptarët gjatë viteve 1945-1999**<br><br>1. *Shqipëria gjatë viteve 1944-1999* | - Analizojnë dhe gjykojnë në mënyrë kritike për zhvillimet gjatë regjimit komunist në | - Shkencat politike, marrëdhëniet |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | - Vendosjen dhe thellimin e diktaturës komuniste në Shqipëri; Kolektivizimin-fshati; Industrializimin-qyteti; Pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë; Politikën prolindore dhe izolacioniste; Krizën dhe shthurjen e sistemit komunist; Fillet e jetës plurale dhe hapat e parë në jetën demokratike; Periudha e transicionit.<br><br>*2. Kosova dhe viset e tjera shqiptare gjatë viteve 1945-1999*<br>- Ripushtimin, aneksimin e Kosovës dhe instalimin e sistemit komunist; Organizimin politik dhe Rezistencën e shqiptarëve; Format e shtypjes dhe të diskriminimit të shqiptarëve në Jugosllavi; Plenumin e Brioneve-ndryshimet në pozitën juridiko-kushtetuese të Kosovës 1969-1974; Ndryshimet në jetën shoqërore të shqiptarëve-emancipimi i gruas; Përpjekjet e shqiptarëve për barazi të plotë (demonstratat 1968-1981); Përshkallëzimi i politikës diskriminuese të Beogradit gjatë | Shqipëri.<br>- Definojnë pozitën ndërkombëtare të Shqi- përisë.<br>- Shpjegojnë shkaqet e rënies së sistemit komunist në Shqipëri.<br>- Krahasojnë të drejtat e njeriut në kohën e transicionit demokratik me ato në kohën e komunizmit.<br>- Definojnë politikën e Beogradit ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi.<br>- Analizojnë format e angazhimeve të shqiptarëve për barazi, demokraci dhe liri.<br>- Çmojnë dhe vlerësojnë luftën e armatosur të popullit shqiptar të Kosovës kundër r gjimit të Beogradit 1987-1999 dhe ndërhyrjen e NATO-s. | ndërkombëtare, sociologjinë, gjeografinë etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | viteve 80-ta- Suprimimi i Autonomisë së Kosovës; Lëvizjen demokratike të shqiptarëve 1989-1992; Lëvizjen për pavarësi dhe lufta e armatosur të popullit shqiptar - UÇK; Çështjen e Kosovës dhe Bashkësinë Ndërkombëtare-Konferenca e Rambujesë; Intervenimin e NATO-s dhe çlirimi i Kosovës 1999.<br><br>**(8 orë)** | | |
| **V. KOHA BASHKË-KOHORE** | **5. Të arriturat në kulturë, në shkencë e në teknikë gjatë shekullit XX** | **Arsimi, shkenca, kultura dhe shoqëria te shqiptarët 1944-1999**<br>- Zhvillimet arsimore, shkencore, kulturore dhe ndryshimet në jetën shoqërore, në gjithë hapësirën kulturore shqiptare; Bashkëpunimi kulturo-arsimor Kosovë – Shqipëri.<br><br>**(2 orë)** | - Analizojnë dhe krahasojnë veçoritë e zhvillimeve arsimore, kulturore e shkencore në periudhën e socializmit dhe të demokracisë si dhe ndërmjet këtyre zhvillimeve në Shqipëri, Kosovë dhe diasporë. | Pedagogjinë, letërsinë, sociologjinë, gjeografinë, artin. etj. |

***Vërejtje*:** 4 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që, sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve, të kenë mundësi për të zgjedhur ndojnë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, instituteve, monumenteve etj.

## METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Metodologjia e mësimdhënies përcakton suksesin e realizimit të qëllimeve dhe të objektivave, që mësimdhënësi ia paracakton vetes në bazë të përmbajtjeve programore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë stilet dhe mënyrat e nxënies së vetë nxënësve. Prandaj, gjatë një ore mësimore, mësimdhënësi mund të përdorë disa forma, teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra-tjetrën, në mënyrë që të arrijë rezultate optimale gjatë procesit mësimor. Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore me nxënësin në qendër, sugjerohen metoda, forma dhe teknika të tilla, si:

**Format kryesore të organizimit të procesit mësimor janë:**

- ***Puna me tërë klasën,***
- ***Puna me grupe*** (të mëdha ose të vogla)
- ***Puna me çifte***
- ***Puna individuale***

**Metodat:**

***E mësimdhënies*** **-** (rrëfimi, shpjegimi, ligjërata, biseda, demonstrimi etj.)

***E të mësuarit*** - është metodë e punës së përbashkët e mësimdhënësit dhe e nxënësve dhe përdoret për arritjen e qëllimeve, synimeve, qëllimeve, objektivave etj,

***E të nxënit*** **-** (vrojtimi i pavarur, ushtrimet, diskutimet, debatet, shfrytëzimi i literaturës, shkëmbimi i mendimeve etj.)

***Kërkimore*** **-** është metodë që mundëson të bëhen kërkime historike nëpërmjet burimeve dhe analizave lidhur me saktësinë dhe interpretimin e fakteve të gjetura.

**Teknikat:**

Ekziston numër i madh teknikash të mësimdhënies dhe të nxënies. Këtu sugjerohen vetëm disa prej tyre.

**- Brainstormingu ("stuhi mendimesh", gjenerim ideshë)** - është teknikë efektive që më tepër përdoret në fillim të orës mësimore.

**- Klasteri (grumbulli apo pema e mendimeve) -** nxit nxënësit për të menduar rreth një teme të caktuar. Zakonisht, shërben për të krijuar lidhje midis fakteve.

- **Insert-i - (është sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe leximin e efektshëm)**. Kjo teknikë përdoret në pjesën kryesore dhe është efektive, sepse nxënësi është gjithmonë aktiv dhe mban qëndrim kritik ndaj asaj që e lexon.

- **Pesëvargëshi** – është teknikë e veçantë, e cila ka pesë vargje që kërkon përmbledhjen e informacionit në shprehjet që përshkruajnë apo reflektojnë rreth idesë kryesore të temës.

**- Xhigsou (ndërthurja)** – është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim; leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga të gjithë nxënësit, por nxënës të caktuar janë përgjegjës për pjesë të caktuara.

Teknikat e tjera janë: ***ditari dypjesësh, di, dua të dij, mësova, ese 5 dhe 10, rrjeti i diskutimit, diagrami i Venit, shkrimi i lirë etj.***
***Historia gojore është gjithashtu një nga mënyrat bashkëkohore të të mësuarit të lëndës së historisë.***

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultate të dëshiruara. Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses muzetë, galeritë, bibliotekat, arkivat, ekskursionet në vendet dhe monumentet kulturoro-historike etj.

## VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike i analizës dhe i interpretimit të informatave, me qëllim të përcaktimit se në ç'shkallë nxënësi ka zotëruar objektivat udhëheqës.

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe u shërben disa qëllimeve të ndryshme.

Ndër qëllimet kryesore të vlerësimit, janë:

1. Të sigurojë informacion rreth përparimit të nxënësve.
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor.

3. T'i motivojë nxënësit.
4. Të sigurojë realizimin e objektivave të përcaktuar.
5. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

**Tipat e vlerësimit**

Ekzistojnë tipa të larmishëm të vlerësimit, si:

**- Vlerësimi diagnostikues** përcakton te nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.

**- Vlerësimi formues** ka për qëllim ta udhëzojë mësuesin në planifikim dhe te nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies (punës), me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.

- **Vlerësimi klasifikues** ka për qëllim të caktojë pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotuara paraprake dhe objektivat e parshikuar.

- **Vetëvlerësimi** është proces i mbledhjes, i analizës, i interpretimit të informatave dhe i veprimtarisë që nxënësi e bën vetë me anë të ndonjë mjeti vlerësues.

**- Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies, p.sh., pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti etj.

**- Vlerësimi në bazë të kritereve** kupton vlerësimin e çdo nxënësi që përmbush kriteret e caktuara, p.sh., krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësimdhënësit të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmojë në përmirësimin e tyre.

**Vlerësimi formues** dhe **diagnostikues** nuk vlerësohet me nota, por në bazë të tyre mësimdhënësi planifikon punën e tij.

**- Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor. Veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.

**- Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuse hartohen jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë).

**- Vlerësimi i përditshëm** bazohet në kontrollin e punës së nxënësit në klasë.

**- Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.

**- Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe bazohet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.

**- Vlerësimi në proces** bazohet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune ose detyre në zhvillim etj.

Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- **Kontrolli i zakonshëm i veprimtarive në klasë**
- **Detyrat e shtëpisë**
- **Testet**

- Mësimdhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupton përparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre.

- Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurohen informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë. Në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherit mund të jetë edhe e padobishme, në rast se, në vend se të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës, nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

**Format e testeve janë:**

- Me gojë
- Me shkrim
- Përmes paraqitjes grafike etj.

Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përparimin e nxënësit, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anët negative për arsye se te nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj. Gjatë zbatimit të testimit, sistemi i poentimit zgjedhet nga vetë mësimdhënësi.

Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdorim edhe veprimtari të tjera, p.sh.:

- Vlerësimi i eseve
- Vlerësimi me dosje
- Vetëvlerësimi etj.

## BURIMET DHE MJETET MËSIMORE


1. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Prishtinë, 1997.
2. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Tiranë, 1995.
3. Bardhyl Musai, Psikologjia e edukimit, Shtëpia Botuese: Pegi, Tiranë,1999.
4. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003.
5. Grup autorësh, Të kuptojmë të kaluarën e përbashkët për të ndërtuar të ardhmen, Ndryshime dhe vazhdimësi të jetës së përditshme në Shqipëri, Bullgari dhe Maqedoni 1945 – 2000, botues: EUROCLIO, Shoqata e Mësuesve të Historisë të Shqipërisë, Shoqata Bullgare e Mësuesve të Historisë, Shoqata e Historianëve të Republikës së Maqedonisë, Tiranë, 2003.
6. MASHT, Plani dhe programi mësimor 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003.
7. MASHT, Plani dhe programi mësimor 7, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
8. MASHT, Plani dhe programi mësimor 8, Libri Shkollor, Prishtinë, 2005.
9. Historia e Popullit Shqiptar I, II, Tiranë, 2001.
10. Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj, Historia 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
11. Isa Bicaj, Arbër Salihu, Historia 7, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
12. Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj, Historia 8, Libri Shkollor, Prishtinë, 2005.
13. Mikel Pjetrushi, Atlas historik i botës, Shtëpia Botuese: Camaj – Pipa, Shkodër, 2001.

14. Kristina Popova, Petar Vodenicharov, SnezhanaDimitrova, Gratë dhe burrat në të kaluarën (shekulli XIX dhe XX) *Materiale mësimore plotësuese për shkollat 8-vjeçare.*Blagoevgrad, 2002.

**BURIMET NË INTERNET**

1. www.dadalos.org
2. www.historyplace.com
3. www.see-educoop.net
4. www.eurocliohistory.org
5. www.euroclio.net
6. www.bbc.co.uk/history
7. www.usborne-quicklinks.com (përmes kësaj faqeje mund të shfrytëzohet “Enciklopedia e historisë së botës”- ***lidhur me internet*** , që është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe).

# EDUKATË MUZIKORE

**(1 orë në javë, 35 orë në vit)**

## HYRJE

Muzika është pjesë e formimit kulturor dhe nevojë e përhershme e njeriut.

Ajo komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kreative me tërë qenien e tij, duke ia formuar mjedisin tingëllor. Nisur nga roli i muzikës në jetën e njeriut dhe ndikimit që ka në të, del edhe rëndësia e formimit edukativ-muzikor.

Edukata muzikore mundëson:

- dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mediave dhe të shfaqjeve muzikore;
- pjesëmarrje në formacione korale - instrumentale dhe në veprimtari të tjera muzikore;
- arsimim të mëtejshem, që nënkupton interesim më të gjërë për muzikën, përkatësisht përgatitjen për ndonjë profesion, ku muzika është pjesë përbërëse.

## QËLLIMET

- Të sjellë gëzim, emocione dhe të zgjojë interes për veprimtari të ndryshme muzikore;
- Të zhvillojë dhe të ngrisë muzikalitetin në vazhdimësi;
- Të ndikojë në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;
- Të edukojë për përzgjedhje selektive të programeve muzikore dhe për mjedis të shëndoshë tingëllor;
- Të zhvillojë kriteret për vlerësim dhe mendim kritik.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHËM DHE SPECIFIKË

**Nxënësit do të:**

- ***njohin vepra të përzgjedhura muzikore nga kompozitorët botërorë dhe kombëtarë në zhvillimin kontinual kohor:***
  - vërejnë dhe dallojnë karakterin shprehës, njohin mjetet dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore të dëgjuara;
  - dallojnë llojet dhe zhanret e ndryshme muzikore në bazë të zhvillimit kontinual të muzikës;
  - dallojnë format e caktuara muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
  - njohin dhe përdorin teknologjinë bashkëkohore muzikore;

- ***muzikojnë në mënyrë të përbashkët dhe individuale:***
  - interpretojnë këngë (popullore, artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë) me dhe pa shoqërim instrumental;
  - interpretojnë në instrumente të ndryshme, shoqërime të këngëve dhe përmbajtje të veçanta instrumentale;
  - zhvillojnë në nivel më të lartë ndjenjën ritmike, melodike e harmonike përmes interpretimit dhe dëgjimit;
  - zbatojnë dukuritë e ndryshme ritmike, melodike dhe shkrimin notal;

- ***zhvillojnë kreativitetin:***
  - riinterpretojnë në mënyrë krijuese veprat e interpretuara;
  - improvizojnë dhe eksperimentojnë në bazë të përmbajtjeve të ndryshme muzikore;
  - shprehen në mënyrë kreative me lëvizje, shprehje figurative e letrare, bazuar në përjetimin e veprës së dëgjuar muzikore;

- ***zhvillojnë të menduarit kritik:***
  - vlerësojnë interpretimin individual dhe të përbashkët;
  - vlerësojnë ngjarjet muzikore në mjedisin e tyre.

| | *VEPRIMTARITË MUZIKORE* | *PËRMBAJTJET TEMATIKO-INFORMATIVE* | *REZULTATET E PRITSHME* | BURIMET ARTISTIKE MUZIKORE – SHEMBUJT TË PROPOZUAR PËR DËGJIM |
|---|---|---|---|---|
| ***D Ë GJ I M*** | • *Dëgjojnë në mënyrë përjetuese dhe analitike vepra muzikore;*<br><br>• *Sistemojnë njohuritë për veprat dhe kompozitorët e epokave dhe të stileve në zhvillimin kontinual të muzikës* | • Vepra e kompozitorë të shekullit XX, zhvillimet muzikore stilistike – ekspresionizmi, neoklasicizmi dhe kërkimet e reja në muzikën bashkëkohore;<br><br>• Zhvillimi i muzikës artistike kombëtare bashkëkohore - vepra dhe kompozitorë;<br><br>• Zhvillimet muzikore në shekullin XIX - epoka e romantizmit (muzika programore, kënga solo, miniatura, poema simfonike, opera romantike); impresionizmi në muzikë ;<br><br>• Zhvillimet muzikore në shekullin XVIII – vepra | Nxënësit:<br>• rinjohin vepra dhe dallojnë elemente shprehëse karakteristike të muzikës së shekullit XX, përkatësisht të muzikës bashkëkohore;<br><br>• rinjohin vepra të kompozitorëve të rëndësishëm të epokës së romantizmit; | S. Prokofjev: Simfonia klasike (Koha I)<br>A. Shënberg: Nata e purpurtë për harqe<br>B. Bartok: Mikrokozmos për piano<br>F. Glas: Koncert për violinë dhe orkestër<br>A.Pert: Cantus in memoriam B. Britën për harqe dhe kambana<br><br>A. Koci: Apasionata për piano<br>Z. Ballata: Nëna Terezë (solokëngë)<br>R. Rudi: Avazi i Tanës për klarinet e piano<br>E. Rizvanolli: Musica Simfonica<br>M. Mengjiqi: Donum Musicum për orkestër<br>V. Beqiri: AlbAlcanicA (Koncert për saksofon, harkor dhe perkusione)<br>F. Ibrahimi: Rapsodi shqiptare<br>A. Peçi: Çast poetik për piano<br>V. Tole: Ç'u mbush mali, për kor femrash<br><br>F. Shubert: Suleika (Solokëngë për soprano e piano)<br>F. Shopen: Valsi për piano Ges-dur, Op.70<br>F. List: Poema simfonike Tasso<br>Xh. Puçini: Opera Madam Baterflaj<br>Xh. Rosin: Opera Berberi i Seviljes |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | • *Thellojnë njohuritë për format e mësuara muzikore;* | dhe kompozitorë të epokës së klasicizmit (muzika absolute, homofonia, sonata, simfonia, koncerti, opera);<br><br>• Zhvillimet muzikore në shekullin XVII – epoka e barokut (polifonia, kantata, oratorio); | • rinjohin vepra të kompozitorëve kryesorë të epokës së klasicizmit;<br><br>• rinjohin vepra të kompozitorëve të rëndësishëm të epokës së barokut; | K. Debysi: Preludi i një pasdite të Faunit<br><br>J. Hajdën: Simfonia Nr. 104 “Londineze”<br>V. A. Moxart: Koncert për piano nr. 21<br>L. V. Bethoven: Uvertura Egmond<br><br>J. S. Bah: Kantata BWV 212<br>G. F. Hendël: Oratorio Messiah<br><br>1. VOLFGANG AMADEUS MOZART : Rekuiem d- mol Kv 626<br>2. FREDERIK SHOPEN: Vals nr. 6-8 op. 64<br>3. SERGEJ PROKOFJEV: Simfonia klasike, koha I<br>4. MORIS RAVEL: Bolero<br>5. PHILIP GLASS: Koncert per violine e orkester<br>6. PENDERECKI: Simfonieta per harkor<br>7. ARVO PERT: Cantus in memoriam B.Britten, STRINGS and BELL<br>8. LORENC ANTONI: Suitë korale<br>9. REXHO MULLIQI “Akuarelet e Prizrenit”<br>10 ESAT RIZVANOLLI: Musica Simfonica<br>11. FEIM IBRAHIMI: Toccata C-dur<br>12. VALTON BEQIRI: Kuartet harkor<br>13. MENDI MENGJIQI: Oratorium-fragment<br>14. VINÇENC GJINI: “Letrat” solokëngë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ***D Ë G J I M*** | • *Njohin cilësitë themelore të folklorit muzikor kombëtar*<br><br>• *Dallojnë zhanret e muzikës së lehtë* | • Zhvillimet muzikore në shekullin XVI – vepra dhe kompozitorë të epokës së renesansës;<br><br>• Muzika popullore vokale, instrumentale dhe vokale-instrumentale; polifonia popullore, vallja koreografike;<br><br>• Mjuziklli, xhazi, shansona, kënga e lehtë, roku; | • rinjohin vepra të popullarizuara të epokës së renesansës;<br><br>• rinjohin disa nga format dhe cilësitë themelore të folklorit muzikor;<br><br>• rinjohin zhanret e muzikës së lehtë; | O. di Laso: *Eho* për kor të përzier<br><br>Këngë njëzërëshe - Dola n'bahçe (nga tradita fashatare)<br>- Njëzetepesë gërsheta (nga tradita qytetare)<br>Vokale-instrumentale - Fol një here (nga tradita qytetare)<br>Pjesë instrumentale - Valle popullore<br>Këngë polifonike - Këndon zogu (dyzërëshe)<br>- Një baçe me lule (trezërëshe)<br><br>L. Bernstein: Tregimi nga perëndimi - Amerika (mjuzikëlli)<br>Luis Armstrong (xhaz)<br>Iv Montan (shansona)<br>Këngët e shekullit XX (muzika e lehtë) - S. Bejleri,Vikena Kamenica<br>Elvis Prisli (roku) |
| ***I N T E R P R*** | • *Interpretojnë këngë artistike dhe popullore shqiptare dhe të popujve të tjerë*<br><br>• *Interpretojnë* | • Këngë artistike dhe popullore një, dy dhe shumëzërëshe;<br><br>• Pjesë, tema dhe melodi nga veprat vokale, vokale- | • kanë përvetësuar së paku gjysmën e numrit të këngëve dhe të temave të interpretuara; | Këngë artistike njëzërëshe: Veber – Vera<br>Këngë artistike njëzërëshe me shoqërim instrumental: Shubert - Trëndafilja<br>Këngë artistike dyzërëshe: Bah - Kur gëzimi ...<br>Këngë artistike trezërëshe: Moxart – Kënga e agimit (Fyelli magjik) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ***E T I M*** | *pjesë nga veprat vokale, vokale-instrumentale dhe instrumentale* | instrumentale dhe instrumentale; | | |
| ***K R I J I M*** | • *Riinterpretojnë në mënyrë përjetuese dhe me mjete të shprehjes estetike përmbajtjet e përvetësuara muzikore*<br><br>• *Në bazë të përjetimit të veprës së dëgjuar nxënësit shprehen në mënyrë kreative në forma të ndryshme*<br><br>• *Vlerësojnë interpretimet e tyre si dhe ngjarjet muzikore* | • Këngët, meloditë, temat;<br><br>• Plotësimet, ndryshimet melo-ritmike, krijimi i melodive-këngëve, shoqërime instrumentale dhe vokale;<br><br>• Manifestimet muzikore; | • realizojnë disa nga format e propozuara të punës krijuese sipas prirjeve të tyre individuale; | |

## UDHËZIMET DIDAKTIKO-METODIKE

Mësimdhënia e edukatës muzikore në klasën IX ka karakter përmbyllës të edukimit fillor dhe të mesëm të ulët. Kjo kërkon racionalizim, si në planifikimin e kujdesshëm ashtu edhe në realizimin e përmbajtjeve programore. Në këtë kuptim bëhet sistemimi i përmbajtjeve programore, jo duke i përsëritur ato të klasave të mëparshme, por duke i vështruar dhe duke i njohur nga një këndvështrim më i gjerë. Kjo do të thotë se një çështje a dukuri që është përjetuar dhe njohur më parë, në këtë klasë përpunohet më gjerësisht përmes përmbajtjeve - shembujve të rinj nga literatura muzikore. Përveç kësaj, dëgjimi dhe interpretimi i veprave dhe i kompozitorëve bëhet në mënyrë kronologjike, pra sistemohen në epokat zhvillimore të muzikës. Renditja kronologjike është realizuar duke u nisur nga vepra e autorë të muzikës bashkëkohore (botërorë dhe kombëtarë) për të vazhduar thellimin në epokat paraprake. Në këtë mënyrë mësimdhënia nuk rëndohet me shpjegime të zhvillimit historik prej komunitetit të parë shoqëror, duke u ngritur në epokat vijuese, por zbret prej bashkëkohësisë e deri tek ata autorë dhe vepra që janë aktualë në jetën muzikore. Në këtë mënyrë është bërë dallimi mes sistemimit praktik dhe atij historik, i i cili do të mund të çonte në verbalizëm dhe në historicizëm.

Kjo bëhet e mundshme, duke i koncipuar njësitë e gërshetuara në kuadër të veprimtarive: dëgjimi, interpretimi dhe krijimi. Në temat mësimore, që paraqiten në vazhdimësi edhe në klasat e mëparme, tani kërkesat thellohen dhe zgjerohen, kurse shkoqitja e përmbajtjeve të reja duhet të bëhet duke pasur parasysh mundësitë zhvillimore muzikore të nxënësve.

Njësitë mësimore shumëdimensionale janë në funksion të kësaj kërkese, në mënyrë që aktivizimi i nxënësve të jetë në përputhje me interesimet dhe aftësitë individuale të tyre.

Kërkesat që paraqiten në përmbajtjet programore mbështeten dhe zgjidhen duke u bazuar në:

1. Literaturën e përzgjedhur muzikore për dëgjim dhe interpretim;
2. Njohuritë, konceptet dhe ligjshmëritë muzikore të cilat ndihmojnë në ngritjen e nivelit të arsimimit muzikor;
3. Informacionet për kulturën muzikore të mjedisit të nxënësit si dhe formimin e qëndrimit estetik dhe pozitiv ndaj krijimtarisë kombëtare dhe botërore.

DËGJIM

Procedura metodike e dëgjimit të veprave të përzgjedhura duhet të mundësojë **dëgjim aktiv**. Dëgjimi duhet të jetë **i shkurtër** dhe **i përsëritur**, gjë që do të mundësojë rritjen e koncentrimit të vëmendjes së nxënësit. Posaçërisht dëgjimi i përsëritur mundëson njohjen më të gjithanshme të veprave, kompozitorëve, epokave dhe stileve, si dhe formës muzikore e formacioneve interpretuese. Me përgatitje motivuese para dëgjimit dhe komentimet përkatëse pas dëgjimit, procedura mësimore pasurohet dhe bëhet më atraktive për nxënësin. Informatat kthyese, si: të shprehurit e përjetimit të veprës së dëgjuar në forma të ndryshme, komenti për elemente të saj etj., janë primesa të dëgjimit analitik.

INTERPRETIM

Intepretimi realizohet përmes këndimit dhe luajtjes në instrumente. Procedura metodike e këndimit bëhet: sipas veshit( imitimit), tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar (kur metoda sipas veshit dhe ajo sipas tekstit notal kombinohen), duke marrë parasysh mundësitë individuale të nxënësve. Luajtja në instrumente aplikohet në shoqërimin e këngëve dhe në interpretimin e përmbajtjeve të veçanta instrumentale. Meqenëse përmbajtjet programore në këtë klasë janë nga muzika vokale, vokalo-instrumentale dhe instrumentale, kërkesa për këndimin e temave ose të melodive të këtyre veprave është e arsyeshme. Nga aspekti metodik është mirë që këto të mësohen para dëgjimit të veprës, ngase kështu bëhen mbështetje dhe lidhje për koncentrimin e vëmendjes gjatë dëgjimit.

KRIJIM

Puna krijuese e nxënësit duhet të përshkohet nga spontaniteti dhe liria e të shprehurit përmes: krijimit të tërësive ritmike dhe melodike të mbështetura në tekste poetike, lëvizjes, shprehjes figurative dhe letrare.

## VLERËSIMI

Mësimdhënësi bën vlerësimin e arritjeve të edukimit muzikor në bazë të kërkesave profesionale didaktike dhe psikologjike. Vlerësimi bëhet në kuadër të grupit, duke vlerësuar arritjet në zhvillimin muzikor

individual të nxënësve në dëgjimin aktiv, interpretimin vokal-instrumental dhe punën krijuese.

Mësimdhënësi përcjell, evidencon dhe vlerëson aftësitë muzikore, shkathtesitë interpretuese, dituritë informative, ndjeshmërinë dhe interesimin e nxënësve.

Vlerësohet rinjohja dhe përjetimi i shprehjes muzikore në veprat e dëgjuara.

Interpretimi vokal dhe instrumental vlerësohet në bazë të përvetësimit të numrit të caktuar të këngëve dhe të përmbajtjeve instrumentale, saktësisë melodike-ritmike dhe interpretimit të përjetuar. Vlerësimi duhet të jetë i baraspeshuar mes këndimit sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar, gjithnjë duke pasur parasysh mundësitë individuale të nxënësve.

Mësimdhënësi duhet ta përcjellë dhe të inkurajojë interesimin e nxënësit për shprehje kreative, në veçanti vlerësohet:

- rinjohja e veprave të dëgjuara
- këndimi dhe luajtja instrumentale
- diktimet melodike dhe ritmike
- përgjigjet me goje dhe me shkrim
- prezantimi

Instrumente të tjera të vlerësimit janë:

- testi
- vetëvlerësimi

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh standardet sipas nivelit dhe rezultatet e arritshmërisë në varësi me objektivat e parashtruar.

### *FORMAT E VEÇANTA TË DETYRUESHME TË MËSIMDHËNIES MUZIKORE*

Puna me kor dhe me orkestër është formë e veçantë dhe e detyrueshme e edukimit muzikor në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Në kor dhe në orkestër marrin pjesë nxënësit me aftësi muzikore të theksuara dhe në bazë të interesit të tyre.

Këto forma të mësimdhënies muzikore paraqesin nivel të lartë të interpretimit muzikor dhe e përfaqësojnë shkollën në të gjitha shfaqjet publike në shkollë dhe jashtë saj.

Puna me korin dhe orkestrën e shkollës, si bazë për formimin e jetës artistike, do të jetë e planifikuar dhe e matshme me orar. Mund të formohen kore të niveleve të ndryshme, ora në kor zgjat sa ora mësimore, 45 minuta. Kjo punë e mësimdhënësit llogaritet në normën javore mësimore të tij me fond javor 2- 4 orë ( varësisht nga niveli). Gjatë vitit shkollor kori përgatit dhe prezanton program me kritere artistike–pedagogjike.

## ART FIGURATIV

**(1 orë në javë, 35 orë në vit)**

### HYRJE

Duke kaluar nga klasa në klasë, klasa e nëntë paraqet një shkallë më të avancuar të kurrikulit, duke u ngritur në orientim koorelativ të mësimit më të profilizuar apo të specializuar. Natyrisht, nga mosha në moshë, arti figurativ absorbohet gjithnjë e më tepër në shpirtin e të riut, duke arritur një pjekuri më të theksuar.

Në këtë aspekt lënda e artit figurativ zhvillon shpirtin më kreativ individual me orientim ndaj kulturës artistike dhe asaj të përgjithshme shoqërore.

### QËLLIMET

Nxënësit e kl. 9 (nëntë) duhet të zhvillojnë gjuhën individuale figurative si një komunikim më kreativ, si avancim me kulturën figurative përgjithësisht.

Përmes orientimit, nga mendimi individual kritik për vlerësim e gjykim, përkatësisht nga vetëdijesimi përmes njohurive dhe zotësive, nxënësit qartësojnë afinitete të ndryshme ndaj lëmenjve shprehës me llojllojshmërin e teknikave e të materialeve punuese.

Aktivitet me intensiv në lirinë shprehëse për pasurimin e mjedisit shkollor e jashtëshkollor, si afrim indivdual në kulturën pamore.

## OBJEKTIVAT

| E përgjithshëm: | Specifikë: |
|---|---|
| Nga përmbajtja programore për klasën e 9 (nëntë) nxënësit duhet që: | |
| Të njohin | - Korelacionin e njohurive figurative me përmbajtjet shkencore-natyrore e shoqërore të vendit e të kohës, ku dhe kur jetojnë.<br>- Lëmenjtë apo fushë-shprehjet figurative me llojllojshmëri teknikash e materialesh punuese |
| Të orientojnë | - Qasjet individuale-prirjet për gjuhën figurative me komunikim në jetën e përditshme |
| Të veçojnë | - Dominanten dhe unitetin e elementeve estetikë figurative |
| Të krijojnë | - Harmoninë kompozicionale |
| Të vlerësojnë | - Arritjet përmbajtësore të njohurive e të shkathtësive figurative |
| Të kultivojnë | - Eseun e përjetimeve figurative<br>- Kujdesin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore<br>- Vizitën ekspozitave, galerive, muzeve, ateleve artistike etj. |

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES

| | |
|---|---|
| I. Të vërejturit dhe përceptimi | 1- Hapësira<br>2- Forma<br>3- Sipërfaqja |
| II. Të shprehurit dhe kreativiteti | 1- Vija<br>2- Ngjyra<br>3- Vëllimi |
| III. Analizë dhe vlerësim | 1- Komunikimi<br>2- Eseja |

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

### Kategoria I – Të vërejturit dhe përceptimi

| Nënka-tegoritë | Temat mësimore | Udhëzime metodologjike | Rezultatet e pritshme |
|---|---|---|---|
| 1<br>Hapësira | - Ritmi (lëvizja)<br>- Drejtimi (kahja) (drejtpeshimi) | - Komponime të lira (teknika e materiale të ndryshme) që paraqesin sensibilitetin e lëvizjes apo ritmi dhe drejtimi apo kahja si harmoni e ndjenjës estetike. | Nxënësi do te:<br>- Kuptojë ekuilibrin estetik që mbeshtetet në parimet e ritmit dhe të drejtimit të ndërtimit hapësinor. |
| 2<br>Forma | - Trajta gjeometrike<br>- Trajta valerike | - Komponime abstrakte apo imagjinative në lëmenjtë figurativë<br>-Komponime tridimensionale në lemenjtë figurativë. | - Dallojë formën dekorative dhe atë vëllimore, duke e aplikuar edhe në jetën e përditshme mjedisore. |
| 3<br>Sipërfaqja | - Masa<br>- Struktura<br>- Natyrore<br>- Artificiale | - Komponime me materiale të teknikave të ndryshme. | - Kreirojë imazhe figurative, duke bërë shprehjen me përmbajtësore dhe emocionale. |

### Kategoria II- Të shprehurit dhe kreativiteti

| Nënka-tegoritë | Temat mësimore | Udhëzime metodologjike | Rezultatet e pritshme |
|---|---|---|---|
| 1<br>Vija | - Ilustrime të ndryshme | Zgjidhja figurative e përmbajtjeve letrare. | Nxënësi do të:<br>- Konkretizojë figurativisht gjuhën verbale në atë joverbale. |
| 2<br>Ngjyra | - Trajta abs-trakte imagji-native, deko-rative, vale-rike reale etj. me përshta- | - Kombinimi i lirshëm individual në aplikimin e teknikave e materialeve pikturale e dekorative. | - Zhvillojë e të orientojë intuitën pikturale apo dekorative me kreativitet më të avancuar |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | tëshmëri individuale të teknikave e materialeve pikturale. | | individual. |
| 3 Vëllimi | - Trajta vëllimore në materiale natyrore e artificiale | - Vëllimi si simbol dhe si identitet i kuptimit (konceptit) real apo objektiv, punuar sipas imagjinatës apo realitetit. | - Dallojë formën iluzionare dydimensionale të vizatuar apo të pikturuar, nga ajo tridimensionale apo skulpturale. |

### Kategoria III – Analiza dhe vlerësimi

| Nënka-tegoritë | Temat mësimore | Udhëzime metodologjike | Rezultatet e pritshme |
|---|---|---|---|
| 1 Komunikimi | - Organizim dhe vizitat e ekspozitave shkollore e jashtëshkollore.<br>- Informacione e reflektime nga historia e artit botëror e shqiptar | - Zgjedhja e punimeve dhe organizimi i ekspozitës.<br>- Analizë e zhvillimit historik të artit figurativ. | Nxënësi do të: NDJEJË rëndësinë e artit figurativ si kulturë e shpirtit estetik,i ntelektual e kreativ, edukativ e shoqëror etj. |
| 2 Eseja | - Mbresa përjetuese të verbalizuara si shprehje e mendimit kritik individual | - Analizë mbështetje e aftësisë inteligjente te nxënesit. | - Krijojë medium personal artistik |

## QASJET NDËRLENDORE DHE PROGRAMORE

- Informacionet kuptimore e terminologjike sa më shumë që bëhen të pranueshme nga lëndët mësimore shkollore, aq më tepër zhvillohet koorelacioni i artit figurativ me jetën dhe disiplinat shkencore, p.sh., letërsia, historia, gjeometria, biologjia etj. Këto qasje ndërlëndore e programore vetëdijesojnë nxënësin si personalitet të ngritur në nxënie dhe në shoqërinë bashkëkohore.

## VLERËSIMI

- Realizimi i objektivave të planifikuar të programuar, si proces i të nxënit, krijohet bazë në të zhvilluar e të vlerësuarit në njohje përmbajtësore lëndore, aftësi në zbatimin e shprehjes figurative individuale kreative dhe reflektim i mendimit kritik.

## BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

- Shumëllojshmëria e teknikave të lëmenjve figurativë e aplikativë me materiale të llojllojshme për shprehje sa më kreative e bën më të lehtë metodologjinë punuese për realizimin e procesit mësimor. Si burim për informacione më të konkretizuara ndihmojnë ekspozitat e veprave figurative, videokaseta, CD – të dhe reprodukimet e kulturës artistike figurative gjithënjerëzore.

## PUNA PRAKTIKE (përvoja e të nxënit)

- Përshtatja e njohurive – aftësive psikofizike të nxënësve dhe e kushteve punuese .
- Llojllojshmëria e fenomeneve dhe e dukurive natyrore e shoqërore shprehet me llojllojshmëri të lëmenjve figurativë, të teknikave e të materialeve klasike e bashkëkohore.
- Bashkëpunimi arsimtar-nxënës-prind-shkollë krijon aplikueshmëri metodologjike programore, liri shprehëse, avancim kultoror dhe ndryshim të rrethit jetësor.
- Vizitimi i drejtpërdrejtë i veprave artistike rrit cilësinë e shprehjes figurative.
- Ndikimi përmes artit në globalizimin e kumunikimit mulitimedial.
- Disiplina punuese kultivon rëndësinë për arritjen e objektivave programorë.
- Ruajtja e trashëgimisë arkeologjike, etnografike e artistike është pasqyrë e identitetit kombëtar.

## TEKNOLOGJI ME TIK

**(2 orë në javë, 70 orë në vit)**

### HYRJE

Teknologjia në përgjithësi dhe Teknologjia e informimit dhe e komunikimit (TIK) në veçanti paraqet njërin nga lëmenjtë kryesorë në jetën bashkëkohore të njeriut, është pjesë e pandarë e veprimtarisë së përditshme të tij dhe sinonim i gatishmërisë për t'u marrë me problemet e të tashmes dhe të ardhmes.

Lënda Teknologji me TIK për klasën e 9-të është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake nga kjo fushë dhe ka të bëjë me përvetësimin e njohurive dhe të shkathtësive të nevojshme nga elektroteknika, elektronika, teknologjia e transportit, përdorimi i suksesshëm dhe i pavarur i pajisjeve të teknologjisë së informimit dhe të komunikimit në përgjithësi. Gjithashtu, një kujdes i veçantë u është kushtuar edhe materialeve elektroteknike dhe elektroinstaluese si bazë të ndërtimit dhe të funksionimit të aparateve elektrotermike shtëpiake. Një kategori e veçantë i kushtohet edhe teknologjisë së transportit tokësor, ujor dhe ajror si dhe sistemeve komanduese dhe drejtuese të tyre.

### QËLLIMET

1. Zhvillimi i shkathtësive të përhershme për mbledhjen e të dhënave relevante nga lëmi i teknologjisë dhe zbatimi i shkathtësive të fituara në situata të ndryshme të jetës së përditshme.
2. Nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i njohin veçoritë kryesore të komponenteve elektroteknike dhe elektronike dhe përdorimin tyre në jetën e përditshme, përfshirë edhe pajisjet e teknologjisë së informimit dhe të komunikimit.

3. Nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i njohin dhe t'i përdorin pajisjet e teknologjisë së informimit dhe të komunikimit për parashtrimin dhe zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

1. Zhvillimi i aftësive të nxënësit për të njohur konceptet dhe parimet e elektroteknikës.
2. Njohja e nxënësve me komponentet elektronike dhe zbatimin e tyre në qarqe elektronike dhe në pajisje elektronike.
3. Nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i njohin pajisjet dhe mundësitë aktuale për përdorimin e softuerit sistemor.
4. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të përdorin programet për përpunimin e dokumenteve tekstuale, për përdorim të përgjithshëm.

## OBJEKTIVAT E VEÇANTË

1. Njohja e nxënësve me materialet elektroteknike, prodhimin dhe bartjen e energjisë elektrike, materialet elektroinstaluese, aplikimin e elektromagnetit në teknikë, aplikimin e induksionit elektromagnetik në teknikë, përdorimin e pajisjeve elektrotermike.
2. Zhvillimi i shkathtësive për përpunimin e modeleve me materiale elektroinstaluese.
3. Njohja e nxënësve me komponentet elektronike pasive dhe aktive.
4. Njohja e nxënësve me qarqet elektronike kryesore - analoge dhe digjitale.
5. Njohja e nxënësve me ndërtimin dhe përdorimin e qarqeve të integruara.
6. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të kryejnë operacionet themelore me të dhëna.
7. Njohja me komponentet kryesore të sistemit kompjuterik (harduerin dhe softuerin).
8. Nxënësit duhet të njohin dhe të jenë në gjendje t'i identifikojnë dhe t'i përdorin mundësitë e sistemit operativ Windows.
9. Nxënësit duhet të njohin dhe të jenë në gjendje t'i identifikojnë dhe t'i përdorin mundësitë e programit MS Word.

10. Njohja me teknologjinë e transportit dhe me sistemet e mjeteve të transportit.

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

| Kategoritë | Nënkategoritë | Nr. i orëve | Përqindja |
|---|---|---|---|
| **1. Teknologjia e materialit. Bazat e elektroteknikës** | 1.1 Organizimi i vendit të punës dhe mbrojtja<br>1.2 Njohja me materialet elektroteknike<br>1.3 Prodhimi dhe bartja e energjisë elektrike<br>1.4 Materialet elektroinstaluese | **10** | **14,29%** |
| **2. Aplikimet e elektroteknikës dhe aparatet elektrotermike shtëpiake** | 2.1 Aplikimi i elektromagnetit në teknikë<br>2.2 Aplikimi i induksionit elektromagnetik në teknikë<br>2.3 Konstruksioni i aparateve elektrotermike shtëpiake | **9** | **12,85%** |
| **3. Elektronika** | 3.1 Elementet e qarqeve elektrike dhe elektronike<br>3.2 Qarqet e integruara | **10** | **14,29%** |
| **4. Teknologjia e transportit** | 4.1 Transporti tokësor, ujor dhe ajror<br>4.2 Sistemet e komandimit të mjeteve të transportit<br>4.3 Sistemet drejtuese dhe mbështetëse në transport | **6** | **8,57%** |
| **5. Teknologjia e informimit dhe komunikimit (TIK)** | 5.1 Sistemet numerike<br>5.2 Njësia për sasinë e informatës dhe kodet<br>5.3 Sistemi kompjuterik<br>5.4 Hardueri<br>5.5 Softueri<br>5.6 Sistemi operativ<br>5.7 Programet aplikative | **35** | **50,00%** |

| Kategoria | Nënkategoria | Përmbajtja programore | Rezultatet që duhet arritur | Lidhja ndërlëndore |
|---|---|---|---|---|
| **1. Teknologjia e materialit. Bazat e elektroteknikës** | **1.1 Organizimi i vendit të punës dhe mbrojtja** | 1.1.1 Organizimi i vendit të punës në kabinetin e teknologjisë<br>1.1.2.Rreziqet që mund të shkaktohen nga rryma elektrike dhe masat mbrojtëse nga goditja elektrike | Të njohë rreziqet që mund të shkaktohen nga rryma elektrike dhe masat mbrojtëse nga goditja elektrike. | Gjuhë amta-re, gjuhë angleze, fizikë<br>kimi |
| | **1.2 Njohja me materialet elektroteknike** | 1.2.1 Materialet përçuese<br>1.2.2 Materialet izoluese<br>1.2.3 Materialet gjysmëpërçuese<br>1.2.4 Teknologjia e materialeve elektroteknike- përçuesit, rezistorët dhe izolatorët | Të njohë materialet përçuese, izoluese dhe gjysmëpërçuese.<br>Të njohë teknologjinë e përpunimit të përçuesve, rezistorëve dhe izolatorëve. | |
| | **1.3 Prodhimi dhe bartja e energjisë elektrike** | 1.3.1 Prodhimi i energjisë elektrike<br>1.3.2 Hidrocentralet, termocentralet, centralet nukleare etj.<br>1.3.3 Bartja dhe shpërndarja e energjisë elektrike | Të njohë mënyrën e prodhimit të energjisë elektrike në tipat e ndryshëm të centraleve elektrike.<br>Të njohë mundësitë e bartjes dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike. | |
| | **1.4 Materialet elektroinstaluese** | 1.4.1 Simbolet dhe skemat elektroteknike<br>1.4.2 Materialet elektroinstaluese - përçuesit, gypat dhe kanalet instaluese, kutitë shpërndarëse, siguresat instaluese, çelësat, prizat, spinat, fytet e poçave etj. | Të njohë simbolet themelore si dhe skemat elektrike.<br>Të njohë materialet e ndryshme elektroinstaluese dhe të njohë punën me këto materiale përmes konstruk-timit të qarku elektrik: | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 1.4.3 Puna me materialet elektroinstaluese<br>1.4.4 Puna me instrumentet matëse | 1. (bateri, çelës njëpolar dhe poç),<br>2. (bateri, çelës serik dhe dy poça).<br>Të njohë punën me instrumentin matës universal. | |
| **2. Aplikimet e elektroteknikës dhe aparatet elektrotermike shtëpiake** | **2.1 Aplikimi i elektromagnetit në teknikë** | 2.1.1. Elektromagneti dhe aplikimi i tij në teknikë<br>2.1.2 Zilja elektrike<br>2.1.3 Releu elektromagnetik<br>2.1.4 Konstruktimi i modelit të releut elektromagnetik | Të njohë elektromagnetin dhe aplikimin e tij në teknikë.<br>Të njohë dhe të kuptojë zilen elektrike, releun elektromagnetik, etj.<br>Të njohë dhe të zbatojë konstruktimit e releut elektromagnetik dhe të ziles elektrike).<br>Të njohë punën me instrumentin matës universal. | Gjuhë amtare, gjuhë angleze, fizikë kimi |
| | **2.2 Aplikimi i induksionit elektromagnetik në teknikë** | 2.2.1 Aplikimi i induksionit elektromagnetik në teknikë<br>2.2.2 Transformatori<br>2.2.3 Elektromotori<br>2.2.4 Alternatori – gjeneratori i energjisë elektrike alternative | Të njohë dhe të kuptojë zbatimin e induksionit elektromagnetik në teknikë.<br>Të njohë dhe të kuptojë punën e transformatorit.<br>Të njohë dhe të kuptojë punën e elektromotorit.<br>Të njohë dhe të kuptojë punën e alternatorit. | |
| | **2.3 Konstruksioni i** | 2.3.1 Njohja me pjesët konstruktive të aparateve elektrotermike shtëpiake | Të njohë pjesët konstruktive të aparateve elektrotermike. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **aparateve elektrotermike shtëpiake** | 2.3.2 Përdorimi i aparateve elektrotermike<br>2.3.3 Shfrytëzimi racioanl i energjisë elektrike | Të njohë mënyrën e përdorimit të aparateve elektrotermike.<br>Të njohë mundësinë e shfry-tëzimit racional të energjisë elektrike dhe të zbatojë ate në jetën e përditshme. | |
| **3. Elektronika** | **3.1 Elementet e qarqeve elektrike dhe elektronike** | 3.1.1 Rezistorët<br>3.1.2 Kondensatorët<br>3.1.3 Induktorët<br>3.1.4 Elementet gjysmëpërçues (diodat, transistorët, tiristorët) | Nxënësi duhet të jetë në gjendje: të dallojë fizikisht dhe në skema elektrike komponentet elektronike pasive dhe aktive (llojet e ndryshme të rezistorëve, kondensatorëve dhe të bobi-nave; llojet e ndryshme të diodave e transistorëve; kom-ponentet optoelektronike).<br>Nxënësit duhet të njohin karakteristikat kryesore të komponenteve elektronike. | Matematikë,<br>Fizikë,<br>Kimi,<br>Gjuhë shqipe |
| | **3.2 Qarqet e integruara** | 3.2.1 Ndërtimi i qarqeve të integruara<br>3.2.2 Llojet dhe zbatimi i qarqeve të integruara | Nxënësi duhet të jetë në gjendje: të dallojë fizikisht dhe në skema elektrike qarqet e integruara.<br>Nxënësi duhet të njohë proceset e ndërtimit të qarqeve të integruara. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Nxënësi duhet të njohë llojet e qarqeve të integruara dhe zbatimin e tyre në pajisje elektronike konkrete. | |
| **4. Teknologjia e transportit** | **4.1 Transporti tokësor, ujor dhe ajror** | 4.1.1 Llojet e transportit tokësor<br>4.1.2 Transporti ujor<br>4.1.3 Transporti ajror dhe në gjithësi | Të njohë llojet e transportit tokësor, ujor dhe ajror.<br>Të njohë përparësitë e tri llojeve të transportit. | Gjuhë amëtare<br>Gjuhë angleze |
| | **4.2 Sistemet e komandimit të mjeteve të transportit** | 4.2.1 Sistemi i transmisionit<br>4.2.2 Sistemi i frenimit<br>4.2.3 Sistemi i drejtimit | Të njohë funskionimin e sistemit të transmisionit, frenimit dhe të drejtimit te mjetet e transportit. | |
| | **4.3 Sistemet drejtuese dhe mbështetëse në transport** | 4.3.1 Sistemet drejtuese<br>4.3.2 Sistemet mbështetëse | Të njohë detyrat që kryejnë sistemet drejtuese në transport.<br>Të njohë llojet e sistemeve mbështetëse në transport. | |
| **5. Teknologjia e informimit dhe komunikimit** | **5.1 Sistemet numerike** | 5.1.1 Sistemi dekad<br>5.1.2 Sistemi binar, konvertimi dekad-binar dhe binar-dekad<br>5.1.3 Operacionet aritmetikore me numra binarë (mbledhja, zbritja) | Njohuri të përvetësuara për sistemin binar.<br><br>Zotërimi i operacioneve aritmetike me numra binarë. | Matematikë,<br>Gjuhë shqipe<br>Gjuha angleze |
| | **5.2 Njësia për sasinë e informatës dhe kodet** | 5.2.1 Biti, Byte-i, shumëfishat e bitit dhe byte-it.<br>5.2.2 Kodi ASCII. | Njohja e njësisë për sasinë e informatës, operacionet me shumëfisha të bitit dhe byte-it. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **5.3 Sistemi kompjuterik** | 5.3.1 Sistemi kompjuterik, hardueri, softueri<br>5.3.2 Shfrytëzuesit (njeriu, kompju-terët tjerë, pajisjet teknologjike të proceseve) | Identifikimi i pjesës harduerike dhe softuerike të sistemit kompjuterik. | |
| | **5.4 Hardueri** | 5.4.1 Njësia qendrore, funksioni, modelet e procesorëve, cilësitë: gjatësia e fjalës procesorike, shpejtësia e punës, frekuenca e punës.<br>5.4.2 Njësitë hyrëse dhe dalëse, funksioni, llojet: monitori, tastiera, miu, skaneri, kamera digjitale, modemi, kartela e rrjetit, kartela e zërit me altoparlantë, njësitë e CD-ve, disketave, DVD-ve, zipat.<br>5.4.3 Memoria, funksioni, mediumet e memories: gjysmëpërçuesi (RAM, ROM, EPROM) optik (CD, DVD) dhe magnetik (disqet, disketat, shiritat), kapaciteti, shpejtësia, llojet: memoria qendrore, kesh memoria, memoria e jashtme (periferike) | Identifikimi i komponentëve të ndryshme të sistemit kompjuterik.<br><br>Njohja e cilësive të komponentëve të sistemit kompjuterik. | |
| | **5.5 Softueri** | 5.5.1 Softueri sistemor (sistemi operativ), shembuj: sistemi operativ DOS, UNIX, Windows<br>5.5.2 Softueri aplikativ, shembuj: Pakete për zhvillimin e aplikacioneve | Dallimi i funksionit të sistemit operativ nga aplikacionet softuerike.<br><br>Njohja me aplikacionet | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | (Visual Basic, Access, etj.), programet për zyrë (MS Office), programet për disenj, Multimedia<br>5.5.3 Ndërlidhja e softuerit me harduerin dhe shfrytëzuesit | softuerike për përdorime praktike. | |
| | **5.6 Sistemi operativ** | 5.6.1 Lëshimi në punë. Desktopi, ikonat, dritaret, dialogët, etj. Startimi dhe mbyllja e programeve.<br>5.6.2 Folderët dhe ajllat(operacionet): hapja, mbyllja, krijimi, fshierja, kopjimi, shtypja, etj.<br>5.6.3 Konfigurimi i Windows-it: Control Panel (Display, Time, etj.). Çlajmërimi, ristartimi, ndalja e Windowsit. | Njohja e operacioneve themelore në Windows.<br><br>Aftësimi i nxënësve për ekzekutimin e operacioneve themelore në Windows. | |
| | **5.7 Programet aplikative** | 5.7.1 MS Word - Startimi. Shkruarja e tekstit, shkronjat e vogla dhe të mëdha, fontet, madhësia e shkronjave.<br>5.7.2 Ruajtja, hapja, mbyllja e dokumentit, dalja nga programi. Editimi (insertimi i tekstit, selektimi, fshierja, kopjimi, zhvendosja, etj.).<br>5.7.3 Insertimi dhe vizatimi i objekteve. Tabelat. Shtypja e dokumentit. | Njohja e operacioneve themelore të MS Word-it dhe të aplikacioneve të integruara në Windows-it.<br><br>Aftësimi i nxënësve për ekzekutimin e operacioneve themelore të MS Word-it dhe të aplikacioneve të integruara në Windows. | |

## UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE TË BURIMEVE TËTJERA MËSIMORE

### Literatura e propozuar

1. Dr. Agni Dika, Mr. Seb Rodiqi, “Kompjuterët dhe informatika”, për nxënësit e kl. I të shkollës së mesme,
2. Dr. Agni Dika, Seb Rodiqi, “Kompjuteri për të gjithë”,
3. Literatura në gjuhën angleze për: Windows 95, Windows 98, Windows 2000, Windows XP, MS Office 97, MS Office 2000, MS Office XP, etj.
4. Udhëzimet e integruara në Windows dhe aplikacionet MS Office dhe Internet Explorer
5. Pajtim Bejtja, Alqi Mustafai, Eva Zagori, Renata Qatipi, Robert Tytymçe, Franko Kondakçi: “Teknologjia 1”, Tiranë, 2002.
6. Engjëll Tartari, Alqi Mustafai, Eva Zagori, Velesin Peçuli: “Teknologjia 2”, Tiranë, 2002.
7. Piro Cipo,...., “Teknologjia 3”, Tiranë, 2002.
8. Prof. Dr. Pirro Cipo, Prof. dr. Jakup Agalliu, Faruk Basha, Ibrahim Xhamaj, “Teknologjia 4” , për shkolla të mesme të përgjithshme, Shblsh, 2001,
9. Rexhep Berisha: “Arsimi teknik”, klasa VIII, Prishtinë, 2001.
10. Boris Abersek, Franjo Florjancic, Amand Patopnik: “Tehnika 7”, Lubjanë, 2000.

### Pajisjet dhe parakushtet e tjera të nevojshme

1. Kabineti me kompjuterë dhe shtypës
2. Aplikacionet e nevojshme softuerike
3. Lidhja në internet, rrjeti lokal në kabinet
4. Komponente harduerike për demonstrim
5. Trajnime për arsimtarë
6. Mirëmbajtja

**VËREJTJE:**

1. Në fondin e paraparë të orëve janë përfshirë: ligjërimi, përforcimi i lëndës dhe testimi i nxënësve.

**UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME**

1. Theksi në demostrim dhe punë individuale dhe grupore, p.sh., ligjërimi 25%, demonstrimi 25 %, puna individuale dhe grupore 50%
2. Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimit të dijes dhe të shkathtësive, puna interaktive
3. Përsëritja e përmbajtjes përmes detyrave që përfshijnë zbatimin e më shumë njohurive të fituara

# EDUKATË FIZIKE DHE SPORTIVE

**(2 orë në javë, 70 orë në vit)**

## HYRJE

Në kuadër të rritjes e të zhvillimit biologjikë e shoqëror të nxënësve të kësaj moshe, e duke i shfrytëzuar maksimalishtë kushtet objektive që i ofron shkolla, programi veprues lëvizor i kësaj lënde duhet të jetë stimulues, zhvillimor, edukativ-human, preventiv i së keqes shëndetësore dhe sa më shumë formues i shprehive pozitive të mjeshtërisë sportive.

Më afër, përmbajtjet programore me ngarkesa lëvizore duhet t'iu përshtaten aftësive zhvillimore të nxënësve, qofshin ata me pengesa të ndryshme psikosomatike apo me prirje për lëvizje mjeshtërore.

## QËLLIMET

Programet e hartuara e të miratuara, pas diskutimeve profesionale me vërtetim objektiv atje ku ka mundësi krahasuese numerike, duhet t'u mundësojnë nxënësve:

- zhvillim të drejtë të aftësive lëvizore e njëherit atyre funksionale duke stimuluar rritën dhe mbrojtjen e shëndetit;
- zbulimi dhe zvogëlimi të mangësive lëvizore, e njëherit atyre psikosomatike;
- rriten e nivelit të mjeshtërisë sportive (shprehive) dhe memorimi programor sa më stabil e zbatues në jetën reale dhe në sport;
- përzgjedhje dhe stërvitje sa më e specifikuar dhe e qëlluar në disiplinat e ndryshme sportive, sportet olimpike, ku nxënësit paraprakisht kanë treguar rezultate etj.

Realizimi i këtyre qëllimeve do të duhej të ketë mbështetje të fortë organizative e përgjegjëse të : aktivit të mësuesve të edukimit sportiv,

drejtorisë së shkollës, organeve të arsimit e të sportit të komunës, prindërve, organizatat joqeveritare etj., duke i përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë në interes të fëmijëve tanë.

**OBJEKTIVAT**

Kuptimet orientuese themelore mund të lidhen me :

1. Të zhvilluarit e aftësive trupore dhe trunore përmes aktivitetit lëvizor të programuar;

   Përvetësimin e mjeshtërive të ndryshme sportive;

   Formimin e qëndrimit të drejtë trupor e mendor në ballafaqim me situata të ndryshme praktike në klasë, në shkollë e më gjerë në shoqëri etj.

2. Udhëheqja, kontrolli e korrigjimi real i objektivave programore nga mësuesit duhet të objektivizohet përmes:

   2.1. Matjeve në fillim të vitit shkollor, në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit me masa, si: centimetër, sekondë dhe kilogram dhe zbatimit të njohurive e të përmasave

   2.2. Biomekanike e teknike të lëvizjeve mjeshtërore sportive.

| PËRMBAJTJA PROGRAMORE | Nr. i orëve |
|---|---|
| 1. VLERËSIMI I AFTËSIVE LËVIZORE | 4 orë |
| 2. ATLETIKË | 12 orë |
| 3.GJIMNASTIKË SPORTIVE DHE RITMIKE | 12 orë |
| 4. SPORTET KOLEKTIVE | 24 orë |
| 5. SPORTET INDIVIDUALE<br>- sportet luftarake<br>- sportet me raketë | 12 orë<br><br>6 orë |
| 6. SKIJIMI-NOTIMI[1] | 7-10 ditë |
| 7. PIKNIQET DHE FUSHIMI | 2 ditë në vit |
| 8.GARA SPORTIVE SË PAKU NË DY SPORTE (SIPAS KUSHTEVE) | |

[1] Mësimi organizohet në terren të përshtatshëm për ski e not në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, prindërit dhe institucionet e tjera.

## TREGUESIT THEMELORË TË PROGRAMIMIT

| **Kategoritë** | **Nënkategoritë** | **Përmbajtjet programore** | **Numri i orëve (%)** |
|---|---|---|---|
| ANTRO-<br>POMETRI<br>DHE<br>MOTORIKË | Vlerësimi i veçorive antropometrike dhe i aftësive lëvizore | **(A)** -Pesha e trupit (PT),<br>- Lartësia e trupit (LT) etj.<br>**( M)** - Kërcim nga vendi në gjatësi,(KVGJ)<br>- Kërcim nga vendi në lartësi (KVL),<br>- Vrapim 100 metra(V100m),<br>- Vrapim 600mF-800mM dhe dy teste nga mjeshtëria e të mësuarit. | 4 orë<br>5.4% |
| ATLETIKË | Vrapime<br><br><br><br><br>Kërcime<br><br><br>Hedhje<br>Gara (në 2 disiplina) | Përsosje e mjeshtërisë së vrapimit (teknikë), kërcimeve dhe hedhjeve përmes:<br>- Vrapimit të shpejtë,<br>- Vrapimit dhe rritjes së qëndrueshmërisë në shtigje më të gjata si 600m për femra dhe 800m për meshkuj.<br>- Ushtrimeve për kërcyeshmëri.<br>- kërcimi së gjati, teknika me trup në hark (përsosje)<br>- kërcimit së larti "fosberi".<br>- Shtytje e gjyles 4 kg.<br>- gara brenda e në mes të paraleleve së paku në dy disiplina, ku duhet të rangohen nxënësit dhe grupëzohen në tri grupe sipas rezultateve. | 12-14 orë<br>6.2-18.9 % |
| GJIMNASTIKË SPORTIVE DHE RITMIKE | Ushtrime në dysheme<br><br><br><br><br>Në hekur | - Vertikalja mbi shpatulla<br>- Nga mbështetja shtrirë para, kalim në mbështetje shtrirë prapa.<br>- Ekuilibri ballor.<br>- Ekuilibri anësor.<br>- Kapërdim fluturimthi.<br>- Nga varja rrotullim me forcë prapa, në mbështetje para. | 10-12 orë<br>13.5-16.2% |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | - Rrotullimi prapa, në mbështetje para.<br>- Dalja në hark. | |
| | Paralele | Paralelja (M):<br>- Lëkundje në mbështetje mbi krah.<br>- Lëkundje në mbështetje mbi duar.<br>- Ngritje në lëkundje para deri në ndenje me këmbëhapur.<br>- Ngritje me shpalosje deri në ndenje me këmbëhapur.<br><br>Paralelja (F)<br>-Varje në drushtën e sipërme.<br>- Nga lëkundja me kapje nga sipër, mbështetje e këmbëve në drushtën e ulët, kthim për 180° .<br>- Varje në drushtin e lartë, kalim me këmbë anash, (majtas-djathtas)<br>- Lëkundja ballore.<br>- Rrotullim prapa në drushtën e ulët.<br>- Rrotullim prapa nga mbështetja e shaluar.<br>- Dalje me trup të shtrirë prapa përtej drushtës së ulët. | |
| | Unazat | - Lëkundje në varje në unaza.<br>- Nga lëkundja para në varje të palosur.<br>- Dalja në lukundje para dhe prapa.<br>- Lëkundja nga mbështetja para dhe prapa. | |
| | Kërcime | -Kërcimi i kaluçit në gjerësi, këmbë anash.<br>- Kërcimi me këmbë hapura anash.<br>- Kërcimi i kaluçit me këmbë të mbledhura | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Në traun gjimnastikor<br><br><br><br><br><br><br>Gjimnastika ritmike<br><br><br>Vallet popullore<br><br>Gara (2) | - Hipjet në shalë përkulje me mbështetje.<br>- Ecje mbi tra në majë të gishtave para-prapa.<br>- Kërcim me të dy këmbët nga vendi.<br>- Kthim për 180°-360°<br>- Qëndrimi në ekuilibër krahët anash-poshtë.<br>- Kombinime me elemente të mësuara.<br><br>- Ushtrime me rekuizita<br><br><br>- Përsëritja e valleve popullore të përvetësuara në klasën V, VI, VII, VIII<br><br>- Brenda e mes paraleleve së paku në dy vegla. | |
| SPORTET KOLEKTIVE | Futboll<br><br><br><br><br><br><br><br><br>Volejboll | Pasimet dhe pranimet e topit.<br>Udhëheqja-driblimi i topit.<br>Mashtrimet-driblingjet me shollë.<br>Goditja-gjuajtja e topit në portë.<br>Zbatimi i lëvizjeve teknike gjatë; lojës së futbollit të; vogël.<br>Elementet taktike: mbrojtja individuale dhe grupore.<br>Sulmi individual dhe grupor me zbatimin e rregullave të fubollit të vogël.<br><br>Përsëritja e lëvizjeve teknike: pasimi i topit, shërbimi, tenis, gjuajtja, blloku, pranimi etj. Përvetësimi i dëbimit të topit nga poshtë, me çekan. Pranimi i shërbimit.<br>Pozicionet (vendosja e lojtarëve). Lëvizjet taktike në fushë. | 26 orë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Mbrojtja grupore dhe ekipore. Vendosja e lojtarëve gjatë mbrojtjes-sistemi me qendërmbrojtës para. Sulmi grupor dhe ekipor nga pozicione të ndryshme. Volejboll, loja 6:6. Gara shkollore në volejboll. | |
| | Hendboll-basketboll | Përmes lojës në kushte të mundshme dhe në numër të lojtarëve të mundshëm bëhen: përsëritja, korrigjimi e përforcimi i drejtë i<br>1. Elementeve themelore të teknikës, si:<br>- pasimet dhe pranimet.<br>- driblimi - udhëheqja.<br>- mashtrimet.<br>- goditjet- gjuajtjet etj.<br>2. Po ashtu, përmes lojës mësohen e korrigjohen elementet e taktikës individuale të mbrojtjes dhe<br>të sulmit dhe të asaj kolektive që duhet ti njohin nxënësit së paku ata të mësimit zgjedhor të dy mbrojtjeve zonale (basketboll, hendboll etj.), një njeri në një njeri dhe një të kombinuar. Po ashtu sulmi kolektiv i paraprir nga llojet e kundër sulmeve nxënësit e përzgjedhur duhet ti mësojnë e përforcojnë dy sistemet së paku dy sisteme të sulmit kolektiv. | |
| | Gara | Brenda e mes paraleleve së paku në dy sporte kolektive. | |
| SPORTE INDIVIDUALE | Sportet luftarake-Xhudo | Njohja me teknikën themelore të lëvizjeve të xhudos, si: kapjet e ndryshme, rëniet etj. | |
| | Pingpong | Përsosje të teknikës themelore të goditjes me pëllëmbë, me shpinë dhe me goditje me rrotullim. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Mësimi i shërbimeve bashkëkohore dhe i sistemeve të garave individuale e ekipore. | |
| | Roshulla<br><br>Gara (2) | Mësimi i lëvizjeve themelore të rrëshqitjes me rroshulla si para, prapa me ndalje, lëvizje gjysmëharkore etj. me shpejtësi adaptuese.<br>Brenda e mes paraleleve së paku në dy njësi mësimore të kaluara. | 6-12 orë |
| Aktivitete në ujë<br>7-10 ditë | Teknikat e notit:<br><br><br><br>Gara | Përsosja e teknikave të mësuara (krol, bretkosë dhe kroli në shpinë).<br>Përsosja e nisjes (startit) krol, bretkosë dhe krol në shpinë.<br>Teknika delfin - lëvizjet elementare, veprimi me këmbë, me krahë dhe frymëmarrja.<br><br>Gara: teknika krol, bretkosë dhe krol në shpinë. | 7-10 ditë |
| Aktivitete në borë<br>7-10 ditë | Disiplinat alpike<br><br><br><br>Gara | Përsosje e teknikës themelore të rrëshqitjes me ski të mësuara më parë (ecjet, kthimet, ngjitjet, zbritjet, kalimet, lëshimet, sllallom dhe sllallom i madh.<br>Lidhja e dy e më shumë kthimeve në terrene të përshtatshme për këtë grup-moshë .<br>Në sllallom të madh në shteg të përshtatshëm për këtë grup- moshë. | 7-10 ditë |
| Gara shkollore | Gara në sportet kolektive dhe individuale<br>Krosi pranveror dhe vjeshtor | Së paku në dy degë sportive në kuadër të shkollës dhe ndërmjet shkollave të komunës, zonës e atyre finale e shtetërore për grup - mosha të caktuara me të dy gjinitë<br>Krosi pranveror dhe vjeshtor | 10-12 orë<br>16.2% |
| Shëtitje | Shëtitje në natyrë dy herë në vit | Ecja në natyrë me konfiguracion 6-12 km.<br>Elemente të orientimit në natyrë dhe të kampingut (zgjedhja e kampit dhe vendosja e një shatori).<br>Lojëra të ndryshme të terrenit. | |

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Në bazë të kushteve që ka shkolla, përshtaten përmbajtjet programore, duke bërë:

- përfshirjen rreth 70% të përmbajtjeve programore (analizo tabelën) si mësim i obliguar, ndërsa
- rreth 30% mësim zgjedhor.

**Metodologjia realizuese.** Në procesin e mësimit të lëvizjeve në edukimin sportive, pa marrë parasysh mjetet e konkretizimit që i ka shkolla, patjetër, duhet zbatuar:

- demon,strimi praktik i njësive lëvizore nga mësuesit e edukimit sportiv apo të ndihmësit të tij (nxënës, sportist). Në varësi me aftësitë e nxënësve dhe të shkallës së ndërlikueshmërisë së lëvizjes, mësuesi zgjedh ecurinë metodologjike të ushtrimeve, duke u bazuar në rend të parë:
- në formën sintetike (tërësinë lëvizore), analitike apo kombinimin e të dyjave. Po ashtu, organizimi i orës mësimore bëhet në varësi me kushtet, objektin, rekuizitat dhe numrin e nxënësve. Duhet bërë përpjekje që komplekset lëvizore përmbyllëse, lidhur me kategoritë e nënkategoritë të cilat zbatohen, të finalizohen me lojë e garë.

**Arritshmëria. -** Në disiplinat lëvizore, ku rezultatet mund të vlerësohen në masa metrike objektive, si: centimetër, sekondë, gram, mësuesi i edukimit sportiv duhet të evidencojë gjendjen fillestare, pastaj atë kaluese dhe së fundi atë përfundimtare, duke bërë renditjen dhe grupëzimin e nxënësve së paku në tri grupe (të dalluar, mesatar e me aftësi të kufizuara). Për lëvizjet ku nuk mund të kemi masa metrike të sakta, duhet bërë përpjekje që niveli i arritshmërisë të lidhet me shkallën e përvetësimit të mjeshtërisë së lëvizjeve nga aspekti i teknikës shkollore, stilit të notimit dhe, duke pasur parasysh anën e drejtë biomekanike të lëvizjeve (me përshkrim).

**Ndërlidhja me lëndët e tjera. -** Orari mësimor dhe organizimi i orës së edukatës sportive, duke përfshirë edhe ngarkesat gjatë orës, duhet të jenë asisoji që të ndikojnë në mënyrë motivuese për lëndët e tjera të asaj dite shkollore.

Njësitë mësimore të kategorive e të nënkategorive të përfshira ndërlidhen duke filluar nga matematika, informatika deri te lëndët biolo-

gjike e shkencat e tjera në kierarkinë disiplinare e interdisiplinare të emërimeve.

## VLERËSIMI

- Vlerësimi i zhvillimit trupor ashtu si në klasën paraprake, të masave antropometrike, bëhet 2 herë në vit. E detyrueshme është lartësia e trupit dhe pesha e trupit, po do të ishte mirë të mateshin edhe masat e tjera, si indi dhjamor etj.
- Vlerësimi i aftësive motorike bëhet me sistemin CGS (centimetër, gram, sekondë). Instrumentet matëse obliguese janë: kërcim nga vendi në gjatësi, kërcim nga vendi në lartësi, vrapim 100 m dhe vrapim 800 m për femra dhe 1000 m për meshkuj.
- Shkalla e informatave të mësuara lidhur me lëvizjet rrethanore (sportive) vlerësohet individualisht dhe gjatë situatave të lojës dhe të garës.

## LITERATURA


1. Edukata fizike dhe sportive, Libri shkollor, Prishtinë 2004 (libra të publikuar)
2. Hendboll, Prof.dr. Faik Çitaku;
3. Basketboll, Prof.dr. Masar Nixha;
4. Volejboll, Prof.dr. Enver Gjinolli;
5. Atletika, Prof.dr. Hysen Rakovica;
6. Futboll, Prof.dr. Enver Gjinolli;
7. Ski, Prof.dr, Masar Nixha - Mr. Aziz Dujaka;
8. Metodika e edukatës fizike, Beqir Hasanxhekaj, ligjërues;
9. Sate Practice- in Physical Edukation - Baalpe.
10. Ditari i edukimit sportiv, Instituti i Antropologjisë sportive, 2003.

Tirazhi: 2000 copë
Përgatiti për shtyp:
*SHTËPIA BOTUESE* ***LIBRI SHKO*****LLOR** – Prishtinë
Shtypi:
Shtypshkronja DRITA PRESS – Prishtinë

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

Plani dhe programi mësimor : për klasën IX të shkollës së mesme të ulët / {Kryeredaktor Fehmi Ismajli].- Prishtinë : Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2005 (Prishtinë : "Drita press").- 252 f. ; 24 cm.

**ISBN 9951-450-83-0**